

**ANDREA LLUKANI**

**ANTOLOGJIA E LETËRSISË  
SË KRISHTERE**

**Tiranë, 2006**

Redaktor: prof. em. dr. Pavli Haxhillazi

## PARATHËNIE

Libri Antologjia e Letërsisë së Krishterë është fryt i përpjekjeve të autorit për të dhënë një panoramë të mendimit kristian në Shqipëri. Hartimi i një Antologjie është një punë e vështirë, e cila kërkon hulumtime të materialeve të ndryshme. Në këtë antologji janë përfshirë 32 autorë me shkrimet e tyre më të spikatura. Materialet i kam nxjerrë nga libra, gazeta, revista, faqe interneti, dorëshkrime, kalendarë etj. Autorët janë renditur sipas kritereve kronologjike dhe i përkasin periudhave të ndryshme të kultivimit të letërsisë së krishterë. Antologjia e letërsisë shqipe ndahet në disa periudha kryesore:

- |                                   |           |
|-----------------------------------|-----------|
| 1- Letërsia e vjetër shqipe       | 1400-1800 |
| 2- Letërsia e rilindjes kombëtare | 1800-1912 |
| 3- Letërsia e pavarësisë          | 1912-1944 |

Libri Antologjia e Letërsisë së Krishterë është konceptuar në gjashtë krerë. Në kreun e parë kam grupuar Letërsinë e vjetër shqipe (1200-1800), e cila përfaqësohet nga Gjon Buzuku, Lekë Matrënga, Pjetër Budi, Frang Bardhi, Pjetër Bogdani, Anonimi i Elbasanit, Grigori i Durrësit, Thoedhor Haxhifilipi, Kostandin Berati etj.

Letërsia e Rilindjes Kombëtare (1800-1912) zë kreun e dytë të librit. Autorët i kam vendosur sipas renditjes kronologjike: Naum Veqilharxhi, Jeronim de Rada, Kostandin Kristoforidhi, Petro Nini Luarasi, Asdreni, Çajupi etj.

Kreu i tretë përfshin periudhën prej vitit 1871 deri më 1940. Letërsia e Pavarësisë përfaqësohet denjësisht nga Gjergj Fishta, Fan Noli, Migjeni, Mitrush Kuteli, Lasgush Poradeci, Ernest Koliqi, Visarion Xhuvani, Anton Harapi etj.

Kontributi i katolikëve për lëvrimin e letërsisë shqipe është i madh. Janë rreth 460 vepra të shkruara prej 163 klerikëve e shkrimtarëve katolikë, të cilat përbëjnë një thesar të vërtetë në kultivimin e gjuhës shqipe. Më poshtë vijon klasifikimi i shkrimtarëve katolikë sipas viteve.

1-Në vitet 1555–1700 katolikët kanë kontribuar në lëvrimin e gjuhës shqipe me 12 vepra, të cilat janë shkruar nga 9 autorë: Buzuku, Bardhi, Bogdani, Budi, Barleti etj.

2-Në vitet 1700-1800 kemi 11 vepra dhe 9 autorë, si dhe 6 dorëshkrime: Kuvendi i Arbërit, Dom Gjon Kazazi etj.

3-Nga vitet 1800–1900 kemi 81 vepra me 34 autorë si dhe 4 dorëshkrime: Zef Jubani, Pashko Vasa, Dom Ejëll Radoja, Dom Pjetër Zarishti, Dom Nue Bytyçi, Dom Pashko Babi etj.

4- Në vitet 1900-1912 janë shkruar 59 vepra me 16 autorë, prej të cilëve mund të përmendim: Gjergj Fishta, i cili botoi 17 libra, Luigj Gurakuqi, që shkroi 6 vepra, Dom Noc Nikaj, Dom Ndre Mjeda me 12 vepra, Shtjefën Gjeçovi me 7 libra, Pashko Bardhi, Hilë Mosi, Filip Shiroka, Mati Logoreci etj.

5-Ndërmjet viteve 1912–1933 janë shkruar 304 vepra me 69 autorë: Terenc Toçi, i cili ka shkruar 8 libra, Vinçenc Prennushi me 20 vepra, Noc Saraçi që ka botuar 13 libra shkollorë, Karl Gurakuqi ka përkthyer 8 libra, Ernest Koliqi me 3 libra etj. Në qytetin e Durrësit me interesimin e etërve domenikanë që nga 14 qershori i vitit 1396 funksiononte “Qendra e studimeve të

përgjithshme teologjike”, e cila kishte në gjirin e saj 25 doktorë shkencash.

Klerikët ortodoksë për shkrimet shqipe janë ndeshur me vështirësi të shumta, madje disa prej tyre e kanë paguar shtrenjtë deri në martirizim.

1-Në shek. XV-XVII ortodoksët kanë dhënë 23 vepra, kryesisht me karakter fetar: “Perikopeja nga Ungjilli i Pashkëve”, “Anonimi Elbasanit”, Grigori i Durrësit me 14 akoluthi, Nektar Tërpo Voskopojari me 2 libra, Theodor Haxhifilipi me 4 vepra dhe Kostandin Berati me 1 libër.

2-Në vitet 1800 deri 1900 kemi rreth 28 vepra të përkthyer nga këta autorë: Naum Velqiharxhi me 1 libër, Kostandin Kristoforidhi me 10 libra, Petro Nini Luarasi me 2 libra, Asdreni me 5 libra, Papa Kristo Negovani me 5 libra dhe Mihal Grameno me 5 libra.

3- Në shek. XX ortodoksët kanë shkruar rreth 47 libra. Përkthyesi më i talentuar ka qenë Imzot Theofan Noli, i cili ka përkthyer 11 libra liturgjikë, Kryeepiskopi Visarion Xhuvani me 3 libra, Lasgush Poradeci me 5 libra, Mitrush Kuteli me 8 libra, Migjeni me 2 libra, Dhimitër Beduli me rreth 15 libra, Imzot Joan Pelushi me 8 libra, Llukan Stavro me 5 libra etj.

Nuk pretendoj që ta kem grumbulluar të gjithë pasurinë e krijimtarisë shpirtërore të popullit shqiptar, por puna voluminoze për mbledhjen dhe sistemimin e materialit më ka dhënë zemër se kam arritur t’u jap lexuesve një Antologji të mendimit kristian, e cila do t’u shërbejë për të njohur më mirë krijimtarinë letrare të shkrimtarëve shqiptarë.

## **KREU I PARË**

### **LETËRSIA E VJETËR SHQIPE (1200-1800)**

Letërsia e vjetër shqipe u kultivua në vitet e mesjetës, prandaj ka përmbajtje tërësisht fetare. Libri i parë në gjuhën shqipe është “Meshari” i Gjon Buzukut, që u botua më 1555. Kleriku katolik Gjon Buzuku solli në shqip pjesë të liturgjisë të rritit perëndimor. Veprat e letërsisë së vjetër shqipe kanë përmbajtje mësimore dhe didaktike. Buzuku shkruan lutje në gjuhën shqipe, Budi shkruan vargje, Bardhi mbledh fjalë të urta në shqip, Bogdani shkruan librin me cikle vjershash dhe Variboba gërsheton subjektet fetare me ato popullore. Veprat kryesore që u botuan gjatë shek. XVI-XVII janë: “E mbësuar e kërshterë” (1592) e Lekë Matrëngës, “Doktrina e krishterë” (1618) dhe “Rituali roman” (1621) të Pjetër Budit, “Çeta e profetëve” (1685) e Pjetër Bogdanit etj.

Gjithashtu edhe në Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut kemi shkrime në gjuhën shqipe. Ndër to mund të përmendim Anonimin e Elbasanit, Kostë Beratin, Grigorin e Durrësit, Teodor Haxhifilipin etj. Veprat e shkrimtarëve të sipërpërmendur kanë karakter fetar. Një tjetër përpjekje për emancipim më të thellë do të realizohej

me ngritjen e Akademisë së Re të Voskopojës në vitin 1750. Akademia pati emër shumë të madh si brenda dhe jashtë vendit. Nismëtarë për ngritjen e saj njihen Patriku i Ohrit Joasafi, si dhe Teodor Kavalioti. Në drejtimin e saj ka qenë dijetari i shquar Teodor Kavalioti, që shërbeu si arsimtar deri në vitin 1753. Në këtë Akademi mësuan shumë nxënës edhe nga vise të tjera të Shqipërisë, si Korça, Elbasani, Përmeti, Gjirokastra, por edhe nga Greqia dhe Maqedonia. Disa nga lëndët që jepeshin në këtë Akademi ishin gramatika, letërsia, logjika, filozofia, teologjia, fizika, matematika etj. Didaktika në këtë shkollë luhatej ndërmjet shkencës dhe fesë, arsyes dhe besimit. Në rrethin e nxënësve dhe të pedagogëve të kësaj Akademie u bënë përpjekje për kombëtarizimin e Kishës Ortodokse që popullit t'i predikohej në gjuhën shqipe. Kjo gjë dëshmohet me përkthimet e Dhiatës së Re dhe të teksteve liturgjike.

### **PAL ENGJËLLI (1417-1470)**

Pal Engjëlli është një figurë e rëndësishme politike e shoqërore e kohës së Skënderbeut. Si Arkipeshkëv i Durrësit ai kishte vendin më të nderuar në hierarkinë kishtarë të kohës. Imzot Pal Engjëlli, gjatë një vizite baritore që bëri në grigjën e tij, vendosi të thërresë mbledhjen e një kuvendi kishtar. Më 8 nëntor të vitit 1462 në kishën e Shën Trinisë të Peshkopatës së Lezhës, u mbledh kuvendi, i cili udhëzonte që në ato raste të veçanta kur nuk kishte priftërinj dhe kisha, pagëzimi i fëmijëve të porsalindur të kryhej nga familjarët. Në qarkoren (Constitutiones) që u dekretua thuhej se familjarët në rast rreziku mund ta pagëzojnë vetë të porsalindurin duke thënë në gjuhën shqipe këtë formulë: *“Un të pagëzoj p’r emnit (t) Atit e*

*t' Birit e t' Shpërtit Shenjt*". (Namik Resuli, *Shkrimtarët Shqiptarë, Pakti, 2007, faqe 3*).

Kjo formulë pagëzimi shoqërohej me ngritjen tri herë në ajër të fëmijës. Ky lloj pagëzimi në gjuhën kishtare quhet "pagëzimi në ajër" dhe kryhet në raste të veçanta sipas ikonomisë kishtare. Formula e pagëzimit është zbuluar në mes të një shkrimi latinisht prej 37 fletësh nga historiani rumun me origjinë shqiptare Nikolla Jorga në Bibliotekën Laureantiana të Firences.

Formula e pagëzimit është një fjali e përbërë nga nëntë fjalë dhe përfaqëson dokumentin e parë të shkruar në gjuhën shqipe me alfabet latin. Formula e pagëzimit vërteton që në kohën e Gjergj Kastriotit ka pasur klerikë, të cilët shkruanin në gjuhën shqipe. Formula e pagëzimit ka një pasaktësi shkencore në vendndodhjen e saj. Studiuesit që janë marrë me shkrimet e hershme shqipe Androkli Kostallari, Kristo Frashëri, Aleks Buda dhe Eqrem Çabej, kanë shkruar se Formula e pagëzimit gjendet në faqen tre dhe vijon në faqen katër të kodikut, ndërsa kohët e fundit është vërtetuar se ajo gjendet në fillim të faqes katër. Në vitin 1915 Nikolla Jorga botoi Formulën e pagëzimit në një libër të tij me shënime për Ballkanin. Lumo Skëndo ia kërkoi N. Jorgës këtë dokument të rrallë për ta botuar në vitin 1927 në revistën "Dituria". Dijetari rumun ia dërgoi në mikrofilm të shkurtuar, pra në fotomontazh. Studiuesit shqiptarë nuk janë mbështetur në origjinalin e Formulës së pagëzimit, por në botimet e Jorgës dhe të Skëndos. Teksti origjinal i Formulës së pagëzimit është në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit. Bibliotekat e vjetra për dokumente të rralla shpesh bëjnë rrena me anë të fotomontazheve, me qëllim që të provojnë ata studiues, të cilët nuk kanë hulumtuar origjinalin. Musa Ahmeti ka



përkthyer Kodikun e Pal Engjëllit, që përbën një libër me 40 faqe dhe brenda tyre gjendet edhe Formula e pagëzimit.

Në kohën kur ishte Ambasador i Shqipërisë në Vatikan, studiuesi Vili Kasmi pati fatin të shohë dorëshkrimin e rrallë. Pas plotësimit dhe nënshkrimit të disa formularëve, nën mbikqyrjen e dy kujdestarëve të bibliotekës, ai u fut në dhomën ku ruhej dorëshkrimi i vjetër. Formula e pagëzimit ka kodin Ashburuham 1167. (*Tomor Osmani, Formula e Pal Engjëllit, Shuteriqi dyshon shqipërimin, Standard, 6 nëntor 2007, faqe 17*).

### **GJON BUZUKU (1555)**

Gjon Buzuku është autori më i hershëm i letërsisë shqipe. Më 5 janar të vitit 1555 ai ka shkruar duke përdorur alfabetin latin “Mesharin”. Profesor M. Domi është i mendimit se Buzuku duhet të jetë nga fshatrat e Krajës, të cilat gjenden në perëndim të Liqenit të Shkodrës. Gjon Bedek (Benedikt) Buzuku ka qenë klerik dhe ka përkthyer pjesë nga ungjijtë, të cilat i përdorte gjatë shërbesave liturgjike. Sipas Moikom Zeqos, kisha ku ka shërbyer Gj. Buzuku ka qenë në Shirgj, në breg të Bunës, pra në Abacinë e Shën Sergit dhe të Bakut. Në pasthënien e “Mesharit” ai tregon se shtypshkruesit bënin gabime dhe ai nuk mund t’u qëndronte gjithnjë mbi krye, sepse i duhej të kryente shërbesat në kishë.

Gjurmuesi i parë i “Mesharit” ka qenë peshkopi i arbëreshëve të Siqelisë Imzot Pal Skiroi, i cili e zbuloi veprën e famshme në Bibliotekën e Vatikanit në vitin 1909. Në atë kohë Imzot Pal Skiroi ishte rektor i Seminarit të Palermos. Në bibliotekën e seminarit gjendej një pjesë e kopjuar, e cila bënte fjalë për shërbesën e martesës. Por si kishte mbërritur kjo pjesë ungjillore e

kopjuar në Seminarin e Palermos? Zanafilla është që në vitin 1740 kur gjakovari Gjon Nikollë Kazazi ndërsa studionte në seminar gjeti librin, kopjoi pjesën ungjillore që përmendëm më sipër dhe ia dhuroi Atë Raguzës, themeluesit të Seminarit të Palermos. Në kohën që Kazazi e pa në Seminarin e Palermos ka shkruar: “Meshari i lashtë shqip krejt i grisur prej vjetërsie”. Meshari përmban: Oficen e vogël të Zonjës, shtatë psalmet e pendesës, litanitë, lutje, antifonë, urata të ndryshme, të cilat përdoren për nevoja liturgjike. Imzot Pal Skiroi, pasi fotografoi tekstin e “Mesharit”, kreu transliterimin e transkripimin fonetik. Në vitin 1929 Justin Rrota nxori në Vatikan tri kopje të “Mesharit”. Në vitin 1968 Prof. Eqrem Çabej bëri një botim kritik të “Mesharit” me faksimile, transliterim dhe transkriptim. (*Eqrem Çabej, Meshari i Gjon Buzukut, Tiranë 1968, faqe 7-9*).

Meshari si libër liturgjik ka edhe shenja muzikore, sipas të cilave këndoheshin troparet. Studiuesi Moikom Zeqo nxjerr në dritë disa prej tyre. Buzuku ka përdorur shenjën V, e cila lidhet me fjalën VOX, që do të thotë zë, pra teksti liturgjik në këtë rast lexohej me zë; shenjën R, që simbolizon fjalën latine CHORUS. Pra troparet këndoheshin prej korit të kishës; shenjën C, e cila lidhet me fjalën latine CANTUS, që do të thotë këngë. Këto shenja muzikore kanë shumë rëndësi për “Mesharin”, sepse ndihmonin klerikët në celebrimin e shërbesave sipas tipikosë së kishës. (*Moikom Zeqo, Gjon Buzuku dhe të vërtetat e pathëna për të, Korrieri, 29 qershor 2005, faqe 14-15*).

Meshari është një libër, i cili është përdorur për për të plotësuar nevojat liturgjike të kishës. Ai ndihmonte meshtarët e rinj për t’i kryer shërbesat në gjuhën shqipe, ndonëse nuk kishte miratimin e Selisë së Shenjtë ose të ndonjë ipeshkvi vendor. Librat liturgjikë janë tekste të miratuara nga autoritetet e larta kishtare

dhe shërbejnë për të celebruar shërbesat e shenjta. Në kohën kur ka jetuar Buzuku në librat liturgjikë hynin: Brevari (Officium-lat), libër i lutjeve të orëve të ditës dhe Meshari (Missale-lat), që përmban lutjet dhe këndimet e eukaristisë hyjnore. Librat liturgjikë përcaktoheshin me dekrete papnore. Le të analizojmë se çfarë përmban libri i quajtur “Meshari” i Gjon Buzukut dhe cilat janë mangësitë e tij.

-Officium parvum B.M. Virgins (Ofici i vogël i së Lumes Mari Virgjër), faqe 13-33.

-Officio in Aduentu (Lutjet e kohës së Ardhjes së Krishtit), antifonët, faqe 33-41.

-Septem psalmi paenitentiales (shtatë psalmet e penesës), faqe 41-49.

-Litanie (litanitë), faqe 49-55.

-Suffragia deprecatiuncule ose Ad vespervas officii defunctorum (Lutjet e mbrëmjes për të vdekurit), faqe 55-61.

-Cathecuminum exorcismorum (Katekizmi mbi ekzorcizmin), faqe 61-83.

-Missalae (Meshari) pjesërisht, faqe 85-387.

Duke analizuar pjesët e sipërpërmendura, Dom Nikë Ukgjini thekson se ky libër nuk mund të quhet Meshar, as nuk bën pjesë në librat liturgjikë kishtarë. Një Meshar ose Brevar, përveç lejes së botimit, përmban Kalendarin e të Kremteve, Rendorin e Meshës, Kanonin e Meshës (Canon Missae), lutjen eukaristike dhe lutjen e shugurimit të ostjes dhe verës, që përbën pjesën më të rëndësishme të një Meshari. Gjithashtu te litanitë “Meshari” i Gjon Buzukut ka disa lutje të tepërta: p.sh. në fund të litanive ai lutet duke përmendur emrin e vet, si dhe për shpirtin e nënës dhe të babait të tij (faqe 55). Këto janë të papranueshme për librat liturgjikë kishtarë. Ky

libër është quajtur gabimisht Meshar, por ai është thjesht një libër që ka luajtur rolin e një Meshari. (*Dom Nikë Ukgjini, A është libër liturgjik kishtar Meshari i Buzukut?, Koha Javore*).

Mesharit i mungojnë tetë faqet e para, titulli i vërtetë i librit, viti i botimit, vendi i botimit, emri i saktë i autorit ose i përkthyesit, titulli i librit origjinal prej të cilit janë marrë pjesët që janë përkthyer, leja e botimit, parathënia etj. Gjithashtu për Gjon Buzukun dimë vetëm që është i biri i Bdek Buzukut dhe vetëm kaq. Nuk dimë vitin e lindjes, vitin e vdekjes si dhe shkollimin e shërbimin kishtar. Sipas kërkimeve në librat e amzës të studentëve, përjashtohet mundësia që Gjon Buzuku të ketë studiuar në ndonjërin nga kolegjet kishtarë të Italisë. Emri i tij nuk figuron në regjistrat e Arkivit Sekret të Vatikanit, duke na krijuar dyshim për pozitën e tij kishtarë. Botimi i Mesharit të Buzukut u bë për të përmbushur këto kërkesa: a) nevojën e përditshme për kryerjen e ceremonive fetare, b) shtimin e njohurive liturgjike të prelatëve shqiptarë, të cilët nuk dinin latinisht, c) edukimin fetar të besimtarëve.

Kushtet historike të shekullit XV sollën zhvillimin kulturor të kombeve. Këto kushte bënë të mundur që shërbesat liturgjike të përktheheshin në gjuhën e popujve të ndryshëm. Me përkthimin e “Mesharit” Buzuku e rendit Arbërinë përkrah vendeve të zhvilluara evropiane, të cilat qenë në kërkim të identitetit të tyre kombëtar. (*Jaho Brahaj, 450 vjet me mesharin e Gjon Buzukut, Panorama, 5 janar 2005, faqe 21*).

### **Pasthënie e Mesharit**

U Dom Gjoni, biri i Bdek Buzukut, tue u kujtuom shumë herë se gluha jonë nukë kish gja të ndigluom n së Shkruomit shenjtë, n së dashunit së botëse sanë desha me u fëdigunë, për sa mujta me

ditunë, me zditunë pak mendetë e atyne qi të ndiglonjinë, përse ata të mundë mernë sa i naltë e i mujtunë e i përmishëriershim anshhtë Zotynë atyne qi ta duonë m gjithë zemërë. U lus mbas sodi ma shpesh të vini m klisë, përse ju kini me gjegjunë ordhëninë e Tinëzot. E atë në mbarofshi, Zotynë të ketë mishërier mbi ju. E ata qi u monduonë djerie tash, ma mos u mundonjë.

E ju t'ini të zgjedhunitë e Tinëzot. E përherë Zotynë ka me klenë me ju, ju tue ndjekunë të drejtënë e tue lanë të shtrembënë. E këta ju tue bam, Zotynë ka me shtuom ndër ju, se të korëtë taj të nglatëtë djerie n së vjelash, e të vjelëtë djerie n së mbjellash. E u ma duo të mbaronj vepërënë teme, Tinëzot tue pëlqyem. Ndë vjetët M.D.L.IV. njëzet dit ndë mars zuna nfill, e mbarova ndë vjetët një M.D.L.V. ndë kallënduor V dit. E se për fat në keshë kun mbë ndonjë vend fëjyem, u duo tuk të jetë fajtë, aj qi të jetë ma i ditëshim se u, ata faj e lus ta trajtonjë nde e mirë. Përse nukë çuditëm se në paça fëjyem, këjo tue klenë ma e para vepërë e fort e fështirë për të vepëruom mbë gluhët tanë. Përse ata qi shtamponjinë kishnë të madhe fëdigë, e aqë nukë mundë qëllonjinë se faj të mos banjinë, përse përherë ndaj ta nuk mundë jeshë; u tue mbajtunë një klisë, mbë të dy anët më duhe me shërbyem. E tash u jam nfjalë gjithëve, e lutëni Tenëzonë ende për muo.

Meshari i Buzukut përmban litani, himne dhe psallme. 12-  
*Psallmet në mënyrë analoge me përmbajtjen e tyre ndahen në: psallme të pendimit, psallme lavdërimi etj. Psallmet më të rëndësishme janë ato që përshkruajnë jetën, pësimet dhe triumfin e Krishtit ose siç quhen ndryshe psallme Mesianike. Moikom Zeqo ka përshtatur në shqipen e sotme disa pjesë të Mesharit.*

O Jezu Krisht, shpëtuesi i tërë botës, shpërblyesi i shpirtërave, mbret i pavdekshëm, unë të lutem Dom Gjoni shërbëtori yt për psallmet që i padenjë të këndova liroje shpirtin tim nga mëkatet, qetësoje zemrën time sërish për ata, që në të keqen ecin në të padrejtën pa ligje, liroje trupin tim, mos jetë simbol mëkati, që në të keqen ecin, në të padrejtën, pa ligje, të mos më afrohet mëkati i dëshirës për grua, largoni tërë të ligjtë që Satani m’i afron, ata që duken dhe që janë të padukshëm, që më shtyjnë të mos eci në rrugën e Zotit. O zot, i tërë rruzullimit të qofsha falë që vetë jetën e mban, në jetë të jetës. Amin! (*Moikom Zeqo, Vepra e Buzukut, në rrafshin poetik dhe estetik, Koha Jonë, 20 dhjetor 2005, faqe 8*).

## **LEKË MATRËNGA (1560-1619)**

Lekë Matrënga ka lindur në Piana dei Greci më 1560. Pasi kreu seminarin e Romës në vitin 1591 u kthye në vendlindje ku shërbeu si meshtar. Një nga detyrat e klerikut është që të zhvillojë mësimet e katekizmit për fëmijët e eparhisë së tij. Për këtë qëllim L. Matrënga në vitin 1592 ka përkthyer dhe botuar në dialektin jugor të gjuhës shqipe veprën “Embsvame e chrestere”, i cili ishte një libër katekizmi i shkruar nga kleriku jezuit spanjoll Landesma. Kjo vepër deri në vitin 1947 ruhej në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit dhe më pas është grabitur. Gjithsesi studiuesi Justin Rota ka mundur që të siguronte një fotokopje, e cila gjendet në Bibliotekën Kombëtare në Tiranë. Madje J. Rota në vitin 1939 e ka botuar këtë vepër të pajisur me shënime, në revistën “Hylli i Dritës”, që botohej në Shkodër.

Studiuesi arbëresh Matteo Mandala duke hulumtuar në Biblioteca Angelica të Romës gjeti një ksombël të veprës “E mbësuaame e krështerë”. Këtë ksombël e pati sjellë në vitin 1589 Angjelo Rocha, i cili ka bërë edhe një shënim italisht në kopertinën e librit: “Dottrina christiana in lingua Albanese”. Vepra “Embsvame e chrestere” ruhet në një vëllim së bashku me dy vepra të tjera.

Musa Ahmeti me mbështetjen e Moikom Zeqos ka arritur të bëjë krahasimet me ksomblën që gjendet në Bibliotekën Kombëtare të Tiranës. Nga krahasimet dhe analizat shkencore vërtetohet se kjo vepër ka disa ndryshime. Në fund të veprës së tretë të Lekë Matrëngës “Embsvame e chrestere” gjendet emri i Tomë Ragiës, i cili aprovon botimin. (*Musa Ahmeti, Vepra “Embsvame e chrestere” e Lekë Matrëngës, Koha Jonë, 23 shkurt 2006, faqe 18*).

M. Mandala ka vendosur që këtë vepër prej 600 faqesh ta botojë në gjuhën shqipe. Ai u ka propozuar akademikëve shqiptarë se ka ardhur koha që veprat e autorëve të vjetër arbëreshë të botohen në gjuhën shqipe, sipas tekstit origjinal, sepse në kohën e regjimit komunist janë sjellë kopje joorigjinale dhe është bërë keqinterpretimi i tyre. Prof. Mandala theksoi: “Unë jam i bindur se duke u marrë studiuesit shqiptarë me tekstet në origjinal, ato shtrembërime që pësuan këto vepra për arsye ideologjike, ato paragjykime dhe interpretime të njëanshme, vlerësime kritike si në rastin e Lekë Matrëngës, De Radës, Jul Varibobës etj, duhen mënjeluar patjetër”.

Libri i L. Matrëngës “Embsvame e chrestere” përmban: një letër të autorit, e datës 20 mars 1592, “Këngën e përshpirtshme” dhe katekizmin në formë dialogu. Autori i librit me anën e Fletëkushtesës i drejtohet Kryepiskopit të Montrealit. L. Matrënga

me përlësinë që e karakterizon i shpreh primatit kishtar arësyen përse ndërmori përkthimin e kësaj vepre.

### **Fletëkushtesa**

Duke pasur unë nga përvoja njohje aq të mirë, sidomos për dashurinë e shprehur që Zoti ynë me mëshirën e vet pëlqeu të pranonte Zotërinë tuaj të fort të Ndrithme e të Ndershme për ndihmë shpirtërove në përgjithësi e në veçanti nënshtetasve tuaj shpresëtarë, kam menduar se juve do t'ju vijë mjaft mirë që unë të ndërmarr ndonjë punë të dobishme për shpirtrat e nënshtetasve që i keni në këtë tokën tuaj të grekëve Shqiptarë. Nga kjo duke ditur se Zotëria juaj fort e ndritshme dhe e ndershme bëri aq shumë që djemtë dhe vajzat të edukohen në doktrinën e krishterë, desha të bëj përkthimin e saj në gjuhën tonë kombëtare Shqiptare, sepse versioni italisht që po qarkullon tanët s'e kuptojnë mirë, këtë e kam bërë me dëshirë aq të madhe sa kam menduar se Zotërisë Suaj fort të Ndrithme kjo do t'i vijë shumë mirë; dhe tashmë ka filluar të mësohet solemnisht me aq gëzim e kënaqësi të popullit, i cili, jam i sigurt, se sikur të kishit qenë ju të pranishëm, do të kishit fluturuar nga gëzimi shpirtëror. Dhe tashmë shumë fëmijë të moshës jomadhore, për çudi të popullit, e kanë mësuar një pjesë të mirë dhe ajo që na habit më së shumti është se vajzat në këtë mësim i kanë kaluar djemtë si për kah numri, ashtu edhe për kah dija.

Kam dashur t'ia kushtoj këtë mund timin Zotërisë Suaj të fort Ndrithme si padronit dhe mbrojtësit tim duke shpresuar se duhet t'u jem mirënjohës; dhe pos asaj që do t'i jetë e dobishme popullit grek, do t'ju jetë edhe më shumë e dobishme aq qindra shtëpive në Kalabri e në Pulje që janë të botës shqiptare. Le të jetë e denjë pra Zotëria Juaj fort e Ndrithme dhe e ndershme që



ta pranojë nga shërbëtori i saj i thjeshtë këtë dhuratë të thjeshtë së bashku me ato dëshira me të cilat unë po jua ofroj sepse sigurisht gjë tjetër s' më ka shtyrë pos lavdisë, pos kënaqësisë se do të dalë për Zotin Tanë dhe pos kënaqësisë nga të gjithë, kam bërë dy gjëra për dy vështirësi që ndeshen në të folurit e kësaj gjuhe shqipe.

E para është se sipas mënyrës letrare greke i kam vënë theksat mbi fjalët, gjë që do të ndihmojë shumë në shqiptimin e drejtë. Dhe e dyta jam kujdesur për një vështirësi të madhe që kanë grekët shqiptarë në shqiptimin e njëfarë tingulli i cili përsëritet gati në çdo fjalë që Zotëria Juaj fort e Ndrithme të jetë e informuar plotësisht, do të dijë se Shqiptarët pothuajse në çdo fjalë kanë njëfarë tingulli që përftohet me hundë dhe megjithatë nuk është rregullisht vokal i veçantë, dmth a,o,e ose u, por nganjëherë vetëm një tingull përkatësisht vokal i shqiptuar me hundë, një A të diftonguar. Këtë do ta kuptojnë mirë me anë të këtij shpjegimi Shqiptarët, ndonëse do të jetë vështirë për të tjerët deri sa me anë të praktikës nuk do ta mesojnë shqiptimin. E gjithë kjo ka qenë e nevojshme të theksohet në këtë kushtesën time. Për ato e kam përdorur kur nevojitet ai tingull përkatësisht vokali më i lehtë. E unë deri sa të jem gjallë nuk do të mungoj (siç kam vepruar gjatë gjithë kohës së kësaj kërsëndelle) të atij që për ne u bë festë fjalë për fjalë e mësojmë drejt e ata përgjigjen me dashuri të zjarrtë Krishtere; e gjithësesi është çudi që nëpër rrugët tona tjetër nuk dëgjohet pos zërit të fëmijëve duke e recituar doktrinën në gjuhën shqipe. E gjithë kjo i qoftë lavdi Zotit Tanë nga i cili kërkoj mëshirë të madhe për Zotërinë Tuaj fort të ndritshme e të ndershme. (*Fadil Sulejmani, E mbsuame e krështerë e Lukë Matrëngës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979, faqe 35*).

Nga Piana de Greçi, më 20mars 1592  
Luka Matrënga

Në vijim të librit poeti arbëresh Matrënga ka shkruar një poezi shumë të bukur, e cila titullohet “Kënga e përshpirtshme” dhe konsiderohet si vjersha e parë e shkruar në gjuhën shqipe. Tre vargjet e para të vjershës janë adhuruese.

Gjithëve u thërres, kush do ndëlesë  
Të mirë e të krështe, bura e gra  
Mbë fjalët të tinëzot të shihni meshë

Dy vargjet që vijojnë janë më themeloret dhe na japin mesazhin e kësaj vjershe.

Se s’ishtë njeri nesh çë mkatë s’ka  
E lum kush e kujton se ka të vdesë

Tre vargjet e fundit të vjershës kërkojnë shpëtimin.

E mentë bashkë mbë tënëzonë i ka  
Se Krishti ndë parrajsit i bën pjesë  
E bën për bir të ti e për vëlla.

Kjo këngë përmbledh gjithë doktrinën e autorit duke na e dhënë në një trajtë të përsosur letrare dhe poetike. “Kënga e përshpirtshme” e Lekë Matrëngës gjendet në librin “E mbsuame e krështerë” të shkruar në vitin 1592. Libri vijon me katekizmin, i cili është ndërthurur në formën e një dialogu ndërmjet atij që drejton katekizmin dhe nxënësve që e dëgjojnë.

## **Të tetë të Lumetë**

- 1-Lumtë ata që janë vabëk shpirti pse e tireja ishte perëndia e qiellvet.
- 2-Lumtë ata që janë të butë se ata kanë të trashëgojnë dhenë.
- 3-Lumtë ata që klanë pse kanë të jenë fëqierë (ngushëlluar).
- 4-Lumtë ata që kanë u e et për ligjt, pse ata kanë të jenë lipsurë.
- 5-Lumtë ata që kanë lipisi pse ata kanë të jenë lipisurë.
- 6-Lumtë ata që janë qëruarë zemëre pse ata kanë të shohënë tënëzonë.
- 7-Lumtë të mbaqëruamitë, pse kanë të kluhenë bilj të tinëzot.
- 8-Lumtë ata që psonjënë të përzëna për ligjt, pse e tireja ishte perëndia e qiellvet.

Në katekizmin e krishterë lumërimet e Zotit janë dhjetë, por Matrënga nga përkthimi i lirë që ka bërë i ka përmbledhur në tetë.

## **PJETËR BUDI (1566-1622)**

Pjetër Budi ka lindur në Gur të Bardhë të Matit në vitin 1566. Në moshën 21-vjeçare u dorëzua prift dhe shërbeu në Kosovë e Maqedoni. Dom Pjetër Budi ishte Vikari i përgjithshëm i Shurbisë. Më 10 korrik të vitit 1621 Budi u emërua ipeshkëv i Zadrimës. (*Pjetër Budi, Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë, 2008, faqe 12*).

Budi ka lënë një trashëgimi të pasur letrare. Ai ka botuar katër vepra. Vepra e parë e P. Budit është “Doktrina e Kërshtenë”, një katekizëm i përkthyer shqip bashkë me disa (dhjetë) vjersha fetare (botuar së pari në vitin 1618 dhe ribotuar në Romë më 1636, 1664 dhe 1668). “Doktrina e Kërshterë” ishte libri më i rekomanduar prej Kundërreformës për misionarët e Vatikanit. Në

vitin 1621, Budi botoi veprën “Rituali roman”. Ndërsa më 1621 botoi “Kush thotë meshë, këto kafshë i duhen me shërbyem”. Përkthimi tjetër i tij “Pasqyra e të rrëfyemit”, nuk u aprovua nga censura e Vatikanit duke u konsideruar si libër i papërshtatshëm për Kundërreformën. Budi ka lënë një trashëgimi të pasur letrare dhe është quajtur shkrimtari më origjinal i letërsisë së vjetër shqipe. Ai ka shkruar rreth 100 faqe prozë në trajtën e parathënieve dhe rreth 3200 vargje poezi.

Budi gjatë shërbimit të tij 40-vjeçar nëpër viset shqiptare u njoh me jetën e vështirë të popullit. Krahas karakterit njerëzor dhe pastoral në shërbim të grigjës së tij, Budi u brumos si njeri kryengritës dhe rebel. Më 1622 Budi grumbulloi gjithë meshtarët vendas të Zadrimës, Shkodrës dhe Lezhës në një lidhje ku u vendos: -Të mos pranonin meshtarë të huaj nëpër tokat shqiptare, të cilët krahas shërbimeve fetare kryenin edhe punë të tjera në dobi të interesave të vendeve të tyre. Në moshën 52-vjeçare Budin e mbytën duke kaluar në lumin Drin. Kjo ka ndodhur në vitin 1622. Mbytja e Budit ka qenë e organizuar nga aleanca Vatikan-Venedik përmes mashës së tyre që kishin në Zadrimë. (*Behar Gjoka, Faktet e vërteta të vrasjes së Pjetër Budit, Standard, 5 qershor 2006, faqe 14-15*).

### **Parathënia e Doktrinës së Kërshtenë**

Vëllazënitë e dashunë e të feeshimitë bijtë e Krishtit.

Disa herë tue kujtuom të vdjerrët e gjith aqë të madh dam të shintesë fee, qi u baa ende po bahet për të gjithë ditë ndë gjuhë tanë, maa kae me dhuunë se ndoonjij tjetër dorë gjindje përmbij dhët; e tue paam ashtu ende se këta diesitë e letërorëtë hollë, qi u vjen ndore ashtu gjaakafshë me ndimuom, e lanë shkret e gjaa maa s’po ndihmonjënë; ma s’keshë tjetër qish me baam, veçëse

hina mbarë e mbrapë, sido munda, shkrova mbë gjuhë tanë e ncë devotshim, frat Paalit prej Hassi; të cijtë, ende me do të tjera të nshtuome, disa herë tue i shkruom, kuur tue paam se ishnë për të madhe ndihmë e fruitë shpijrtit t’ atij populli, e aqë maa tepërë të disa priftëne, qi dëshërojnë me i pasunë; hina për të gjithë ditë kaa, me të cijt të mundeej ndër ta me u ndihmuom feeja e Krishtit, zuna fijll, mund aqë saa munda, nktheva këtë shinte Doktrinë gjuhe cë lëtine mbë gjuhë t’ arbëneshë, si për ndimëtë atij populli, ashtu ende me ncierrë pakëzë gjumënë e disave, qi pakmos gjithë të rijtë e jetënë e vet e shkuonë ndë të mbrazëtë;.....

E tashti, tue mos dashunë maa tej me ngjatunë, jo tjetërë mbassi u janë porësiturë ndraato shinte uratë e qi jemi detuor njani për tjetërit, u rekomendonj e u porësit, ashtu ende gjith atë popullë e kërshënim qi kini ndaj vetëhenë, e aqë maa tepër ata qi kini marrë gjith atë popullë e kërshënim qi kini ndaj vetëhenë, e aqë maa tepër ata qi kini marrë përpara vetij en Zotynë, posikur bariu grigjnë me i ruojtunë ndër gjithë saa janë kafshëtë shpijtrit ashtu qi ndë e vonë ur uratë tuoj e për të madhet mëshërier të Tinëzot, e ju për të nzyyrmrit e fëdigët e kujdes taaj, e ata për të prunjëtit e hobidienciet e ndimëtë korpit që t’ u banjënë, gjithë ncë bashku ata ndaj engjijt e ndaj shintënit të lëvdojmë shintinë emënitë e tij për gjithë jetë të jetësë. Amen, ashtu qoftë.

Prej Rome, të 7 ditë ndë kallënduor, ndë vietë të Krishtit 1618.

Gati ndë gjithë shërbetyrë i prunjëti vëllai i zotënijsë saaj, Dom Pjetër Budi, prej Guri cë bardhë, Vikari gjeneraalli Shurbijsë.

Pjetër Budi, në librin “Doktrina e Kërshënenë” pohon se kapitujt e parë i ka marrë nga Frat Pali prej Hasit. Nuk dihet me

saktësi se kush ka qenë Frat Pali nga Hasi. Pra për dy vjershat e para për vdekjen dhe ditën e gjyqit, Budi pohon se i ka marrë nga Pali dhe i ka përpunuar.

### **Vdekja e Madhështia**

O i pafati njieri  
Gjithë ndë të keq harruom,  
I dhani ndë madhështi,  
Ndë mkat pshtjellë e ngarëtruom:

Ndo plak je ndo i ri,  
Përse s'shtie të kujtuom,  
I vobeg ndo zotënji  
Nceje je i krijuom?

Baltë e dheu cë zi,  
E jo ari cë kulluom,  
As engijjshi cë tij,  
Ndo guri cë paçmuom.

Kaha të vjen n dore ty,  
Mbë të madh me e levduom,  
Ndë sqimë e ndë madhështi  
Tinëzot me kundërshtuom?

Lavdin tand të levduom  
Ti pa venë re vetë;  
Ame cote idhënuom  
Kur leve mbë këtë jetë.

Poezia e Budit ndahet në: poezi të rrëfimit biblik, poezi vetjake dhe poezi ngjarjesh të rastit. Poezitë me temë biblike i ndajmë në dy pjesë. Ato deri tek e nënta kanë tema nga Dhiata e Vjetër, kurse nga e nënta deri tek e gjashtëmbëdhjeta tregojnë pasazhe nga jeta e Krishtit. Poezitë që vijojnë janë rrëfejna nga jeta e autorit si dhe ngjarje në rrethana të caktuara historike. Pjetër Budi më 1618 ka shkruar vjershën “I madhi zot, qofsh levduom”.

I madhi Zot, qofsh levduom  
për gjithë kaqë të mirë  
që së kam u’merituom  
me ndonjë shërbetyrë;

q.i. më dheë kaqë hijr  
këtë kafshë me mbaruom  
si q paçë zanë fijll,  
gjithëherë tue shjruom.

Posi mendja më përcill  
nd’ Arbënë me ua dërguom,  
për kishë e për munështjir  
pak ndë mend me i trazuom.

e si zogzitë ndë pyyllt,  
Zoti im me të levduom,  
ndjerë vetë nata byyllt,  
me një zaa t’amlëtuom.

P. Budi ka ngulmuar që gjuha shqipe të futej mirë në praktikën fetare. Gjuha shqipe e veprave të P. Budit është një

gegërishte e mesme me ndikime të gegërishtes veriore të trojeve shqiptare.

### **FRANG BARDHI (1606-1643)**

Frang Bardhi ka lindur në Kallmet të Zadrimës në vitin 1606. Ai rridhte prej një familjeje me tradita. I ungji, Gjergji, ishte ipeshkëv i Zadrimës. Duke parë shprestarinë dhe përkushtimin e Frangu Bardhit ai e mori me vete në Kishën e Blinishtit. Frangu mësimet e para fetare i mori nën kujdestarinë e të ungjit. Më 1628 F. Bardhi studioi në Kolegjin Ilir të Loretos. Vite më vonë, më 1633, vajti në Romë për të studiuar në Seminarin Urban të Propagandës Fide.

Më 1635 Bardhi u dorëzua në gradën priftërore. Po atë vit botoi veprën “Fjalor latinisht-shqip”. Me vdekjen e kryeipeshkvit të Tivarit, Pjetër Mazrrekut, Selia e Shenjtë caktoi Gjergjin. Më 17 dhjetor 1643, ndonëse nuk kishte përfunduar ende studimet e larta, Gjergji e emëroi nipin ipeshkëv të Sapës (Zadrimës). Ceremonia e shugurimit të Bardhit u zhvillua në Romë më 30 mars 1636. Në atë kohë F. Bardhi ishte në moshën 30-vjeçare. Gjatë qëndrimit në Venedik më 1636, Bardhi ka botuar në gjuhën latine veprën “Apologjia e Skënderbeut”. Gjithashtu F. Bardhi ka përkthyer në gjuhën shqipe “Dëshminë e fesë” si dhe “Rendin e Sinodit”, meqë priftërinjtë që ishin në varësinë e tij nuk e kuptonin latinishten. Bardhi u nda nga jeta më 1643, në moshën 37-vjeçare. Libri i Bardhit “Dictionarium latino-epiroticum” është fjalori i parë në gjuhën shqipe dhe përmban rreth pesë mijë fjalë. Ky libër ka pasur këto botime: Më 1932 prej Mario Rok, në Paris, më 1982



nga Engjëll Sedaj, në Prishtinë, më 2002 u ribotua në Shkodër  
“Frang Bardhi dhe leksiku” prej Kolë Ashtës.

**DICTIONARIUM  
LATINO EPIROTCVM**

Una

Cum nonnullis usitationibus loquendi formulis

Per

R. D. FRANCISCVM BLANCHVM  
Epirotam Coll. De Propag. Fide Alumnum

**Parathënia e Fjalorit**

Gjithë atyne t’ arbneshëve qi ta marrënë me e zgjedhunë, e me e zanë.

Tue pasunë ditë e përditë, të dashunitë e mij, mbasi hina ndë Kolehë, kujtuem me qish copë librë keshë me ndihmuem mbënjaanë gjuhënë tanë. Që po bdaretë e po bastardhohetë saa maa parë të ve; e maa fort me ndihmuem gjithë atyne qi janë nd’ urdhënitë Tinëzot e të shintesë kishë katolike; e s’ dijnë gjuhënë lëtime, pa të sijët askush s’ munë shërbenjë si duhetë paa të madh error e faj hesapetë, zakonetë e çeremoniatë e shintesë kishësë Romësë; me ndy jo pak mirë me marrë e me nlërthyem nja librë, qi kaa ndë vetëhe saa emëna janë e gjindenë ndë këtë pkesë shekulli; posikuur me thanë të nierëzet e të shtasëvet e ujënavet e të mallvet e të fushavet e të saa tjera kafshëve, qi gjendenë ndënë qiellt, ende mbë qiellt, posikur të Tinëzot, të engjiet e të shintënet. ....

Prashtu përzinima me këtë fëdigë saa ashtë e sido ashtë, posikur t’ ish kafshë e madhe e vëjjetëshime, e mos u vijnë fështijr

me uruem për mue. Itëni shëndosh prej Rome, dit ndë maaj 30, ndër vietëtë Krishti 1635. Shërbëtori i zotënijsë saaj, unë D. Frangu i Bardhë, shkollar ndë Kolexhë të Shintesë Fee.

Fjalori është i pari libër i botuar nga Propaganda Fides. Të parin fjalor dygjuhësh të gjuhës shqipe, ndonëse me një vëllim kaq të vogël, qeveria socialiste nuk e botoi kurrë, por e censuroi, me pretekstin se ishte ideologji fetare. (*Ledi Shamku-Shkreli, Dictionarium i Frang Bardhit, Shekulli, 28 korrik 2006, faqe 1213*).

Në përbërje të fjalorit Bardhi ka futur edhe 113 Fjalë të urta shqipe. Bardhi ka qenë mbledhës i fjalëve të urta të popullit. Një pjesë e tyre kanë motive Biblike.

## **PJETËR BOGDANI (1625-1689)**

Pjetër Bogdani ka lindur në vitin 1625 në Gur të Hasit në Kukës. Bogdani ka kryer kolegjin ilir të Loretos dhe në vijim më 1655 në Propaganda Fides në Romë, ku u diplomua për teologji dhe filozofi. Pas përfundimit të studimeve u kthye në atdhe dhe filloi të shërbejë si meshtar në Pult. Në moshën 26-vjeçare u bë ipeshkëv i Shkodrës dhe vite më vonë u fronëzua arkipeshkëv i Shkupit.

Në vitin 1685 Bogdani botoi në Padova të Italisë veprën origjinale *Cuneus Prophetarum* “Çeta e profetëve”. Për botimin e librit e ndihmoi një miku i tij, kardinali Barnarigu, të cilit në shenjë mirënjohjeje Bogdani ia kushtoi librin. Në parathënien e librit Bogdani kërkoi prej bashkatdhetarëve që ta ruanin e ta lëvronin gjuhën shqipe si mjetin kryesor të shprehjes kulturore të popullit

shqiptar. P. Bogdani shkruan: “Antikrishtat janë shumë, që veprojnë kundër Krishtit, e luftojnë për të tretun të shenjtin, ligjin e tij. Çdo shpirt që rrënon Krishtin, nuk ashtë prej Tinëzot, e ky ashtë Antikrishti, e ndër ta njihet Neroni, Domiciani, Deci, Valeriani, Muhameti, Surulahi e të tjerë”. Dorëshkrimi i librit të Bogdanit “Çeta e Profetëve”, shkruar që në vitin 1675, ruhet në një nga Arkivat e Dubrovnikut, ku e pati lënë vetë autori përpara se ta niste për botim në Romë. Ky dorëshkrim e paraqet të plotë veprën dhe ka rreth 40% më tepër tekst se libri i botuar në Romë. Gjithashtu hyrja që ka shkruar Bogdani në dorëshkrim është krejt ndryshe nga ajo që ka botimi zyrtar. Studiuesi Nikolla Çollak nga Janieva e Kosovës e ka zbuluar për herë të parë këtë dorëshkrim në vitin 1941. (*Musa Ahmeti, Çeta e Profetëve, Ballkan, 18 shkurt 2004, faqe 28*).

Vepra e Bogdanit “Çeta e profetëve” është ribotuar disa herë: Botimi i N. Mjedës më 1930, botimi i Mark Harapit në vitet 1940-1943, botimet Martin Camajt dhe të E. Sedajt (Prishtinë 1999). Në vitin 1989 me rastin e 300-vjetorit të vdekjes së Bogdanit, në Tiranë u organizua një konferencë shkencore, ku u parashtrua botimi kritik me transkriptimin dhe një studim më i gjerë filologjik e gjuhësor i vëprës së Bogdanit “Cuneus Prophetarum”. Nga mesi i viteve 90, Instituti i Gjuhësisë dhe Letërsisë ngarkoi gjuhëtarën Anila Omari, e cila pas një pune voluminoze 10-vjeçare arriti të sjellë në dritë botimin. Botimi i Anila Omarit përmes transkriptimit fonologjik të tekstit në alfabetin e sotëm përbën një botim kritik lehtësisht të arritshëm për lexuesit. P. Bogdani vdiq në Prishtinë më 1689. Ai është autori më i shquar i letërsisë së krishterë të shek. XVII.

Në Parathënien e librit, të cilën e titullon “Të primtë përpara letërarit”, Bogdani paraqet qëllimin për të cilin shkroi veprën.

### **Të primtë përpara letërarit**

Prashtu dergjetë dheu ndë robil errëtë, e verbuem, me dyy palë niegulla të zeza mbë faqe, qi janë mpkati e të paa dijtunitë, përse u dvuer dieja, e Urtija, e tue kjanë dheu i Arbënit ndë mjedistë t’paa feevet; mirë filli Nierij si të marrë mend e shqisë nuke mundetë me qëndruem ndë hijrtë Tinëzot, as nukë munë shelbonjë paa mos kjanë kush, e ndritën ndë Lijt e ndë Feet, e silla anshtë themeli i gjithë vepëravet miravet. E përse Feeja zinhetë, o dobitetë, me të ndëgjuemit, paa mos pasë kush na mpson, e kallëzon, mundetë kurraj Nierij me ndëgjuem, e me giegiunë.....

Të lutgemi Laterari em i urti të më ndëjeish ndë gjeç fjalëzë, qi të trazon veshëtë. Përëse as Dielli paa hie, as hana, pa njegullazë mbë faqe nukë anshtë; po venë roe kush na ka pushtuem e ndë të kujet dhee jemi ani me zemerë anëko, posi tha Ovid. Lib.3.Elegia I.

Si qua videbuntur casu non dicta latinae  
In qua scribebam, barbara terra fuit.

Fjalët e fundit me të cilat autori mbyll parathënien e librit përkthehen: “Në qoftë se gjuha që kam përdorur nuk të duket latine, kjo vjen ngase shkrova në dhe të huaj”.

Vepra është botuar në dy gjuhë, italisht dhe shqip sepse censura donte të kontrollonte përmbajtjen e saj. Libri ndahet në dy pjesë: në të parën Cuneus Prophetarum “Çeta e profetëve” dhe pjesa e dytë De vita Jesu Christi, Salvatoris Mundi “Mbi jetën e Jezu Krishtit, shpëtimtarit të botës”. Dijetari Bogdani me librin e tij

filozofiko-teologjik “Çeta e profetëve” ka ngritur shumë lart letërsinë agjiografike shqiptare. Pjesa e parë bën fjalë për krijimin e botës dhe për jetën e profetëve, ndërsa pjesa e dytë rrëfen për jetën e Krishtit, mrekullitë, vdekjen dhe ngjalljen e tij. Pjetër Bogdani në librin “Çeta e profetëve”, ka shkruar vjershën “Krijimi i rruzullimit”.

Parëse Qiellja, Dheu, Deti ne Zjarmi  
Ishte: kje Zjarmi, Dheu, Qiellja e Deti.  
Ma shëmpton Qiellja Dhenë e Detinë Zjarmi;  
Se ku ish Qiellja, Dheu, Zjarmi e Deti.  
Aty ish Dheu, Qiellja, Deti e Zjarmi;  
Dheu Qiellnë mbëlon, e Zjarminë Deti;  
Qiellja, Deti ende Zjarmi ishte ndë dhet,  
Dheu, Zjarmi ene Qiellja ishtë ndë Det.

Mbë qiellt nuk ishte as yll, as dielli,  
Qi me dritë të vet xbardhënë dritë të re,  
As hana delte me dy të rgjanta bri,  
As prej qiellshit vinte ndonji reze përdhe,  
As dheu si shqype nalt qëndron e rrij,  
As niegullë me shi, as breshën’ as rrëfe.  
As deti me valë epte të madhe gjamë,  
As lymenatë me breg ishinë zanë.

Në poezinë “Sibila delfica” autori përshkruan vajtimin e Shën Marisë në momentin e kryqëzimit të Krishtit.

Vajtonj un’ e mjera një të madhe gjamë,  
Se Krishnë mbë Kryjt rrafunë e keq shëmtuem  
Shëplaka, grushta, helm’ e ufullë dhanë,  
Përgjegjunë shtatnë plagësh e irënuem

Isr (a) eli mbë dhet keq nukë la pa i banë,  
Patërshanë ende mbë kryjt depërtuem,  
Dvekunës' amëse mbë prehënë ia dhanë,  
Zemërënë tu'i shituem anë e pranë.

Në pjesën e dytë të librit Bogdani ka dhënë në një diferencim të qartë etnokulturor: “Ma mirë me kjanë një keshtenë birij një Turku se me kjanë një Turk, birij një t’keshtenit, posikur me thanë ma mirë me kjanë një lua, i biri një lepurit se me kjanë një lepurë, birij një luani.

### **ZEF SKIROI (1690-1769)**

Zef Skiroi ka lindur në vitin 1690. Pasi kreu studimet teologjike në vitin 1717 dërgohet si misionar në Himarë. Në vitin 1739 emërohet Kryeipeshkëv i Durrësit. Ai botoi në Palermo një përmbledhje të rapsodive shqiptare, të cilat qenë më të dobëta se ato që kishte mbledhur De Rada. Në vitin 1900, Skiroi shkroi vjershën “Vajtimi i Hajdhisë”. (*Faik Konica, Vepra, Naim Frashëri, Tiranë 1993, faqe 118*).

Nani çë dielli i trimëris' u shua  
E miq edhe gjërinj atë vajtojën,  
Sikurse nata mbi ktë jet' u shtrua,  
Rrin' zogëzit ndër gjethe edhe këndojën,  
Të gjithve i duket keq edhe për mua,  
Trimat e vashat lipisi m' dëftojën,  
Se jam e bukur, ndonse kaq e prerë.  
Ajlimano, të mos u kisha lerë!

Mbi ret' o trim, si vidëz e dëlirë,

Shpirti i pafajshim te Parrajsi u hip,  
Ku sos nga dëshërim se ka të mgirë,  
Po nusja jote t'kla tue shkukur krip;  
Të kla gjith' Hora ç'aqë deshe mirë;  
Për ty e male e fusha u vun' ndë lip;  
Të kla edhe lumi te ku u pam'ndë verë,  
Te ku më fole ti të parën herë.

Në Bibliotekën Apostolike të Vatikanit gjenden pesë tekste në gjuhën shqipe, të cilat datojnë më 1767. Autori i tyre është Kryeipeshkvi arbëresh i Durrësit Zef Skiroi. Këto pesë tekste të shkruara në gjuhën shqipe gjenden në “Opera Omnia” me autor Papa Benedikti XIV, botuar në vitin 1767. Teksti i parë gjendet në faqen 81.

### **Scium i Lumuriat**

Te bamet, lavdimet, edhe ato Kyae caa paesuane prae feenae tae Christit robby i tyn Zoti Fidheli caa Sigmaringa na daeftognanae me aft, se ay Kyun caa i ver tet, niraeedhe i besaes ndae sctaepiit tyn Zoti, edhe stolisaenae meta ggith landimet tae Apostollyet. Ktae tae vertet desc vet Zotyn te defton me scegnet Kyae caa baen gner sod prae tae falurit, e prae te luturit atiy vet tae lumurit gnerii. Tasc po duhet, vece saa scnuhet emaeny i tiyh me sceitaenat. Asctu e martenae me mbndemia tae paa diiturat, a sdcu thom paa fare frik. Josefi Schiro Arçbiscupu i Durrsit, edhe Vicar Apostolycu i Hymarrs ndae Abaenit.

Në një relacion të vitit 1729 Zef Skiroi njofton Propagandën Fide që në Himarë u mësonte fëmijëve “Doktrinën e Krishterë”. Vite më vonë më 1739 Z. Skiroi caktohet Vikar Apostolik për Himarën. Imzot Zef Skiroi vdiq më 2 dhjetor 1769 në Romë. (*Musa*

*Ahmeti, Pesë tekste në gjuhën shqipe, të vitit 1767, Ballkan, 18 shkurt 2004, faqe 29).*

## **JUL VARIBOBA (1724-1788)**

Jul Variboba ka lindur në katundin Mbuzat të Kozencës në Kalabri. Mësimet e para i mori në kolegjin e San Benedetos në Ulano. Në vijim ka shërbyer disa kohë si prift në fshatin e vet të lindjes. Në Romë kaloi vitet e tjera të jetës, ku më 1762 botoi vëllimin poetik “Gjella (jeta) e Shën Mërisë Virgjër”, poemë e gjatë në dy pjesë bashkë me një tufë vjershash. Subjekti fetar i kësaj vepre është larguar mjaft nga tradita e krishterë e paraqitjes së figurave biblike, të cilat J. Variboba i ka përshkruar si njerëz të zakonshëm në mjedise vallesh e vajesh të ngjashme me ato të poezisë popullore arbëreshe. Libri fillon me një letër më anën e së cilës poeti i drejtohet Shën Mërisë, për t’i treguar përse ka ndërmarë botimin.

### **Oj e ndeermja Rexhi**

Të vjen somenat mbë tries një pem’ e ree, çë nëng e kee pravuar mai çë kuur jee ndër qiell. Është një çik skallangure, dimërore e e egër, vërtet. Fare duket e bukur si ato të tjerat, që ngaa dit të sjellënë rigaall vashast e tuu. Ma mos u rëfse, oj Zonja e S. Mërii. Pravee edhe këtë, ashtu tu ruat Krishti.....

Me anën e një letre tjetër Variboba u drejtohet lexuesve: nëse vepra nuk u pëlqen, atëherë le ta djegin atë.



## **Oj ti, çë dhiavasën**

Ora mos zë fill nani të qeshënjësh e të qellnjësh dhuun, njota se edhe gjuha arbërisht do të hiinj ndër qiell e të zëër fiil edhe ajo kangjell' e saaj. Kii me bes; nëng është suberie, mangu vakëndari o prosuncion. T'e thom u' nani si qe. Kij misionënt që shtuur ndër deet kaa marinaarrët e që skaftitur kaa një pishk' i math. E brenda ndë barkut këtij pishku, nëng vdiqë, mëngu u lamendua, ma këndoi atë kënk çë priftërat grek kan të fici. Ora mund thom se pata edhe u' ktë fërtun. Qeva për mëkatet mia, jo shtuur në deet, të më hajin pishkit, ma dërguar n' asiil Rom. Atje, In zot më bëri e njoha se ish vollundata e tij, jo të lamëndonesh distinit, si bënëjn graat o të qesh me ata çë qen' kaus, pesë dish propiu Zotiin ashtu për të mirët tim, ma t'' këndonj të S. Mërinj çë atje mëë se gjetk më pat kurr e pruvidencia.

E ashtu pak e ngaa pak, saa duroi nasili, bëra gjith ktë kënk, se të thosha edhe u' si tha Davidi. Bëra pensier se këto rima kan t' i pëlqenjën, në mos t' Arbëreshët, çë së diin jatër art maa miir, mose të qellnjën dhuunë alminu S. Mërijs, përdi mutive; pse esht një kënk ndë një gjuh çë për saa dii u' nëng kaa stampaatur edhe ndonj rim spirituall: e puru pse mbrënda ndë kët kart është dheë dotrina e Krishtit...

E gjgje nani si vate shërbisi? Ti dhiavase: ndë jee divot e të pëlqen rima, zee ala mende e parkales të S. Mërija' edhe për mua. Ndë mos të pariiritit e ti bën një të mir frungullueer e digje, se ashtu alminu ngrohen duart. Të falem.

## **Gjella e Shën Mërisë virgjër**

Oj jet' e ëmbël, o Shën Mëri,  
vjershin e ri ea na mbiso;

si do shurbier, si ti t'pëlkie,  
ti bashk' me ne nga e këndo.

Na ning dimi ti të vandonjim,  
ti të nderonjim si meriton;  
se je fatmirë se na do mirë,  
këta ti thomi, këjo baston.

Cili njeri sa i lart' je,  
sa gracje ke, mund nimëronjë?  
vet'Zoti inë ti di vandinë,  
jatër gjuhë s'di ti këndonjë.

Nd'atë dikret ç'i fjet karta,  
vetëm sa lart ti qeve vënë;  
neve të tjerët të bjerrt', të mjerët,  
gjarpri mëkat na pat ngrënë.

E bër' aposte për Tënëzonë,  
shkele Dimonë, i re pir mort;  
ti vetëm qeve porsa u leve,  
ndi trut'ia ngjoke, ia ngjoke fort.

Jotëm' Shin Ana me Shin Xhajinë,  
fimilë s'kinë e, pjot me lot,  
e shertëruan, e agjëruan,  
ashtu ti bjetin ka Inzot.

Me vute e meshë e raciuna,  
me divuciuna e me hijdhi,  
të kunçipirti, të parturti,  
shin Ana e mirë ndi pjakëri.

Kur ti u leve, e qiell e dhe,  
bëri hare ndir gjith' kundrat;  
haret' i solle kur ti dolle,  
dolle si dielli e pamëkat.

Tri vjet u mbille ndi një kuvend,  
bëre kutiend ti Tinëzon;  
i dhe një lule, një trëndafille,  
i dhe të virgjrit ç'i lulëzon.

Andaj Zotinë tij t'u prejar,  
t'u namurar e mir' të dish:  
e të bekoi, të shëjtëroi,  
e shpirti kur min t'e bëri kish''.

Nj'ëmgyjll aposti të suall mbashatën,  
të suall uratën ndi kit modh';  
-o e lumja grua, Ti si e thua?  
ti Zoti in' për em' të zgjodh.

Ti rispëndove:-U'jam e virgjër  
si një e virgjër mund jetë emë?  
këjo mbashatë ning është' uratë;  
pir një të virgjër është' më se nëmë.

Ëngjëlli foli: -Jo, se Zotin'  
tek vete hin, ning e danon.  
virgjitatet e puritatet;  
tek më e nget, më e ngjaron.

Si pasikiri tek dielli hin,  
ai ning e nxin, e dritëson.  
mos kij pahur, mos kij timur:  
vet' Shpirti shënjt' vjen e të mbjon.

Vepra “Gjella e Shën Mërisë Virgjër” përbëhet prej dy poemash: e para titullohet “Gjella e Shën Mërisë” dhe e dyta “Gjella e Shën Bambinit”. Ndërsa në pjesën tjetër të librit autori ka përmbledhur disa vjersha shpirtërore. Në poemën “Gjella e Shën Mërisë” trajtohen aspekte nga jeta e Hyjlindëses deri në momentin e lindjes së Krishtit. Ndërsa në poemën “Gjella e Shën Bambinit” përmenden aspektet më të rëndësishme të jetës së Krishtit, më pas vijon tradhëtia, kryqëzimi dhe pësimet. Poema përfundon me vajtimin e Hyjlindëses për birin e saj. Ky libër i Jul Varibobës është një ndër veprat e para artistike të poezisë shqiptare që është shkruar në variantin e arbërishtes. Shën Mëria paraqitet si simbol i mëshirës dhe i përdëllimit, ndërsa figura e Krishtit tregohet si një Mesi i vërtetë. Variboba është përfaqësuesi kryesor i letërsisë së vjetër arbëreshe që lëvroi temën fetare për qëllime kishtarë dhe mësimore. (*Jul Variboba, Gjella e Shën Mërisë virgjër, Tirana Observer, 16 prill 2006, faqe 28*).

## Vajtimi i djalit

Bir, si të vranith?  
Mua ku më lanith?  
Si s'të pan'lipisi?  
Si stë ndihu mosnjeri?  
Bir, si të furnuanith!  
Ku të vate ajo belic'?'  
Çë më jip aq llogric'?'  
Ruaj si të nxjtin, shih si të pështjtin;  
Si të bën, bir o  
Gjith qag', mjera u, o!  
Ka t'ert' kjo kuror,  
Kush' t' e their atë dor?  
Këto këmb' të ngriqësua  
Cila gozdh t'i la të shpuara?  
Edhe zemërën t'e shpuan,  
Me një llënx t'e zbuluan!  
Oj bir, sa pen'!  
Mirrëm mua me vet-hen.  
Pa bir u si të rronj,  
Këtë thik u si t'e duronj?  
Me tij, bir, dua të shihem,  
Ndë ktë varr dua të mbëllihem.

Dhimbja e Hyjlindëses për Krishtin është e madhe. Për ta bërë sa më jetësor vajtimin, Variboba merr motive nga vajtimet e nënave arbëreshe. Kjo shprehet në vargjet:

Afër kriot sot rrij e qaj  
E bën një vaj sa gurët thien,  
Ruam të bir çë duaj mir

E me gjakt lot' ti përzien.

Pjesa e fundit e librit përmban vjersha me karakter shpirtëror, të cilat ndonëse nuk kanë lidhje midis tyre i bashkon tematika fetare që ato mbartin.

## **PERIKOPEJA NGA UNGJILLI I PASHKËVE (shek. XV)**

Një perikope nga Ungjilli i Pashkëve është dokumenti më i vjetër që kemi për përdorimin e gjuhës shqipe nëpër shërbesat fetare. Dokumenti gjendet brenda një dorëshkrimi greqisht në Bibliotekën Ambroziana të Milanos dhe i përket shekullit XV. Ai përbëhet nga tri pjesë të ndryshme: 1- Një pjesë e Ungjillit të Matheut 27:62-66 (është pjesë nga Ungjilli i mëngjesit që këndohet të Premten e Madhe gjatë shërbesës së Epitafit), 2- urimi “për shumë vjet o Kryezot” 3- Himni i Pashkëve “Krishti u Ngjall”.  
*(Dhimitër Beduli, Gjuha shqipe në kishë, Tiranë 1999, faqe 8-9).*

Ndonëse teksti është shkruar me alfabetin grek, ky dorëshkrim përbën dokumentin e parë në toskërishte. Në faqen A është shkruar:

1. pri Shin Matthe
2. Ungjill... Evag shintë e premtë e madhe.
3. E më nesër-që nesër-që ishte më premtë, u mb-
4. Lodhi e priftërij edhe farisej e thanë Pilatit:
5. Zot, kujtuam se ai u plan, edhe kur kje gjall
6. Tha se per tre dit prieremi. Urdhëro
7. Ashtu, (i) nqiellshmi zot, t' u mblidhet varri, mos pi-
8. qej e vinin nate, ai avtu mathitai e vjedhin
9. ata: pra thon (ë) lausi se u ngre së vdekurit.

10. E ishtë ma kejq se prapa, e keqja, se para.

11. Pra, tha Pilati: kini kustodi, prini, mbi-

12. Li varrën si e pat, sfragjisni gurin me të

13. Gjithë kustodie.

Shum vjet, Zoti nun.

Ndërsa në faqen B kemi urimin e pashkës:

Krishti u ngjall së vdekuri, mortje mortnë e shkejli (i), e ata që janë ta varr (i) gjellna u dhuro (i).

Në shkrim përdoret alfabeti grek, ndonëse nuk i është përshtatur mirë tingujve të shqipes. Dokumenti është një fletë me format 15x13.5cm, brenda kodikut me format 23.3x15.3. dhe u zbulua më 1906 nga Spiridon Lambros, i cili e botoi në revistën *Neos Elinomnimon* të Athinës. (*Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe, Tiranë 1976, faqe 39*).

Më vonë u transkriptua nga episkopi i Korçës Evllogjio Kurila, i cili pretendon se është i Grigor Gjirokastritit. Studiuesit mendojnë se autori ka qenë një prift shqiptar i ritit lindor. Në të vërtetë teksti është një përkthim nga greqishtja në shqip. Për ta kuptuar më mirë tekstin, po japim përkthimin e Kostandin Kristoforidhit:

Edhe ndë të nesërmenë, qi ashtë mbas të prendesë, u mblotnë kryepriфтënit, edhe Fariseitë te Pilati, tue thanë, Zot, na ukujtue, se ai gënjeshtari tha; kur qe gjallë; se mbas tri ditsh kam me ungjallë. Urdhëno pra të ruhet vorri deri mbë të tretënë ditë, se mos vijnë dishepujt' e ati natënë edhe e viedhinë, edhe i thonë popullit, se u ngjall prej së vdekurish; edhe ka me qenun' e mbrëpmëja gënjeshtërë ma e keqe se e para. Edhe Pilati u tha atyne.

Keni ruejtësa shkoni, e siguroni-a sit a dini. Edhe ata voitnë, e siguroenë vorinë; tue vulosunë gurinë, bashkë me ruejtësat.

Perikopeja nga Ungjilli i Pashkëve është dokumenti i parë i shkruar në toskërisht. (*Tomor Osmani, Udha e shkronjave shqipe, Shkodër 1999, faqe 19-20*).

## **ANONIMI I ELBASANIT (shek. XVII)**

Anonimi i Elbasanit është një dëshmi tjetër, e cila mendohet të jetë e shekullit XVII dhe u gjend në vitin 1949 në Manastirin e Shën Gjon Vladimirit në Elbasan. Ajo përbëhet nga pjesë të të katër ungjijve, shkruar me një alfabet të veçantë dhe është përdorur për nevoja liturgjike. Teksti nuk e përmend emrin e autorit dhe vitin e shkrimit, prandaj u emërtua si anonim. (*Tomor Osmani, Udha e shkronjave shqipe, Shkodër 1999, faqe 93*).

Përkthimi është i lirë, në të folmen e Elbasanit dhe ka pak fjalë të huaja. Gjuha është më arkaike se ajo e Dhaskal Todrit. Dokumenti i përket gjysmës së dytë të shekullit XVII dhe në të ndjehen ndikimet e toskërishtes. Alfabeti i përdorur është i panjohur më parë, me 40 shkronja me bazë glagolitike dhe është alfabeti orgjinal më i vjetër që njihet në shkrimin e shqipes. Ai mund të jetë diçka origjinale ose nga ndonjë traditë e humbur për të cilën ne nuk kemi dijeni. Alfabeti i përdorur ka më tepër bazë sllave sesa greke. Nga gjuha e dorëshkrimit kuptohet që ka qenë njeri i ditur. Kjo vepër prej gjashtëdhjetë faqesh u shpëtua nga studiuesi elbasanas Lef Nosi, atëherë kur manastiri i Shën Gjon Vladimirit u dogj më 14 mars 1944. Në tekst gjendet i shkruar emri i një kleriku,



Papa Totasi, i cili ishte prift i Shpatit dhe ka jetuar në shekullin XVII. (*Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe, Tiranë 1976, faqe 92*).

### **Anonimi i Elbasanit**

Transliteruar nga Robert Elsie

Të shenjtënuashimenë të premtën e madhe. O të bekuam të kërshenë. Thiri Krishti zoti ynë apostujtë e ju dëftoi atë ditë qi donte të të kryqëzohej, e ju tha: o bijt e mi të dashun, ta dini se pas dy diç bahetë pasxa e atëhere dua të epem të më kryqzonjënë. Atëhere u mbëlodhnë upeshkëpinjtë e letërorëtë ndë sarajet të Kaijafësë upeshkëpit e kuvënduanë shoq me shoq qi ta zanë çefun Jisunë ta vrasënë. E thoshin: mos e zamëte njëme më ditë të kremtesë se ishte e shëtynë se mos bahetë të përziem ndë gjin qe duan e na mbodhisnjënë se aqë qe duan e na mbodhisnjënë se aqë prej cë perëndisë deshmë.

Ta xanë Xrishnë ditën e pashkëvet qi donjinë të hanjinë qegjnë qi të ju dëvtet një se zoti Xrisht është qengji i vërtetë qi donjënë të thernjënë çifutëtë më kryqt. Atëhereza Judha një 12 apostoj shë qi ishte kusar ergjandashur nëgjoj se bujarëtë ishinë ndë sarajet të Pilotit Kaijafë së mbëledhun, vu ndër men të ve një të ju apë Xrishtnë, e vote ndë ta ju fal e jut ha: o qoftë i lavduruam perëndia o bujarë qi me driti sot e e gjofta se jam rrenë më dhidhaskalit të Krishtit, e prand i psua i mirë qi jam i Mosiut e i profitëvet.....

## GRIGORI I DURRËSIT (1701-1769)

Mitropoliti i Durrësit Grigori mendohet se ka lindur në vitin 1701 në Voskopojë. Ai studioi në “Akademinë e re” dhe më vonë u bë profesor i saj. Më 1740 qethet murg në Venedik, ku mësoi zanatin e tipografisë prej shtypshkruesit venedikas Nikolaos Glykys. Në vitin 1744 Grigori ka themeluar shtypshkronjën e Voskopojës, të cilën e ka drejtuar deri në shkatërrimin e saj më 1764. Kjo shtypshkronjë u soll nga Venediku, ku mjeshtrat shqiptarë mësuuan tipografinë. Shtypshkronja e Voskopojës ka shtypur 14 akoluthi, të cilat janë përdorur për nevoja liturgjike.

Ja dhe disa shkrime që u botuan në këtë shtypshkronjë: “Akoluthia e Shën Nikollës” (1712), “Akoluthia e Shën Theodorës” (1731), “Akoluthia e Shën Harallambit” (1734), “Akoluthia e Shën Serafimit” (1735), “Akoluthia e Shën Naumit” (1740), “Akoluthia e pesëmbëdhjetë martirëve” (1741), “Akoluthia e Shën Klementit” (1741), “Akoluthia e Shën Gjon Vladimirit” (1742), “Akoluthia e Shtatë Shenjtorëve” (1742), “Letër baritore e patrikut Joasaf të Ohrit” (1742), “Akoluthia e Shën Visarionit” (1744), “Akoluthia e Shën Antonit” (1746), Kostandinos Hagionaumites, “Katekizëm” (1746), Leonardo Lombardi, “E vërteta si gjykatës” (1749), Teodor Kavalioti, “Oktaikos” (1750), Meletios Pegas, “Doktrina fetare” (1769).

Mitropoliti i Durrësit Grigori ishte klerik me kulturë të gjerë dhe autor i librave të ndryshëm fetarë. Studiuesi Zabiras mendon se Grigori ka shkruar një akoluthi të Shën Naumit, ka hartuar parathënien dhe megalinaret në akoluthinë e Nikodhimit, etj. Nga formulat që gjenden në ballinat e veprave, Grigori përmendet për herë të parë në vitin 1731 si “më i dituri dhe më i nderuari murg klerik”, ndërsa prej vitit 1740 shfaqet si prift dhaskal

(hierodhaskalos). Prej të dhënave të fundit kuptojmë se ai ka dhënë mësim në “Akademinë e Re”. Grigori ka përkthyer në shqip Dhiatën e Vjetër dhe të Re, duke përdorur një alfabet të shpikur nga ai vetë para vitit 1772. Përkthimet e tij fatkeqësisht kanë humbur. Pas suprimimit të Patriarkanës së Ohrit më 1768, ai u caktua nga Patriarkana Ekumenike e Kostandinopojës si Mitropolit i Durrësit. Grigori mendohet të ketë vdekur në Venedik më 1769. (*Max Demeter Peyfuss, Shtypshkronja e Voskopojës, Vienë 1996, faqe 92-93*).

## **NEKTAR TËRPO** **VOSKOPOJARI (shek. XVIII)**

Nektar Tërpo Voskopojari ka nënshkruar në një gravurë të gjetur në Manastirin e Ardenicës. Në të është shkruar një lutje e shkurtër drejtuar Hyjlindëses në katër gjuhë, greqisht, latinisht, arumanisht dhe shqip. Gravura ka këtë tekst në shqip të shkruar me alfabetin grek: “Virgjin Mamë eperëndis uro për nee fajtorëte”. Në gravurë paraqitet Shën Mëria me Krishtin e vogël ndër duar. Ajo daton në vitin 1731 dhe poshtë saj është nënshkrimi i Hieromonak Nektarit. Bëhet fjalë për Voskopojarin Nektar Tërpo, një propagandues i zellshëm dhe i guximshëm i besimit ortodoks, i cili në atë kohë ishte igumeni i Manastirit të Ardenicës.

Hieromonaku Nektar Tërpo Voskopojari ka lindur aty nga fundi i shekullit të 17-të në qytetin e famshëm të Voskopojës. Ai renditet në listën e intelektualëve të shquar të Akademisë së Voskopojës. Pas studimeve vajti në Malin Athos duke përqafuar jetën monakale. Vite më vonë e gjejmë në Manastirin e Shën Naumit dhe më pas në Manastirin e Ardenicës. Në korrik të vitit 1724 turqit e arrestuan në fshatin Dragot në afërsi të Elbasanit dhe e

rrahën keq, sa ngeli me dorën e majtë të paralizuar. Vitet e fundit të jetës së tij i kaloi në Venedik, ku edhe ndërroi jetë. Ndonëse të dhënat në lidhje me jetën e tij janë të pakta, megjithatë kanë mbetur dy vepra të shkruara prej tij. E para titullohet “Çështje të ndryshme teologjike” me pyetje e përgjigje nga veprat e Vasilit të Madh. Ky ngjan më tepër me një libër katekizmi. Për të grumbulluar dhe sistemuar materialin e këtij libri atij iu deshën dhjetë vjet punë, nga 1720-1730. Vepra e dytë e Hieromonakut Nektar Tërpo Voskopojari titullohet “Besimi”, është botuar në Venedik në vitin 1732 për të ndaluar islamizimin e popullsisë ortodokse. *(Imzot Joan Pelushi, Një vështim i shkurtër historik mbi përkthimet fetare në kishën ortodokse në Shqipëri, Tempulli, Nr 2, Korçë 2000, faqe 11).*

### **THEODHOR HAXHIFILIPË (1730-1805)**

Theodhor Haxhifilipi, i njohur me emrin Dhaskal Todri, ka lindur në Elbasan. Ai ka studiuar në Akademinë e Voskopojës. Më vonë e gjejmë në Elbasan si mësues dhe predikues. Ka bërë përkthime të shumta fetare duke përkthyer shqip Dhjatën e Vjetër dhe të Re dhe Liturgjinë e Shën Joan Gojartit. Gjatë përkthimit të Liturgjisë ka ndjekur fjalë për fjalë tekstin greqisht duke mos e përshtatur si duhet në gjuhën shqipe. Pjesa më e madhe e shkrimeve të tij u dogj pas epidemisë së kolerës të vitit 1827. Prej tyre shpëtoi Liturgjia e Joan Gojartit, e cila ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit në një kopje të mëvonshme të kopjuar nga igumeni i Manastirit të Shën Gjon Vladimirit, Haxhi Josifi. Liturgjia e Joan Gojartit u botua në revistën “Kopshti Letrar” në Elbasan. Alfabeti i përdorur nga Dhaskal Todri pati jehonë të madhe kudo dhe menjëherë filloi të

përdorej jo vetëm nëpër shërbesat fetare dhe shkolla por edhe në jetën e përditshme të tregtarëve elbasanas. Alfabeti i Theodor Haxhifilipit luajti rol të rëndësishëm për përhapjen e gjuhës shqipe nga fundi i shekullit XVIII e deri në fillimet e shekullit XIX dhe për zëvendësimin e greqishtes me gjuhën shqipe. Konsulli austriak në Janinë, albanologu Johan Georg fon Hahn (1811-1869), u entuziazhua shumë kur me ndihmën e Kostandin Kristoforidhit u zbulua alfabeti i Dhaskal Todrit. Gjithashtu Dhaskal Todri ka përkthyer edhe Librin e Orëve.

Dëshira e Dhaskal Todrit ishte që të ngrinte në Elbasan një shtypshkronjë ku të shtypeshin libra në gjuhën shqipe. Me ndihmën e tregtarëve elbasanas dhe voskopojarë shkoi në disa vende të Evropës për të derdhur shkronjat e alfabetit të tij. Gjatë kthimit prej Manastirit në Dhianat të Rënjës u vra nga qiraxhinjtë.

### **KOSTANDIN BERATI (1745-1825)**

Kostandin Beratit i përket një dorëshkrim që gjendet në Bibliotekën Kombëtare. Ai përbëhet nga 152 faqe, ku në 46 faqet e para janë të përkthyer shqip me alfabetin grek lutje të ndryshme fetare dhe pjesë ungjillore që përdoren në shërbesat liturgjike, ndërsa në faqen 106 ndodhet një alfabet origjinal me bazë glagolitike prej 37 shkronjash. Gjithashtu në të gjendet edhe një vjershë me dyzetekatër vargje e titulluar “Zonja Shën Mëri Përpara Kryqësë”, dy glosarë greqisht-shqip me rreth 1710 fjalë si dhe shënime të ndryshme me karakter fetar, ngjarje të ndodhura midis viteve 1764-1789. Përkthimet e tij nuk patën përhapje të madhe sepse nuk mundën të botoheshin. Studiuesi Ilo Mitkë Qafëzezi është

marrë me transkriptimin e dokumentit dhe e pagëzoi me emrin “Kodiku i Kostandin Beratit” që i përket vitit 1764. Ky dorëshkrim pasqyron përpjekjet për përdorimin e gjuhës shqipe në shkolla dhe në shërbesat fetare. (*Tomor Osmani, Udha e shkronjave shqipe, Shkodër 1999, faqe 104*).

### **Zonja Shën Mëri përpara Kryqësë**

Zonj' e Shën Mëri ardhurë,  
E mbretëresh' e engjëjjet,  
E kur e pa mbërthyerë,  
E qante ngashëryerë,  
Judha i mallëkuarë,  
E erdhë e të rrëmbyenë,  
Të shpunë të të gjykonjënë,  
Qiturë shahit jallanxhi,  
Të ndyninë e të pshtyninë,  
Me të math zë thërrisinë,  
Vallë ç' u pate bër' o bir,  
Që mbë kryq të mbërthyenë,  
O biri im i dashuri,  
Qysh i duron mundimetë,  
E ndenj përpara kryqsë,  
Zonjë e gjithë dynjasë,  
Shpëtimn' e njerëzisë,  
Me mallëngjim thërriste:  
Që kallëzoi çifutë,  
Si uqër të pandieshm,  
Ndë avlli të Pillatit,  
Që të turpërojnë,

E të rrah e të shanë,  
Atij Pillatit: vra-e!  
A ç'të lig u punove,  
E vdekë që të dhanë,  
E djali im i ëmbli  
Rrahur'e përçmuarë.

Në vjershë përshkruhet tmerri që ndiente Zonja Shën Mëri në momentin që pa të birin të mbërthyer në kryq. Vjersha është përkthyer nga greqishtja. Autori i saj është Akakios Diakusis nga Qefalonia, i cili e ka botuar në vitin 1730.

## **KREU I DYTË**

### **LETËRSIA E RILINDJES KOMBËTARE**

#### **(1800-1912)**

Letërsia e Rilindjes kombëtare (1800-1912) lindi dhe u kultivua si pjesë e pandarë e lëvizjes për çlirimin e vendit nga skllavëria osmane. Tema kryesore e saj është atdhedashuria, prandaj kjo letërsi ka karakter të theksuar patriotik. Përfaqësuesit e letërsisë së Rilindjes kombëtare janë frymëzuar prej përpjekjeve të popullit shqiptar për pavarësi dhe ruajtjen e sovranitetit kombëtar nga synimet e fqinjëve. Në veprat më të mira u shpreh krenaria për të kaluarën e lavdishme të popullit shqiptar dhe ëndrra për ta parë Shqipërinë të lirë. Pionierëve të letërsisë së Rilindjes kombëtare u është dashur të luftonin me armiqtë, ata duhej të bënin shkrimtarin, dijetarin, patriotin dhe prijësin e kryengritjes popullore. Autorët më të shquar kanë qenë: Naum Velqiharxhi, Jeronim de Rada, Kostandin Kristoforidhi, Zef Serembe, Petro Nini Luarasi, Çajupi etj. Letërsia e Rilindjes kombëtare shënoi kalimin nga letërsia me përmbajtje fetare në letërsi artistike duke hedhur bazat e kultivimit të gjuhës letrare shqipe, ndonëse përfaqësuesit më në zë të saj



kanë jetuar në mërgim. Megjithatë në krijimet e tyre i këndohet gjuhës së bukur shqipe dhe bukurive natyrore të vendit tonë.

Përfaqësuesi më i denjë i kësaj letërsie është Naim Frashëri, i cili njihet si poeti më i madh i letërsisë shqipe duke themeluar lirikën moderne. N. Frashëri më 1886 ka shkruar poemën “Bagëti e bujqësia”, më 1890 përmbledhjen me lirika të titulluar “Lulet e verës”, poemën religjioze “Qerbelaja” më 1898, e cila njihet si eposi i bektashizmit. Moikom Zeqo thekson se bektashizmi naimjan ishte në harmoni me romantizmin dhe kombëtarizmin laicist të tij. Qe një formë origjinale e harmonizimit të dy feve të mëdha: krishterimit dhe bektashizmit dhe në kohën e sotme quhet ekumenizëm. Naim Frashëri ka shqipëruar një perikope ungjillore (Gjoni 8, 1-11) dhe ka krijuar vjershën “Përpara Krishtitë”, të cilit i drejtohet me fjalët: -Djalëth, njeriu i Perëndisë.

### **NAUM VEQILHARXHI (1797-1846)**

Naum Veqilharxhi ka lindur më 1797 në Vithkuq të Korçës. Që herët emigroi në Rumani, ku mori pjesë në revolucionin rumun të vitit 1821. Veprimtarinë atdhetare e nisi me hartimin e një alfabeti original të gjuhës shqipe me 33 shkronja. Me këtë alfabet N. Veqilharxhi hartoi abetaren e parë për mësimin e gjuhës shqipe. Në vitin 1845 botoi “Evëtarin” dhe një vit më vonë më 1846 botoi “Fare i ri evëtar për djelm nismëtar”, të cilin e shoqëroi me një parathënie për djemtë e rinj shqiptarë.

Librat e N. Veqilharxhit u pritën me entuzjazëm nga patriotët shqiptarë brenda dhe jashtë Shqipërisë. Më 1846 Veqilharxhi botoi

“Enciklikën”, me të cilën kërkoi t’i jepej rëndësi mësimi të gjuhës shqipe dhe kulturës kombëtare. Ai i kërkoi Patrikut Ekumenik që të përktheheshin librat e shenjtë në gjuhën shqipe dhe u bëri thirrje bashkatdhetarëve që të mësonin gjuhën shqipe e të përhapnin dituritë pa pasur dallime fetare. N. Veqilharxhi u bën thirrje bashkatdhetarëve që të kenë guxim: “Le të hedhim farën e mirë dhe me siguri vetë natyra e shenjtë e ngjarjeve do të na ndihmojë për gjallërimin, mbirjen dhe rritjen e saj, pemët e bukura dhe shumë të ëmbla të së cilës do t’i korrë padyshim brezi i ardhmë që do të bekojë ata bujq dhe mbjellës të mirë”. N. Veqilharxhi vdiq në rrethana të dyshimta (i helmuar) më 1846 duke qenë dëshmori i parë i Rilindjes kombëtare.

### **Parathënie për djemtë e rinj Shqiptarë**

Më të mirën gjë që njohu e që kuptojti... njeriu ish të mësuarit. E po që pat kujdes ee gjet, iu pushtua më gjit shtrënguarë. E veç që me kohë dualën kaq burra të ditur e të tërë ndriçim oa edhe njerëzit zunë të dalin nga t’egërit e tyre, që patnë pasur që herje, e të hapën e të thellojnë mendjen sikundër duket se mbë ç’qëndrim të qyteçmë arriti.

Se të mirën e çdo njeriut, q’e sjell drita e të mësuarit, s’është asnjë e ndëdyshme; se njohëm që gjithë farët e çdo njerëzve mundohen pareshtur si të mundnjënë të ndërtojnë e të shtojnë gjuhën e tyre edhe të mësuarit.

Por fort për të çuditur është që si ne shqiptarët jemi kaq të ndarë e të pangjajmë farëvet të tjera, pa pasur fare të shkruar e të kënduar mbi gjuhën tënë. Si ka duruar kjo dora e shqipëtarit të jetë mbetur ndënë të qeshurit e botësë huaj?...

Fjala ime, o djem s'është sepse s'patmë të shkruame mbë gjuhë tënë, mbetmë pa shkruar gjuhë të tjera. Dihet se nxinim edhe punoheshim jo mirë. Po ç'fitim, që vetëm fort pakë kishim e kanë fat shumica tjetër dergjet nd'errësirë të padijes e vetë dinin e njihnin se ç'hiqnin. Fare lehtë mund secili të njohë lehsimnë që ka çdo farë e njerëzve të mësojnë të mësuarit mbë gjuhë të vet.

### **JERONIM DE RADA (1814-1903)**

Jeronim de Rada ka lindur më 19 nëntor 1814 në një katund të vogël të Kalabrisë të quajtur Macchia Albanese. Pasi kreu kolegjin e San Benedeto Ullanos, studioi për drejtësi në Universitetin e Napolit. Në vitin 1836, kur ishte 22 vjeç, botoi “Milosaon”, librin e tij të parë. Milosao është një përrallë historike me vjersha në gjuhën shqipe. Jeronim de Rada e arriti kulmin e krijimtarisë së tij në vitin 1866 kur botoi në Firence “Këngët e Milosaos”. Ky libër përmban rapsoditë më të bukura shqiptare, të cilat autori i kishte mbledhur në kolonitë shqiptare të Kalabrisë dhe të Napolit. Këto këngë i patën sjellë me vete të shpërngulurit (arbëreshët) dhe u transmetuan gojë më gojë nga brezi në brez për katër shekuj. Sipas Moikom Zeqos kemi disa variante të Milosaos. Varianti pëfundimtar përmban 40 këngë, të cilat datojnë prej 27 korrikut 1435 deri më 7 nëntor 1443. Ndërmjet “Këngëve të Milosaos”, Jeronim de Rada në libër ka përfshirë edhe disa vjersha, të cilat quhen “Graxeta”. Këto këngë këndohen prej grave. Në këngën e fundit përmendet që Milosao ka vdekur më 7 nëntor 1443. (*Moikom Zeqo, Kombkrijuesi dhe emërshenji De Rada, Ballkan, 20 shtator 2006, faqe 16*).

Më 1840 botoi poemën “Serafina Topia”, e cila më tepër se një himn dashurie është një himn për bashkimin e shqiptarëve. Gjatë viteve 1847-1848 botoi “Rrëfimet e Arbrit”, e cila përbëhet nga katër novela romantike. Më 1861 botoi “Parimet e estetikës”, më 1864 “Lashtësia e kombit shqiptar” dhe më 1866 “Rapsodi e një poeme arbëreshe”. Veprën e fundit Jeronim de Rada e shkroi në vitin 1900 në moshën 86 vjeçare. Gjatë krijimtarisë së tij 69 vjeçare, Jeronim de Rada ka botuar shkrime të panumërta në shqip dhe italisht. Zemra e tij nuk reshti së shkruari për Shqipërinë dhe shqiptarët. Gjithsesi duhet theksuar se gjuha me të cilën shkruante Jeronim de Rada është shqip vetëm nga rrënja e fjalëve. Jeronim de Rada u martua më 1850 me arbëreshen Madalena Melkji, me të cilën pati katër djem. Fatkeqësitë familjare, vdekja e gruas dhe e djemve nuk e mposhtën atë, por dhimbjen e ktheu në forcë duke vazhduar veprimtarinë krijuese. Në këtë kohë shkroi poemën “Skënderbeu i pafat”. Jeronim de Rada pasi kaloi një pleqëri të vështirë vdiq në Shën Mitër Koronë më 28 shkurt të vitit 1903. Faik Konica në veprat e tij shkruan: “Ata italianë që i thonë vetes “italo-albanesi”, sado e përdornë e do ta përdorin emrin e qëruar të Radës për qëllimet e tyre, nuk patnë as mendimin të mbledhin një ndihmë për plakun e mjerë, i cili e shkoi pleqërinë në mëshirë e në vatrë të huaj. Thonë se janë 200 000 mijë, e të gjithë atdhetarë. Në janë aq e ashtu, sikur të kishin dhënë nga 5 para njëri, Rada i ngratë s’do të kish vuar aqë të liga në pleqëri”. (*Faik Konica, Vepra, Tiranë 1993, faqe 78-79*).

### **Rapsoditë Kombëtare**

Sapo kisha kryer kolegjin e Shën Adrianit në korrik të 1833, më erdhi një letër nga Rafael Valentini (i cili më vonë,

shumë plak u bë dhe kryetari i pushtetit ekzekutiv të kryendritësve të Kalabrisë, më 1848). Në atë letër ai më kërkonte këngët popullore të kolonive tona. Atëherë unë shkova në Shën Kozmo, tek gjyshja ime, nëna e nënës, dhe atje, një plakë e ndershme, Tortoshëlja, më tha të parat, dhe midis syresh atë të Deli Skurës, të Milo Shinit, të Rada Vanit. Pastaj u ngjita në Shën Mitër te krushka Oricia, nga shtëpia e Strigarëve, e moçme mbi nëntëdhjetë vjeçe, dhe prandaj s' mbante shumë mend. Ajo më mësoi këngën: *Ra turku po ku ra!* e të tjera përgjysë.

Ndërkaq veja të pyesja gratë e katundit tim dhe prej tyre mblodha nja njëzet. Nga kuvendimi me vajzat dhe nga mënyra e thjeshtë e të thënurit të atyre këngëve, lindi historia dhe paraqitja siç është sot e sajimit të Milosaos. Këngët e mbledhura i dërgova në Kozencë. Më 1845 më gjeti në Napoli Kamarda dhe më tregoi një dorëshkrim me nja 15 këngë, që e kishte gjetur në kolegjin shqiptar të Palermos; këto ai pak i kuptonte, se ishin të dialektit sicilian; por unë sapo i lexova, zbulova menjëherë se ishte gjuha e vendeve tona. Do të thoshja se do të ishin të gjitha të zgjedhura e të lidhura në More, midis syresh po përmendim: “Dual e bukura në derë”, “Te qyteti i Napolit”, “Rrezes së përmallshme” etj. I kopjova e i bashkova me të tjerat. Vitin tjetër njoha Herman Kestner nga Hanovra që mblidhte këngë popullore të vendeve të ndryshme dhe donte dhe nga të miat. Shpirti guximtar dhe freskia e re e tyre iu duk atij se qenë më të mira nga të gjitha ato që ai njihnte. Dhe më nxiti që t' i nxirrja në dritë që t' i njihnin dhe të tjerët.

Pesë vjet më parë Luigj Petrasi nga Çerxeto (Qana) më kish dërguar tri këngë me vërtet të zgjedhura. Dhe një vjet më vonë erdhi në Napoli Anxhelo Bazile nga Plataçi dhe më solli të tjera: atë të Pjetër Shortit, ato të dasmës të plota dhe të besës së

madhe të Kostandinit, të cilat nuk i kisha. I rregullova dhe i përktheva italisht. Pastaj më ndodhën halle të njëpasnjëshme dhe më penguan t' i nxirrja në dritë. Kështu, kur unë e lashë Napolin me zemër të copëtuar, i prisha ose i hodha poshtë bashkë me të tjerat, pa vërejtur edhe këtë dorëshkrim, i cili kështu u zhduk.

Kur u ktheva në vendlindje, siç më kishin porositur, atëherë më ra ndër mend, kërkoja copat e letrave nga kisha nxjerrë materialin e atij libri, por një pjesë e mirë kishin humbur dhe në mes atyre kënga “këndova e zgjova zotninë tim”. Kopjen e kësaj shpresoja ta kishte Kestneri, të cilit ia kisha dhënë. Më duhesh atëherë të shkoja në Shën Sofi dhe prej një plake me mbiemër Xhibia dëgjova pesë a gjashtë të tjera dhe nuk e di në se një popull tjetër të ketë të tilla si: “Mbre i biri i Fugës”, “Ngritën një shtatore”, “Të gjitha vala i nxuar mb’an”, “Bie shi e borë” etj. Pastaj një grua nga Perçilota më mësoi në mënyrë të përpiktë këngën aq të bukur “Kur linde, linde ti, vashë”.

Më së fundi kisha edhe disa që i kishte mbledhur frati Anton Santori nga kolonitë përtej Kratit; por më duhej që t’u hiqja pjesët e shëmtuara, duke u ndihmuar nga shembulla të tjera që kisha edhe prej disa pjesëve që më kujtoheshin se u këndonte te djepi zonja mëmë vëllezërve të mi. Kështu dhe nga plaka mëndeshë, që ne duke qenë të varfër na rriti për mëshirë, më kujtohej kënga: “Ligjëroi plaka me malin”.

Por duhet të jenë edhe të tjera në vendet tona që ende s’janë harruar, prandaj unë lus të gjithë ndihmonjësit e kësaj të përkohshme që t’i mbledhim kudo që të kenë mbetur të pa vëna re; kështu që puna ime të plotësohet nga duart e tyre; sepse ky është një trashëgim i shkëlqyer që na përket të gjithëve ne. Në vitin 1866, mbasi ato që kishim i rregullova së bashku me Nikolla Jenon

prej Shën Dhimitri, u ndihmuam nga Nikollë Tomazeu që t' i shtypim në Firence.

### **KOSTANDIN KRISTOFORIDHI (1827-1895)**

Kostandin Kristoforidhi ka lindur në Elbasan në vitin 1827. Shkollën e mesme e kreu në Gjimnazin “Zosimea” të Janinës. Gjatë viteve 1847-1850 Kristoforidhi i mësoi gjuhën shqipe albanologut Hahn, i cili ishte konsull i Austrisë në Janinë. Vite më vonë Hahn me ndihmën e Kristoforidhit zbuloi shkrimet e Dhaskal Todrit. Bashkëpunoi me Hahnin, i cili botoi më 1854 në Vjenë veprën “Studime shqiptare” (Albanische Studien). Më pas Kostandini studioi në kolegjin protestant të Maltës. Në vitin 1869 përktheu, me porosi të Shoqatës Biblike Britanike, Dhiatën e Re në dialektin gegë dhe më 1897 e botoi atë në Stamboll sipas dialektit toskë.

Kristoforidhi përktheu edhe disa nga librat e Dhiatës së Vjetër. Në vitin 1872 botoi Psalltirin dhe në vitet 1880-1884 botoi “Të bërët”, “Të dalët”, “Nomi i dytë”, “Fjalë të Urta” dhe “Isaia” në toskërisht. Përkthimet e Kristoforidhit dallohen nga pastërtia dhe saktësia e përdorimit të gjuhës shqipe. Teksti i Dhiatës së Re, i botuar për herë të parë në vitin 1879 në dialektin toskë, dhe i ribotuar në vitet 1911 dhe 1930, përdoret ende edhe sot në Kishën Ortodokse. Për edukimin fetar të fëmijëve ortodoksë K. Kristoforidhi përktheu përveç Biblës edhe tekste fetare shkollorë si “Historia e Shkronjës së Shenjtëruar” dhe “Katër katekizmat”. Kristoforidhi provoi në teori dhe në praktikë bashkësinë dhe njësinë e gjuhës shqipe në dy trajta shekullore dialektore, gegërisht dhe toskërisht dhe njësinë e kombit shqiptar. Veprat shkencore shumë të rëndësishme për gjuhën shqipë janë “Gramatika” (1882) dhe

“Fjalori i Gjuhës shqipe”, i cili mundi ta shohë dritën e botimit në vitin 1904 në Athinë. Të gjitha përkthimet e tij shquhen nga pastërtia dhe përdorimi i shkëlqyeshëm i gjuhës shqipe. Gjithë jetën e tij ia kushtoi predikimeve të fjalës së shenjtë, të Ungjillit, i frymëzuar prej idealit të bekuar të shqiptarizmit. Kostandin Kristoforidhi vdiq më 24 shkurt 1895 në qytetin e lindjes në Elbasan. Për të nderuar veprën e madhe të këtij dijetari dhe atdhetari të shquar, Kisha Ortodokse në vitin 1934 i ngriti një bust, i cili është sot në Kishën e Shën Marisë në Elbasan. (*Mitropoliti i Korçës Joani, Një vështim i shkurtër mbi përkthimet fetare në kishën orthodhokse, Ngjallja, mars 1999, faqe 7,8*).

## **DHIATA E=RE**

e Zotit edhe Shpëtimtarit t’ënë JISU KRISHT

Kthyerë prej Elinishtesë SHQIP

Ndë të folë Toskënisht

**Ungjilli pas Mattheut.**

Krye 1.

1 Vivll’ e gjeneallogis’ së Jisu Krishtit, të birit të Dhavidhit, të birit t’ Avraamit. 2 Avraamit i lindi Isaaku; edhe Isaakut i lindi Jakovi; edhe Jakovit i lindi Judha edhe të vëllezërit’ e ti; 3 Edhe Judhësë i lindi Faresi edhe Zaraj nga Thamara; edhe Faresit i lindi Esromi; Esromit i lindi Arami; 4 Edhe Aramit i lindi Aminadhavi; edhe Aminadhavit i lindi Naassoni: edhe Naassonit i lindi Sallmoni; 5 Edhe Sallmonit i lindi Voozi nga Rahava; edhe Voozit i lindi Ovidhi nga Rutha; edhe Ovidhit i lindi Jesseu; 6 Edhe Jesseut i lindi Dhavidhi mbreti. Edhe mbretit Dhavidh i lindi Sollomoni nga gruaja e Uriut; 7 Edhe Sollomonit i lindi Rovoami; edhe Rovoamit i lindi Aviaj; edhe Aviajt



i lindi Asaj; 8 Edhe Asajt i lindi Josafati; edhe Josafatit i lindi Jorami; edhe Joramit i lindi Ozia; 9 Edhe Ozisë i lindi Joatham; edhe Joathamit i lindi Ahazi; edhe Ahazit i lindi Ezeqia; 10 Edhe Ezeqisë i lindi Manassiu; edhe Manassiu i lindi Amoni; edhe Amonit i lindi Josia; 11 Edhe Josisë i lindi Jehonia edhe të vëllezërit' e ti, mbë të-çpërngulurit të Babillonësë, 12 Edhe pas të-çpërngulurit të Babillonësë, Jehonisë i lindi Sallathieli; edhe Sallathielit i lindi Zorobabeli; 13 Edhe Zorobabelit i lindi Aviudhi; edhe Aviudhit i lindi Eliaqimi; edhe Eliaqimit i lindi Azori; 14 Edhe Azorit i lindi Saduku; edhe Sadukut i lindi Aqimi; edhe Aqimit i lindi Eliudhi; 15 Edhe Eliudhit i lindi Eleazari; edhe Eleazarit i lindi Matthani; edhe Matthanit i lindi Jakovi; 16 Edhe Jakovit i lindi Josifi, burr' i Marisë, prej së cilësë lindi Jisuj që thuhetë Krisht. 17 Gjithë brezatë pra që nga Avraami e gjer mbë ditët të Dhavidhit janë katër-mbë-dhjetë breza; edhe që nga Dhavidhi e gjer mbë të-çpërngulurit të Babillonësë janë katër-mbë-dhjetë breza; edhe nga të-çpërngulurit' e Babillonësë e gjer mbë ditët të Krishtit janë katër-mbë-dhjetë breza.

18 Edhe të-lindurit' e Jisu Krishtit kështu ka qënë; passi uvlua e em' e ati, Maria me Josifnë, përpara se të bashkoneshinë, ugjënt me barë nga Frym' e-Shënjtëruarë. 19 Edhe Josifi, burr' i asaj, dyke qënë i drejtë, e dyke mos dashurë t' i nxjerë asaj zë të-lik, desh t'a lëshonjë fshehurazi. 20 Po ay tek po ishte dyke menduarë këto punë ja nj' ëngjëll i Zotit tek i uduk nd'ëndërrë, dyke thënë, Josif, i bir' i Dhavidhit, mos ufrikëso të marrç me vetëhe gruanë t' ënde Marianënë; sepse të-mbarsuritë që ubë tek ajo është nga Frym' e-Shënjtëruarë, 21 Edhe dotë pjellë djalë edhe dot' j'a quanjç emërinë Jisu; sepse ay dotë shpëtonjë llauzin' e ti nga fajet' e atyre. 22 Edhe Gjithë këjo ubë, që të mbushetë e-thëna prej

Zotit me anë të profitit, që thotë, 23 “Ja vërgjëresha tek dotë mbarsetë, edhe dotë pjellë djalë, edhe dot’ j’ a quanjën’ emërin’ Emanuil” që e-kthyerë do me thënë, Perëndia bashkë me ne. 24 Edhe Josifi si uzgjua nga gjumi, bëri sikundrë e urdhëroj ëngjëll’ Zotit, edhe mori për anë vetëhesë gruan’ e ti: 25 Edhe nuk’ e njohu atë, gjersa bëri të birin’ e saj të-parëlindurinë; edhe j’ a quajti emërinë Jisu.

## **TË BËRËTË**

### **Krye 1.**

1 Ndë kryet Perëndia bëri qiellin’ edhe dhenë. 2 Edhe dheu ishte pa formë edhe i-shkretë; edhe ishte errësirë mbi faqet të pafundjesë. Edhe fryma e Perëndisë sillej mbi faqet të ujërave.

3 Edhe Perëndia tha, Le të bënetë dritë; edhe ubë dritë; edhe Perëndia pa dritënë se ishte e-mirë; edhe Perëndia ndau dritënë nga errësira. 4 Edhe Perëndia dritën’ e quajti Ditë, edhe errësirën’ e quajti natë. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit’ e-parë.

6 Edhe Perëndia tha, Le të bënetë qëndresë ndër mest të ujërave, edhe le të ndanjë ujërat ndër mest të ujërave, edhe le të ndanjë ujëratë nga ujëratë. 7 Edhe Perëndia bëri qëndresënë, edhe ndau ujëratë që ishinë përposh qëndresësë; edhe ubë kështu. 8 Edhe Perëndia e quajti qëndresënë Qiell. Edhe ubë mbrëmje, edhe ubë mëngjes, dit’ e dytë.

9 Edhe perëndia tha, le të mblidhenë ujëratë që janë përposh qiellit mbë një vënt, 10 edhe le të duketë toka; edhe ubë kështu. Edhe Perëndia tokënë e quajti Dhe; edhe të-mbledhurit.....

## **PETRO NINI LUARASI (1865-1911)**

Petro Nini Luarasi ka lindur më 22 prill të vitit 1865. Në vitin 1878 Petroja studioi në dhidhaskalion e Qesaratit. Pas përfundimit të shkollës emërohet dhaskal në fshatin Bezhan, ku paguhej prej Llasos. Petroja ishte një nga mësuesit e parë të shkollës shqipe dhe dëshmor i shkrimit të gjuhës shqipe. Në vitin 1883 u mësoi nxënësve gjuhën e tyre amtare dhe e futi gjuhën shqipe në predikimet kishtarë. Mitropoliti i Kosturit Fillareti më 1892 e shkishëroi dhe e mallkoi. Ja edhe teksti i mallkimit: “Fort të përndershëm priftërinj të katundit Luarasi të Eparhisë sonë, ju urojmë atërisht, dhe ju lajmërojmë se, me qënë që Petrua nga katundi juaj Luarasi u përthith me shoqërinë masonike dhe protestante, dhe me qënë që përndau predikime kundër krishtërit dhe libra të çvetëmtuara (të aforizuara), është çkishëruar fëmijërisht (me gjithë fëmijë)”.

Për këtë veprim antishqiptar të kishës, Petro Nini Luarasi ka shkruar më 1911 pamfletin “Mallkimi i shkronjave shqip dhe çpërfojja e shqiptarit” dhe poemën “Kundër mallkimit të gjuhës shqipe”. Për t’i shpëtuar ndëshkimit dhe për të vijuar veprimtarinë atdhetare Petroja shkoi në Amerikë, ku themeloi shoqërinë “Malli i mëmëdheut”. Më 24 shkurt 1908 Fan Noli celebroi meshën e parë në Boston. Petro Luarasi ishte në vendin e psaltit. Në fund të shërbesës përshëndeti të pranishmit. Më pas ai u kthye në atdhe dhe u bashkua me çetën e Çerçiz Topullit. Më 1 maj 1908 botoi në gazetën “Drita” artikullin “Çudira të çuditëshme” dhe në vijim “Pranvera shqiptare”. Petro nuk i shpëtoi dënimit të përcaktuar, atë e helmuan më 1911.

## **Parathënie**

Të dashur këndonjës,

Dyke parë çpalljen e një libreje të tillë, si të kësaj, mbase do të pandehni se është fjala për ndonjë libër mësimtare a literature a prallë tregimtare, që është gjë e atyre shkronjëtarëve (autorëve), të cilët kanë kujdes të përformuarit dhe çpalosjen, mbë të gjithë njerëzinë, të një ideje të mirë, për të çpikurit e së cilës fort pakë njerës me shumë djesë dhe përgjerkatje dhe vojë u lodhë për interesën e bashkë të njerëzisë.

Tek lënda e kësaj pasjesëve s'ka pjesë as në një ndër sendet e sipërme, se s'është as mësimtare as literatyrake, as ndonjë prallë-tregim. Po me gjithë këtë, në lëndën e kësaj libre gjendet brenda një e vërtetë dhe e drejtë, e cila është nevojë të çquhet me kujdes prej logjikës së paudhët me qënë se qëllohet për të përzhuritur ndërgegjejen e disa njerëzve, të cilët vetë quhen shënjtorë dhe mendorë në kungajkat rreth syresh, po që kundërpunojnë dhe me mjete padrejtësie ndalojnë lirinë e çkëputur të çpalosjes dhe të idealit të njerëzve të tjerë, që janë të padëmshim e të padhunët në ndërgegje dhe përkrahim po të pavojsëm e të pamësuar në intrigat e farisenjta dhe të magjinjta dhe prinjen në këtë jetë. (*Petro N. Luarasi, Mallkimi i shkronjave shqipe dhe çpërfojla e shqiptarëve, Tiranë 1999*).

## **Kundër mallkimit të gjuhës shqipe**

Ju, vëllezër Shqipëtarë,  
Që për gjuhët dëshëroni,  
Si e qysh të vejë mbarë  
Dhe këtë fillthi mejtoni,

Ju lutem të më dëgjoni

T'ju tregoni një gjë të gjarë,  
Vini re të kupëtoni  
Për gjuhën se ç'funt ka marrë:

Më shtatë ditë kallnori,  
Këtë ditë të shënuar,  
Miqtë pritte zoti Gjoni  
Q'i vinin për të uruar.

Pas shumë njerës që vanë,  
Vajti edhe prift' i qytetit,  
Mori pas dhe grek-dhaskalë  
T'i epte rëndësi nderit.

Hyri brënda dhe i foli,  
Gjoni, që ta pritte dolli:  
“Kal' imera, i bekuar  
dhe gëzofsh emrin çdo mot  
si dhe ditën e shënuar  
që po kremtojmë sot”!

### **ANDON ZAKO-ÇAJUPI (1866-1930)**

Andon Zako-Çajupi ka lindur në fshatin Sheper të Zagorisë më 27 mars të vitit 1866. Mësimet e para i kreu në vendlindje. Në moshën 15-vjeçare, i ati Harito Çako e dërgoi në Aleksandri për të ndjekur kolegjin francez. Gjatë viteve 1887-1893 studioi për drejtësi në Gjenevë të Zvicrës. Gjatë studimeve u njoh me

Evgjeninë, e cila pas një viti martese ndërroi jetë, duke lënë jetim birin e sapolindur, Stefanin. Kjo ngjarje e hidhur ndikoi thellë në jetën e Çajupit, i cili e përjetoi emocionalisht humbjen e parakohshme të bashkëshortes së tij. Dhimbjen e shprehu nëpërmjet elegjisë “Vaje”, vargjet e së cilës janë shumë prekëse. Këtë vjershë Çajupi ka përfshirë te “Baba Tomorri” dhe është nga elegjitë më rënqethëse të letërsisë shqipe. Vjersha përshkohet nga pikëllimi i thellë i autorit për humbjen e parakohshme të bashkëshortes së tij të dashur. Vjershëtori vajton për të shoqen, e cila u nda nga jeta vetëm pas një viti martese, duke i lënë birin e sapolindur jetim. Vargjet e para të kësaj elegjie shprehin mallëngjim dhe zhgënjim.

Që ditën që vdiqe, që kur s’ të kam parë,

Lotë, që kam derdhur s’ më janë edhe tharë!

Shumë vjet u bënë, sot u mbushnë dhjetë,

Që kur më ke lënë dhe s’ të shoh ndë jetë!

Në ç’ kopshte me lule ke qëndruar vallë?

S’ të vjen keq për mua, s’ të vjen mall për djalë?

Çajupi i gjunjësuar përpara varrit të Evgjenisë thur vargje, të cilat sikur ia lehtësojnë brengën. Kujtimet e përmallshme dhe lotët që ka derdhur për një dekadë e fusin poetin në letargji duke e pyetur të vdekurin, si nuk e ka marrë malli për djalin, të cilin e pati lënë foshnjë dhe tashmë është bërë burrë.

Mos na le të gJORë, me zemër të ngrirë,

Ktheu të gëzonest kur të shoq të birë;

E ke lënë foshnjë, tani u bë burrë,

S’ harite ta rritje, s’ të ka parë kurrë!

Çajupi pyet të vdekurën, mirëpo thirrjeve të tij u përgjigjet vetëm heshtja e thellë e varrit. Ashtu si-ç është i gjunjësuar buzë varrit, i lutet edhe njëherë Efgjenisë me vargje prekëse:

Për ty shumë herë çoç do të më thotë,  
Por s' mund t' i përgjigjem se më mbytin lotët!  
Kthej kokën mënjanë dhe vështroj përpjetë,  
Duke psherëtitur, te Zoti i vërtetë...  
O Zot i vërtetë, s' t' erdhi keq për djalë,  
Kur i more mëmën dhe më le të gjallë?

Stefani e pyet babanë për nënën, por ai nuk mund t' i përgjigjet, sepse e mbysin lotët. Vjeshëtori këmbëngul përsëri duke iu lutur Zotit, por ligjet e natyrës nuk mund ta kthejnë Evgjeninë në jetë. Tashmë i zhgënjyer nga çdo gjë e kësaj bote, fillon e shfryhet me urrejtje kundër natyrës, madje arrin deri aty që të thotë fjalë edhe kundër Zotit.

Doje dritë o qiell, more dritën time,  
Dhe më mbushe jetën plot me hidhërimë!...  
Tani rroj pa shpresë, ndaj s' dua të rroj,  
Se Perëndinë tani s' e besoj!.....

Në këto momente dëshpërimi i shfaqet një engjëll dhe ai sheh një vegim sikur në këndin e dhomës një nënë e re ka përqafuar foshnjën në gji dhe i lutet Perëndisë pa pushim:

Perëndi, lemë të gjallë,  
Po të lutet mëm' e mjerë,  
Të mund të rrit këtë djalë,  
S' ka një javë që ka lerë,  
Kush do ta marrë ta rritë?  
Jetimi qysh do të rrojë?  
Kush do t' i japë të pijë?  
Si unë kush do ta dojë?

Në këtë rast shpirti i Evgjenisë i kërkon ndjesë Perëndisë, për mëkatin e të shoqit.

Më ndje, o Zot i vërtetë,  
Se Stefani ka babanë,  
Dhe do ta rritijë vetë.  
Engjëlli me këto fjalë  
Nga jet' e rreme shpëtoi,  
La baban' e zi me djalë,  
Dhe në Qiell fluturoi!

Evgjenia falenderon Perëndinë që Stefani ka babanë gjallë dhe do të kujdeset për rritjen e tij. Pas këtyre vargjeve, Çajupi mendon se edhe për të do të vijë një ditë dhe do të vdesë si çdo njeri. Ai e kupton se në kushtet që gjendet i mërguar në dhe të huaj, një ditë do të vdesë në vetmi, pa pasur të afërm pranë. Ai ndërgjegjësohet tashmë se nuk ia ka fajin Perëndia. Këtë e shpreh me anën e vargjeve:

Gjithë ç'kanë qënë të gjallë si unë,  
Të varfër, të pasur, të urt' a të marrë,  
Mbase kanë dashur, qeshur apo qarë,  
Po të tërë vdiqnë dhe në varr i vunë!

Vjershëtori pendohet për fjalët e pamenduara që ka thënë dhe mundohet të ruajë në kujtesën e tij vetëm kujtimet e mira të kësaj bote “Kujto djalërinë...një Engjëll, një natë”. Më 1898 Çajupi botoi artikullin “Duke kërkuar një alfabet”, ku u paraqit me pseudonimin Çajupi, që ishte mali i vendlindjes së tij. Çajupi e ngriti letërsinë shqiptare në tematikë dhe në patosin zotërues. Ai ka shkruar poezi lirike, poezi parodike, pamflet, elegji etj. Studiuesi Ermir Nika mendon që vepra e Çajupit nuk është e plotë, sepse studimet e deritanishme të veprës së tij janë bazuar vëtëm në veprat e botuara dhe nuk janë përfshirë dorëshkrimet e tij. Këto të fundit i ka marrë me vete gruaja, e cila jetoi vitet e fundit me poetin në



Kajro. Çajupi është i fundmi ndër shkrimtarët e letërsisë romantike. Ai vdiq në Kajro të Egjiptit më 11 korrik 1930. (*Ermir Nika, Vepra e Çajupit dhe takimet e saj me rrymat letrare, Korrieri, 27 mars 2006, faqe 17*).

### **NDRE MJEDA (1866-1937)**

Ndre Mjeda ka lindur në fshatin Mjedë të Shkodrës më 20 nëntor 1866. Pasi përfundoi seminarin në Shkodër, kreu studimet e larta në Spanjë, Poloni, Kroaci dhe Itali. Që në moshë të re filloi të shkruajë për popullin dhe vendin e tij. Vepra e parë e tij është “Shahiri elierz”. Kur ishte në moshën 21-vjeçare, më 1887, Mjeda botoi vjershën “Vaji i bylbylit”, ku paraqet dhembjen për fatin e kombit të robëruar dhe optimizmin për të ardhmen e tij. Gjatë viteve 1887-1892 krijimtaria e Mjedës vazhdon me përkthime të ndryshme. Gjatë viteve 1886-1887 Mjeda përktheu në shqip veprën “Jeta e Shën Gjon Bergmans”. Në Arkivin e Shtetit gjendet një fletore, e cila përmban tetë krijime të Mjedës që janë shkruar në vitet 1884-1893. Në vitin 1901 Ndre Mjeda themeloi shoqërinë gjuhësore dhe letrare “Agimi”, e cila në botimet e veta përdori një alfabet të ri të gjuhës shqipe. Pa kaluar shumë kohë, më 1902, Ndre Mjeda botoi broshurën “Parashtrimi i alfabetit adoptuar në Konferencën e ipeshvijve shqiptarë në Shkodër. (*Tomor Osmani, Udhë e shkronjave shqipe, Shkodër 1999, faqe 379-385*).

Mjeda hyri në letërsinë tonë si poet i shquar me botimin e vëllimit “Juvenilja” më 1917. Ndre Mjeda i këndon më ëndje gjuhës shqipe.

Përmbi za që lshon bylbyli,  
gjuha shqipe m’shungullon;

përmbi er' që jep zymbyli,  
pa sa zemrën ma ngushllon.

Ndër komb' tjera, ndër dhena tjera,  
ku e shkoj jetën tash sa mot,  
veç për ty m' rreh zemra e mjera,  
e prej mallit derdhi lot.

Geg' e tosk' malsi, jallia  
jan një komb, m' u da, s' duron;  
fund e maj' një a Shqipnia  
e një gjuh' t' gjith' na bashkon.

Në vitet 1920-1924 Mjeda u zgjodh deputet i opozitës. Me ardhjen në fuqi të Mbretit Zogu I, Mjeda u largua nga aktiviteti politik, për t' u përkushtuar në aktivitetin fetar si famulltar i katundit Kukël. Në vitet e fundit të jetës ka punuar si mësues i gjuhës shqipe në Shkodër. Ai ka dhënë ndihmesë të çmueshme në lëvrimin e gjuhës amtare duke botuar artikuj të ndryshëm me anën e të cilëve trajtonte probleme të gjuhës shqipe. Ndër to mund të përmendim: “Vërejtje mbi artikuj e premna pronës të gjuhës shqipe”, botuar më 1934, “Mbi shqiptimin e qellzoreve ndër dialektet e ndryshme të gjuhës shqipe”, botuar më 1902 etj. Gjithashtu Mjeda është marrë me studimin dhe transkriptimin e veprave të letërsisë së vjetër shqipe. Ai ka transkriptuar pjesërisht veprat e Budit e të Bogdanit, si dhe “Perikopenë e ungjillit” të shek XV. Ndre Mjeda vdiq më 1 gusht të vitit 1937. (*Fjala e Mjedës, Standard, 21 gusht 2006, faqe 17*).

## MIHAL GRAMENO (1871-1931)

Mihal Grameno ka lindur më 1871 në qytetin e Korçës. Që në moshë të re emigroi në Rumani dhe më 1889 u zgjodh sekretar i shoqërisë “Drita”. Më 1907 u bashkua me çetën e Çerçiz Topullit. Ai mori pjesë në Kongresin e Manastirit dhe më 1912 në Shpalljen e Pavarësisë. Gjatë viteve 1921-1924 M. Grameno jetoi në SH.B.A.

Veprimtaria letrare e Mihal Gramenos fillon me komedinë “Mallkimi i gjuhës shqipe” më 1905 dhe dramën “Vdekja e Pirros” më 1906. Në vitin 1909 shkroi novelat “E puthura”, “Oxhaku” dhe “Varri i pagëzimit”. Të gjitha vjershat i përmbloodhi në vëllimin “Këngëtore shqipe-Plagët”, që e botoi më 1912. Ndër krijimet më të spikatura janë vjershat “Lamtumirë”, “Uratë për liri”, “Për mëmëdhenë” etj.

Për mëmëdhenë, për mëmëdhenë  
Vraponi burra, se s’ka me prit.  
Të vdesim dot me besa-besë  
Pranë flamurit të kuq q’u ngrit.

Pranë flamurit, pranë flamurit,  
Me shpatë të zhveshur shqipëtarisht,  
Për dhen’e babës edhe të burrit  
Kemi me vdekur sot burrërisht.

E Drini plak me oshëtima  
Mbi Shqipërinë valët po derdh;  
Tosk’edhe Gegë, si vetëtima  
Armikut bini se dita erdhi.

Ejani burra malit përpetë  
Duke u betuar vdekj' a liri.  
Se s'ka m'e ëmbël në këtë jetë,  
kur vdes shqiptari për Shqipëri!

Më 1925 ka shkruar librin me kujtime “Kryengritja shqiptare”. Mihal Grameno vdiq në Korçë në vitin 1931. Më 1 shkurt të vitit 1909 u formua në Korçë shoqëria “Lidhja Ortodokse”, në drejtimin e së cilës u vu atdhetari Mihal Grameno. Kjo shoqëri patriotike botoi gazetën e përdryjavshme fetare dhe letrare, nëpërmjet së cilës zhvilloi propagandën e saj. Qëllimi kryesor i kësaj shoqërie atdhetare ishte përdorimi i gjuhës shqipe nëpër shërbesat fetare. Shumë shpejt kjo shoqëri krijoi degët e saj në Elbasan, Durrës, Berat e gjetkë. Shkrimet e tij publicistike u vunë në shërbim të çështjes kombëtare. (*Dhimitër Beduli, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944, Tiranë 1992, faqe 16*).

### **ASDRENI (1872-1947)**

Aleksandër Stavre Drenova (Asdreni) ka lindur në Drenovë të Korçës më 1872. Mësimet e para i mori në fshatin e lindjes dhe më vonë ka studiuar në Bukuresht. Asdreni e kaloi jetën në mërgim. Ai ka bashkëpunuar me shtypin letrar brenda dhe jashtë vendit. Asdreni është mjeshër krijimit të himneve dhe marsheve. Nga gjithë krijimtaria e tij, vjersha “Betimi mbi flamur”, e cila u shkrua më 1907, ka fituar popullaritet sepse u bë Himni ynë Kombëtar. Ka botuar “Rreze dielli” (1904), “Ëndërra e lotë” (1912), “Psallme murgu” (1930) etj. Në vjershën “Perëndia”, Asdreni flet për krijimin e botës.

O Zot i math i vërtetë  
Dhe bërës i gjithësisë,  
Që jep dritë që jep jetë  
Natyres dhe njerëzisë.

Ti ke tërë fuqinë  
Se ti botën e urdhëron,  
Sa lëvizin dhe sa rinë  
Ti i këmben dhe ti i ndron!

Ti bën delet të valijnë  
Er'rat të fryjnë me nxitim,  
Edhe retë të gjëmojnë  
Botën ta tundin pa pushim.

Ti bërë diell edhe hënë  
Yjtë dhe hapësirë  
Që të gjitha i ke vënë  
Me mjështëri dhe me hirë.

Ja njeriu sa i çquar!  
Gjithë ç'ke bërë si i sheh,  
Tynë duke të lëvduar  
Për Zot të vërtetë të njeh.

Tek "Lutja e të humburve" Asdreni flet për përdëllimin e  
Atit Qiellor, i cili pranon ata që pendohen.

O Zot i madh i jetës, Ati ynë  
Që përmban gjithësinë pa mbarim,

Përpara Teje vijnë sepse Tynë  
Të kemi shtyllë, shpresë në ngjallim.

Me krye përulur kurdoherë  
Ty, lutje po të sjellin dhe sot, por...  
Jemi edhe të verbër, të pandjerë  
Për t' u njohur më mirë o At qiellor!

Ty ne të kemi ndihmë nat' e ditë  
Dhe mirësinë Tënde, mal që ke,  
Dërgojena, ndërtona me një dritë  
Sepse i plotfuqishmë veç Ti je!

Mëkatet Atë falnani, kij mëshirë  
Se ne pa vetdije jemi sot;  
E ndjen zemra dhe shpirti shumë mirë  
Po s' kemi zë as gojë, s' flasim dot!

Ti pra o shpres' e naltë hape dorën  
Dhe bekimin na dërgo si fuqimath  
Me ngushëllim na mbush zemrën të gjorën;  
Na mblith gjithë nd' atë kopësht, gjith n' atë vath.

Në vitet e fundit të jetës Asdreni botoi vëllimin “Këmbanat e Krujës”. Poeti vdiq më 11 dhjetor të vitit 1947 në Bukuresht të Rumanisë.

## PAPA KRISTO NEGOVANI (1875-1951)

Papa Kristo Negovani ishte prift atdhetar i Kishës Ortodokse. Ka lindur në Negovan të Follorinës në vitin 1875. Pasi mbaroi shkollën qytetare në Athinë shërbeu si mësues në fshatrat Negovan dhe Ballkamen. Vite më vonë u hirotonis prift filloi të përkthente tekstet liturgjike në gjuhën shqipe duke i praktikuar edhe nëpër shërbesat fetare. Papa Kristo Negovani mundi me shumë përpjekje të botojë nëntë vepra shkollore dhe kishtarë në gjuhën shqipe. Veprimtarinë e vet fetare me ungjillin në dorë ai e shoqëroi edhe me veprimtarinë e shquar kombëtare. Papa Kristo Negovani ka botuar librin “Prishja e Hormovës prej Ali pashë Tepelenës”, ka shkruar bukur librin “Të drunjtin Kryq” dhe vjershat “Vrasja e Ivikut”, “Tek ajo kodra shumë e lartë”, ka përkthyer nga frëngjishtja “Kryqin e Margaritartë”, librat fetarë “Bënjat e Shenjtorëve dërgimtarë” dhe “Hijetore histori”. Gjithashtu Papa Kristo Negovani ka shkruar rrëfenjën “I vogli Donat Argjendi”, e cila u botua nga Shoqëria “Bashkimi” e Kostancës në vitin 1900. (*Mitrush Kuteli, Vepra letrare, Nr. 5, Tiranë 1990, faqe 148*).

Më 10 shkurt 1905, ditën e Shën Harallambit, në prani të dhespotit të Kosturit Karavangjeli, Papa Kristoja e mbajti meshën në gjuhën shqipe. Dhespoti i Kosturit, Karavangjeli, e mallkoi, por Papa Kristo Negovani vazhdoi shërbesat në gjuhën shqipe. Më në fund e masakruan me sëpatë në pyllin e fshatit Negovan më 12 shkurt 1906. Ai u bë kështu martiri i parë në përpjekjet për të futur gjuhën shqipe në shërbesat e Kishës Ortodokse. (*Alqi Jani, Mitropolia greke e Gjirokastrës mallkon banorët e Nivanit të Zagories, Zagoria, Korrik 2003, faqe 2*).

Vrasja e Papa Kristo Negovanit pati ndikim të madh në popull. Duke marrë shkas nga kjo ngjarje e shëmtuar poeti Loni Logori (1871-1929) krijoi vjershën “Papa Kriston e vranë”.

Papa Kristonë e vranë  
Dhe s’ra për të një këmbanë;  
Dhe malet e Shqipërisë,  
Dhe shpellat e malësisë,  
Thërrisnin anëmbanë:  
Papa Kristonë e vranë!

Dh’ay vjershëtor i pyllit,  
Bilbili q’i këndon yllit,  
Përse s’këndon si më parë,  
Po hedh zëra më të qarë?  
Përse e thonë që mbi manë  
Papa Kristonë e vranë?

Kjo vjershë u krijua më 1905, menjëherë pas vrasjes së Papa Kristo Negovanit. Vjersha është botuar në librin e Anton Paplekës, “Poetët shqiptarë”.



## **KREU I TRETË**

### **LETËRSIA E PAVARËSISË (1912-1944)**

Pas shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë më 1912, thellohet karakteri demokratik dhe realist i letërsisë së krishterë. Përfaqësuesi më i shquar i frymës demokratike ka qenë Imzot Theofan Noli, i cili paraqitet si poet, historian, publicist, muzikolog, përkthyes, etj. Për kontributin e tij në shumë fusha të artit është cilësuar si njeriu më i madh i të gjitha kohërave. Figurë tjetër e kësaj epoke ishte Atë Gjergj Fishta, i cili me “Lahutën e Malsisë” mbetet poeti më i madh epik i shqiptarëve. Liriku më i madh i atyre viteve është Lasgush Poradeci, i cili ndërtoi identitetin e botës shpirtërore shqiptare.

Nëpërmjet Asdrenit dhe Lasgush Poradecit letërsia e Pavarësisë u shfaq si trashëgimi e simbolizmit, pastaj në realizëm me frymë kritike, me Nolin dhe Çajupin, me prozën e moderuar të Koliqit, Migjenit dhe Kutelit etj. Letërsia e Pavarësisë u mbështet në krijimin e strukturave të reja letrare si dhe në krijimin e ndërgjegjes letrare. Kulmin e realizmit kritik kjo letërsi e arriti me Migjenin, i cili pasqyroi gjendjen e mjerueshme të shtresave të varfëra duke theksuar revoltën popullore.

## GJERGJ FISHTA (1871-1940)

Atë Gjergj Fishta ka lindur në fshatin Fishtë të Zadrimës (Përtejdrini), më 23 tetor të vitit 1871. Arsimin fillor e kreu në kolegjin françeskan të Shkodrës dhe më pas në Troshan. Në vitin 1886 me bekimin e Atë Bernardin da Portogruaro, ndoqi studimet teologjike dhe filozofike në Bosnje. Kreu vitin e provës në manastirin e Guca Gora. Studimet e plota teologjike i përfundoi në Livno. Pas përfundimit të studimeve më 25 shkurt të vitit 1894 Atë Fishta celebroi meshën e parë në kishën e Troshanit. Njëkohësisht emërohet të japë mësim në kolegjin e Troshanit, ndërsa shërbesat kishtarë i kryente në kishën e Gosmiqes. Veprimtaria letrare e Fishtës është shumë e larmishme duke lëvruar të gjitha zhanret: lirikën, epikën, dramën, satirën, publicistikën, veprat agjiografike etj. Fishta ka shkruar rreth 50.000 vargje poezi, ndërsa në prozë bëhen rreth 7000 faqe. Gjergj Fishta ka botuar 40 vepra dhe ka lënë në dorëshkrim 30 të tjera. Botimet kryesore të Fishtës janë: “Lahuta e Malcis”, “Mrizi i Zanave”, “Vallja e Parrizit”, “Gomari i Babatasit”, “Shën Françesku i Asizit”, botuar më 1909, “Shqyptari i gjytetnuem”, botuar më 1911, “Juda Makabe”, botuar më 1920, “Baritë e Betlemit”, botuar më 1925, etj. (*Ndue Zef Toma, At Gjergj Fishta, figurë e madhe e kombit, 55, 29 dhjetor 2005, faqe 19*).

Nën titullin “Mrizi i zanave”, Fishta botoi në vitin 1913 lirika me temë fetare. Në këtë vepër ndiejmë vibrimet e holla, me të cilat poeti ngazëllohet nga soditja e flamurit kombëtar, që valëvitet si krah engjëlli në sfondin e atdheut të çliruar nga robëria e gjatë osmane. Vjersha më e bukur e librit është ajo e titulluar “Gjuha shqype”. Me anën e kësaj vjershe Fishta himnizon bukurinë dhe madhështinë e gjuhës shqipe.

Posi kanga e zogut t' verës,  
qi vallzon n' blerim të prillit;  
porsi i ambli flladi i erës,  
qi lmon gjit e drandofillit;  
porsi vala e bregut t' detit,  
porsi gjama e rrfes zhgjetare  
porsi ushtima e një tërmetit,  
njashtu a gjuha e jonë shqyptare.

Pra, mallkue njai bir Shqyptari,  
qi këtë gjuhë të Perëndis',  
trashigim, qi na la i Pari,  
trashigim s'ia len ai fmis:  
edhe atij iu thaftë, po, goja,  
qi e përbuzë këtë gjuhë hyjnore;  
qi n' gjuhë t' huej, kur s' asht nevoja,  
flet e t' veten len mbas dore.

Në gjuhë shqype nanat tona  
qi prej djepit na kanë thanun;  
se asht një Zot, qi do ta dona;  
njatë qi jetën na ka dhanun;  
edhe shqyp na thanë se Zoti  
për shqyptarë Shqyptnin e fali,  
se sa t' enden stina e moti  
do ta gzojn kta djalë mbas djali.

Kryevepra e Fishtës është "Lahuta e Malcis", që u botua në vitin 1937. Ky libër me 511 faqe u botua në Shtypshkronjën Françeskane në Shkodër. Për të nxjerë në dritë kryeveprën epike

të literaturës shqipe, Fishtës iu deshën tridhjetë e dy vjet punë. “Lahuta e Malcis” ka 30 këngë me rreth 15.563 vargje. Kjo vepër është cilësuar si “Iliada” e shqiptarëve, gjithashtu është i vetmi epos kombëtar i letërsisë sonë. Në të gjithë veprën flitet për fatin e Shqipërisë, që qëndron përpara simbolit mitologjik “Ora e Shqipërisë”. Sipas besimit shqiptar rreth kësaj ore grupohen orët e fiseve, bajraqeve, trojeve, orët e shtëpive dhe së fundmi orët e çdo luftëtari e të çdo shqiptari. Ngjarjet e poemës fillojnë në vitin 1858, kur Mali i Zi, i nxitur prej carit të Rusisë, synonte të zaptonte trojet shqiptare. Fishta i rendit këngët sipas kronologjisë së ngjarjeve historike. Pesë këngët e para, që përbëjnë edhe cilkin e parë të poemës, janë ato për Oso Kukën. Viojnë këngët për Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, për të përfunduar me këngën “Konferenca e Londonit”, e cila përbën epilogun e poemës. Poema përfundon në kohën kur është shpallur pavarësia e Shqipërisë dhe Konferenca e Londrës ka vendosur për copëtimin e trojeve shqiptare. Poema paraqet konfliktin midis shqiptarëve dhe sllavëve.

Lum e lum për t’ Madhin Zot!  
Ç’ka shkrehë sonte gjithë ky mot,  
Gjithë ky mot e kjo vetimë,  
Gjithë kjo gjamë e bubullimë,  
Thue po shemben qiellë e dhe.  
Ka lëshue përrue, po, e ka lëshue she;  
Rreh shtërngata, shungllon era;  
Ushtojnë malet, me t’hi mnera;  
Kaq një mot ka shkrehë n’ malsi;  
Shka do t’ jetë, vallë nuk e di.

Kjo vepër u botua në revistën “Ylli i Dritës” më 1922. Gjergj Fishta në prill të vitit 1916 botoi në revistën “Përparimi” vjershën me titull “Dita e Gjyqit”.

At ditë, disi t’u u matë, u çueka dielli;  
e as dritë ai nuk po bate. Njato rreze,  
t’cillat motit t’shkëlzyeshme e t’nxeta ngrohshin  
gjit’ e plleshëm t’natyrës, e gjallë mbi shekull  
mbajshin flakën e jetës, ato të zbeta  
e t’marrta dheut po i bijshin: thue se gurra  
e dritës isht’ shterë. Po pasha e rruzullimit  
ajo dhe atë ditë e ngathët e disi rryetas  
asaj ravës s’hershme (nëpër eter t’cilen  
gishti ia çili Perendis s’Amshueme).

Fishta ishte për pastërtinë e gjuhës shqipe. Ai ishte për një gjuhë të gjallë të popullit. Gjergj Fishta vdiq në Shkodër më 30 dhjetor 1940. (*Pal Dukagjini, Gjergj Fishta, jeta dhe veprat, S. Maria degli Angeli, Assisi 1992*).

Ceremonia e varrimit të poetit të madh u krye në kishën e Gjuhadorit, me pjesëmarrjen e klerit françeskan, të besimtarëve të shumtë, si edhe të intelektualëve të shquar. Fjalën e rastit e mbajti Prof. Aleksandër Xhuvani.

Disa ditë pas varrimit eshtrat e Fishtës u zhvarrosën nga vendi ku preheshin me paqe, për t’u flakur në lumin e Kirit, ashtu sikurse kishin vepruar turqit me eshtrat e Pjetër Bogdanit dhe serbët me lipsanin e Shtjefën Gjeçovit. Gjatë pesëdhjetë vjetëve të regjimit totalitar, Fishta është cilësuar si armik i komunizmit dhe vepra e tij është lënë në harresë. Askush prej shkrimtarëve nuk e mori guximin të shkruante diçka për jetën dhe veprën e tij madhore. Vetëm në vitet e demokracisë Atë Gjergj Fishta u rehabilitua dhe u vlerësua

nga instancat më të larta të shtetit shqiptar. Me rastin e 90-vjetorit të Pavarësisë, Presidenti i Republikës Alfred Moisiu i akordoi Fishtës medaljen e artë “Nder i Kombit”. Më 28 dhjetor 1996 u krye ceremonia e rivarrimit të relikeve dhe eshtrave të gjetura të tij. Në këtë ceremoni mbresëlënëse u bënë homazhe në nderim të kujtimit të Fishtës së madh. Shtypshkronja françeskane ka filluar ribotimin e plotë të veprës së tij.

### **FAN NOLI (1882-1965)**

Fan Noli ka lindur më 6 janar 1882 në Adrianopojë të Turqisë. Arsimin fillor e kreu në gjimnazin grek në Adrianopojë. Më pas vajti në Athinë ku punoi si karrocier në një tramvaj rrugësh me kuaj. Gjithashtu ai punoi si figurant dhe zëvendësues aktori në një trupë teatri. Më vonë në vitin 1906 emigroi në Amerikë dhe punoi si punëtor i thjeshtë nëpër fabrika të ndryshme. Në vitin 1912 u diplomua në Universitetin e Harvardit.

Në vitin 1920 Noli kryesoi delegacionin e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve në Gjenevë dhe punoi për t’u pranuar edhe Shqipëria në Lidhje. Ky ishte edhe sukcesi i tij në fushën diplomatike. Në vitin 1924 Theofani u bë Kryeministër i Shqipërisë, megjithëse ishte klerik dhe pjesa dërrmuese e popullsisë ishte e besimit mysliman. Gjatë qeverisjes ai zbatoi reformën agrare. Më pas u detyrua të largohej nga Shqipëria dhe u vendos në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Më 1938 u diplomua për muzikë në Universitetin e Nju Jnglendit, ndërsa në vitin 1935 mori gradën doktor i shkencave filologjike në Universitetin e Bostonit. (*Fan S. Noli, Autobiografia, Tiranë 1994, faqe 72-80*).

Duke lexuar me ëndje përkthimin e Dhiatës së Re nga Kristoforidhi, Noli i lindi dëshira për t' u bërë misionar i krishterimit. Kështu në vitin 1908 Noli u dorëzua prift nga mitropoliti rus i Nju Jorkut Platoni në katedralen e Shën Nikollës, sipas rekomandimit të Atë Aleksandër Hotovickit dhe Atë Jakob Grigorievit. Theofan Noli u dorëzua në gradën priftërore në moshën 26 vjeçare në këto rrethana historike. Kisha nuk kishte varrosur një shqiptar me emrin Kristo Dishnica në varrezat e Kishës së Shën Gjergjit. Ky incident ka ndodhur vërtet dhe daton në vitin 1907, por në atë kohë prift në atë kishë nuk ishte një grek, por një sirian. Ky i fundit duke parë certifikatën e lindjes së Kristo Dishnicës, e cila thoshte “lindur në Turqi, fshati Korçë”, nuk kishte pranuar që ta varroste, sepse sipas tij ai ishte mysliman. Në atë kohë të gjitha dokumentet e shqiptarëve mbanin vulën e Perandorisë Osmane. (*Sokol Balla, Noli ky prift i çuditshëm, Klan, 31 janar 1999, faqe 32*).

Kristo Thimo Dishnica u varros pa asnjë ceremoni kishtarë. Kjo ngjarje shkaktoi zemërimin e shqiptarëve të Masaçusetsit, të cilët vendosën që të kishin një prift shqiptar. Më datën 22 mars 1908 u celebrua liturgjia e parë në gjuhën shqipe prej Atë Theofanit në sallën e “Kalorësve të Nderit” në Boston. Liturgjia Hyjnore e përkthyer nga Atë Theofani tingëllonte shumë bukur në gjuhën shqipe dhe kuptohej nga besimtarët e pranishëm. Po atë ditë shqiptarët u mblodhën në sallën “Feniks” dhe themeluan Kishën Ortodokse Shqiptare të Shën Gjergjit në Boston. Më 17 nëntor të vitit 1918 Atë Theofani mori ofiqin e Arkimandritit prej Episkopit Rus Aleksandër në Katedralen e Shën Nikollës, ndërsa më 25-27 shkurt të vitit 1919 në mbledhjen e përgjithshme kleriko-laike të kolonive shqiptare të SHBA-së, Arkimandrit Theofani u propozua si kandidat për episkop. Me iniciativën e tij, më 20 korrik 1919, Kisha

Ortodokse e diasporës shqiptare të Amerikës u shpall e pavarur. Më 21 nëntor 1923 në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë u bë fronëzimi i Theofanit si Mitropolit i Durrësit, prej episkopëve Kristofori dhe Jerotheu. Mitropolit i Durrësit mbante titullin: “Mitropolit i Durrësit, Gorës dhe Shpatit, primat i gjithë Ilirisë, Detit të Perëndimit dhe gjithë Shqipërisë”. Ky titull i takonte Fortlumenturisë së Tij, Kryepiskopit të Shqipërisë Theofanit. (*Fan Noli, Vepra II, Tiranë 2003, faqe 304-306*).

Në verën e vitit 1964 Imzot Theofani, në moshën 83 vjeçare, kaloi një sëmundje të rëndë. Ai shtrohet në spital dhe iu nënshtrua një operacioni të vështirë. Vuante nga kanceri në zorrë. Në stinën e dimrit në Boston bënte shumë ftohtë, prandaj Noli kishte vendosur që të shkonte në Florida, në shtëpinë që kishte blerë me ndihmat e shqiptarëve. (*Takimi i fundit i Fan Nolit me shqiptarët, Sot, 6 dhjetor 2002, faqe 15*).

Hirësia e tij Theofani ndërroi jetë më 13 mars të vitit 1965. Ceremonia e përcjelljes për në banesën e fundit u zhvillua ditën e shtunë më 20 mars. Kisha ishte mbushur plot e përplot, nga shqiptaro-amerikanë të ardhur nga të gjitha anët e Amerikës, sidomos nga Bostoni, nga funksionarë të tjerë me në krye guvernatorin e shtetit të Masaçusets Xhon Volpe. Kurora me lule të shumta mbulonin arkivolin, ndër të cilat dallohej kurora e dërguar në emër të Shqipërisë. Mbi 15 priftërinj ortodoksë shqiptarë morën pjesë në zhvillimin e ceremonisë së përmortshme. Djem dhe vajza të Kishës së Bostonit përbënin korin që shoqëronte panagjirikët, të cilët u mbajtën në gjuhën shqipe dhe angleze, prej të perëndishmëve Sokrat Sotir dhe Sotir Dilogjika. Varri i tij me gurë të skalitur, që ndodhet sot në këto varreza, është përruar më 7 shtator 1974. Në qendër shënohet KRYEPESHKOPI FAN



STILIAN NOLI, themeluesi i Kishës Orthodhokse Shqiptare në Amerikë, në të dy anët jepet veprimtaria e tij jetësore. (*Efthim Dodona, Noli i panjohur, Tiranë 1996, faqe 191*).

### **Vepra letrare e Nolit**

Fan Noli ka qenë nga njerëzit më të shquar të të gjitha kohërave. Përveç gjuhës së bukur shqipe, të cilën e ka mësuar nga nëna në Ibrik-Tepe, Noli fliste dhe shkruante greqisht, turqisht, anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht etj. Ai ka qenë gazetar. Botimet në shtypin e kohës janë me emrin e tij ose me pseudonimet Theofan Mavromati e Baba Qyteza; Teolog dhe orator me përkthimet e teksteve liturgjike dhe predikimet e fjalës së Perëndisë që mbante çdo të dielë nga amvoni; Historian, me kryeveprën “Historia e Skënderbeut”; Kritik arti dhe shqipërues i kryeveprave të letërsisë botërore; Poet me vjershat e shumta që ka shkruar, të cilat mund t’i ndajmë: 1-satirike “Marshi i Barabait”, “Bismilah tridhjet seneja”, “Kënga e monarkisë”, 2-elegji “Tomsoni dhe kuçedra”, “Elegji për Luigj Gurakuqin”, “Shpell’ e Dragobisë”, 3-simbolike “Shën Pjetri mbi mangall”, “Hymni i Flamurit” etj. Kompozitor, duke botuar “Hymnore”, e cila përmban himne të kompozuar prej tij, që përdorshin gjatë të kremteve. Më 1948 shkrimtari i shquar Mitrush Kuteli botoi përmbledhjen “Albumi”, në të cilën paraqitej krijimtaria më e mirë e Nolit. Ky libër u sponsorizua nga “Vatra”.

Nga krijimtaria e Nolit shumë poezi kanë motive biblike: “Moisiu në mal”, “Marshi i Barabajt”, “Krishti me kamxhik”, “Marsh i kryqëzimit”, “Shën Pjetri mbi mangall”, “Marshi i Krishtit” etj. Të gjitha këto krijime pasqyrojnë aspekte të jetës politike të vendit gjatë viteve 1920-1924. Vjersha “Shën Pjetri mbi mangall”

pasqyron ngjarje reale të cilat i ndodhën Nolit pas ngjarjeve të dhjetorit të vitit 1924. Noli mbeti i braktisur nga miqtë, prandaj përdor simbolet biblike të mohimit të Shën Pjetrit, i cili e mohoi Zotin Krisht tri herë.

Mohimi i parë:

Dhe një shërbëtore i tha:

-”Je dhe ti një nga ata!”

Po Shën Pjetri proteston,

E mohon.

Mohimi i dytë:

-”Nga ata je: -thot ajo.

E mohon Shën Pjetri: “Jo!

“As e njoh, as e kam parë,

moj e marrë.”

Mohimi i tretë:

Thot ajo: “Je, mos gënje!”

Pjetri e mohon me be:

“Jo, për Zotin, moj e marrë,

s’jam e s’jam.

Kënga e këndezi simbolizon mohimin dhe tradhëtinë.

Kuspull mbi mangallin mblidhet,

Po djeg dorën dhe përdridhet,

Se ç’këndon bandill këndezi

Nga qymezi.

-Simon Pjetri, Bar Jona,

kështu ndahet kjo dynja:

Kryqi andej, këndej buxhaku  
Dhe allçaku.

Se ç'vajton Shën Pjetri hidhur,  
Leshlëshuar, duarlidhur  
Tri her' e mohoj pagdhirë,  
Faqenxirë.

Në vjershën “Moisiu në Mal” Noli përshkruan historinë e Kryeprofetit të Izraelit, i cili ngjitet në mal për të marrë porositë nga Zoti. Nëpërmjet Moisiut Noli flet për përpjekjet e tij, kur emigroi në Amerikë për të mos e parë më kurrë atdheun. Noli shfaq dhimbjen e tij, ashtu sikundër izraelitët u endën dyzet vjet me shpresën e tokës së premtuar, edhe ai nuk mundi ta shohë dot Shqipërinë e lirë. (*Mitrush Kuteli, Vepra Letrare, Nr. 5, faqe 280-285*).

Ngjitet përpjetë, Malit të shkretë  
Kryeprofiti, trim me fletë  
Të bisedojë me Perëndinë  
Për Palestinë.

Arrin në majë lart i kapitur  
Qëndron me frikë, pret i tronditur,  
Dhe Jehovaj i flet prej një reje  
Me zë rrufeje:

“Ti dhe të tjerët pleq do të ngelni,  
Tokën e Shenjtë kurrë s’e shkëlmi  
Skllëvër, bij-skllëvërish, s’e meritoni  
Se liri s’doni!”

Kryeprofitit dita i ngryset  
Dhe shpirt-këputur përdhe përmbysset,  
Me lot në sy, me zemër të ngrirë  
I lyp mëshirë.

Pse kaq gjatë, Zot, m'arratise,  
Pse më përplase, më përpëlise,  
Pse shpresën dyzet vjet m'a ushqeve,  
Dhe sot ma preve.

Poezia “Himni i flamurit” u botua në gazetën “Liria kombëtare” të Gjenevës.

O Flamur gjak, o flamur shkabë,  
o vend e vatr', o nën' e babë,  
lagur me lot, djegur me flakë,  
flamur i kuq, flamur i zi.

Fortesë shkëmbi, tmerr tirani,  
s'të tremb romani, as veneciani,  
as serb Dushani, as turk sulltani,  
flamur i madh për vegjëli.

Flamur që lint Shën Kostandinin,  
pajton islamin me Krishterimin,  
shpall midis feve vllazërimin,  
flamur bujar për njerëzi.

Këtë poezi Noli e ka shkruar më 14 nëntor të vitit 1926.  
Me anën e kësaj vjershe Noli tregon qëndresën e popullit tonë

ndër shekuj. Në poezinë “Krishti me kamxhikun” përdor shumë simbole të krishtera, të cilat me mjeshtëri i kthen me kuptim politik. Kështu me anën e figurave ungjillore Noli përshkruan ngjarjet që po kalonte Shqipëria në vitet 1920-1924.

Në kështjellë t’ atdheut, në tempull të fesë,  
janë shtruar sarafët pa shpirt e pa besë,  
tregëtojn’ e gënjejnë, rrëmbejn’ e sfrutojnë,  
thon’ ashtu Izraelin e mbrojn’ e shpëtojnë.

Shtrembërojnë kanunet, i marrin në dorë,  
dhe shkëlqejnë në kish’ e në fron me kurorë,  
vegjëlja për ta batërdisen dhe vriten  
dhe kështu parazitët gjakpirës po rriten.

Çdo i shenjt’ ideal, çdo shtëpi perëndie  
ishte bërë dyqan dhe pazar tregëtie:  
kush fitonte më tepër, ai ish usta,  
dhe kush nukë plaçkiste, ish krejt budalla.

Kur e pa këtë zi dhe këtë errësi,ë,  
Krisht’ i ëmbël u ndez dhe u bë i vështirë:  
me kamxhik e me fshikull sarafët i dëboi,  
dhe nga larot gjakpirës atdheun’ e shpëtoi.

Dhe shën Pjetri’ i gëzuar ahëri i tha:  
“Ja tani e ke nisur tamam, or usta!  
me kërbaç e me shpatë mbi ne mbretëro,  
dhe me forc’ e pahir na çliro, na shpëto”.

“Je gabuar, o Krisht, që u ke predikuar,  
se të marrët, të shurdhët s’kanë dëgjuar;  
ndreq kurrizin më parë, pastaj ndriço trurin,  
se shpirt-robi s’çlirohet askurrë pa drurin”.

Jesu Krishti s’dëgjoji dhe s’mori vesh mikun,  
dhe me lot i penduar e hodhi kamxhikun,  
dhe i tha: “S’e ka fajin kurrizi, po truri,  
se lirin’e sjell drita e mendjes, jo druri”.

Në personin e Krishtit nënkuptohen demokratët e asaj  
kohe (ndër ta edhe Noli), të cilët organizuan ngjarjet e qershorit  
1924. Kjo duket shumë qartë në vargjet:

Me kamxhik e me fshikull sarafët i dëboi,  
Dhe nga larot gjakpirës atdheun’ e shpëtoi. ...

Shën Pjetri simbolizon njerëzit, të cilët mendonin se duhej  
përdorur dhuna revolucionare, por Noli si fetar që ishte nuk e pranoi  
këtë gjë. Në këtë rast Krishti (Noli) nuk e dëgjoji këshillën e Pjetrit.  
Kjo shprehet me flakjen e kamxhikut:

Jesu Krishti s’dëgjoji dhe s’mori vesh mikun,  
Dhe me lot i penduar e hodhi kamxhikun,

Në poezinë “Marshi i Barabajt”, të cilën e shkroi në Vjenë,  
në nëntor të vitit 1927, Noli përdor përsëri motive biblike:

O stërnip i Kainit, teptil si bari,  
ti na shtyp e na shtrydh e ti gjakun na pi,  
ti na ther e na grin për qejf na bën fli:  
o kokuth e lubi, Hosana Baraba!

Me fjalën Kain nënkuptojmë vrasësin e vëllait. Gjithashtu  
edhe fjalën Baraba e ka huazuar nga Bibla. Barabai ishte kusari i

cili iu propozua turmës për t’iu falur jeta. Në këtë rast Noli i jep poezisë karakter alegorik. “Marshi i Barabait” quhet ndryshe “marshi i vrasësit”. (*Fan.S. Noli, Poezi të zgjedhura, Shtëpia Botuese e librit shkollor, Tiranë 1975*).

Te vjersha “Marshi i Krishtit” Noli përshkruan hyrjen e Mesisë në Jerusalem. Kjo ngjarje kremtohet në të dielën e dafinave.

Hosana o çlironjës, Mesi, hosana!  
Shtroni udhën me lule, dafin‘ e hurma,  
Brohoritni trumpeta, timpane, zurna,  
Thirr e zbras, o gurmas: Hosana, hosana!

Kryetrim, që lëfton, triumfon për atdhe,  
Shpëtimtar, kryemjek, kryeshenjt, kryefe,  
Pasuri, dhe liri, dhe fuqi ti na dhe,  
Lum e lum, Galile: Hosana, hosana!

O i biri i Davidit, i Miri bari  
Ti na prin dhe na rrit në luath e vërri  
Ti na ruan, na mpron, dhe për ne bëhesh fli,  
O njeri-Perëndi: Hosana, hosana!

Përmbi Dhe, përmi Fron, përmi Qiell u bekofsh,  
Përmi djall dhe tiran, përmi Ferr mbretërofsh,  
Me pean dhe temjan, dhe këmban’ u këndofsh,  
Drit’ e gas, rrofsh e qofsh: Hosana, hosana!

O i fort’ o i urt’ o i ëmbël Jesu,  
Plot me bes’ e me shpresë të biem mi gju,  
T’adhurojmë me zemër këtu e tëhu,

Gjithëkund e pa funt: Hosana, hosana!

Hosana, o çlironjës, Mesi, hosana!  
Shtroni udhën me lule, dafin' e hurma,  
Brohoritni trumpeta, tímpane, zurna,  
Thirr e zbras, o guemas: Hosana, hosana!

Hosanna është fjalë hebraike që do të thotë: *Shpëtona!* Populli izraelit këtë shprehje, e cila ishte pjesë e Psallmit 118 e përdorte gjatë *festës së kasolleve*. Ceremoninë e udhëhiqte gjithnjë prifti dhe turma e njëërëzve herë pas here thërriste *Hosana* duke tundur degët e dafinave. Ndërsa në rastin e hyrjes triumfale të Jesu Krishtit në Jerusalem turma e popullit brohoriste: “Hosana birit të Davidit! I bekuar është ai që vjen në emrin e Zotit! Hosana në më të lartat!” (Matheu 21,9). Në këtë poezi, Noli thirr më e ngazëllimit Hosana e përdor me ironi. Noli shkruan me mjaft ndjenjë vjershën “Kryqëzimi”.

Po troket çekani  
Po kërcet mejdani  
Dor' e këmb' i çpon,  
Krishtin kryqëzon.

Me tërbim goditin  
Me gjëmim e ngjitin  
Turma ulërin  
Nëna blegërin.

Çdo peronë plagë  
Përvëlon si flagë  
Çurka gjak buron



Fryhet dhe pikon.

Kryqet ngulen, shtiden,  
Tallen, qesëndisen;  
Sipër Kryqe tre,  
Tri Mari për-dhe.

### **Noli, përkthyes i teksteve liturgjike**

1-Në vitin 1908 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik “Shërbesat e Javës së Madhe”, 103 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të Javës së Madhe dhe të Pashkëve.

2-Më 1909 përktheu librin liturgjik “Shërbesa të Shenjta të Kishës Orthodhokse”, 246 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban shërbesat kryesore të Kishës Ortodokse lindore.

3-Në vitin 1911 përktheu librin liturgjik “Të kremtet e mëdha të Kishës Orthodhokse”, 318 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të të kremteve kryesore.

4-Më 1913 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik “Triodi i vogël”, 270 faqe, botuar nga qeveria rumune në Bukuresht dhe përmban himne dhe lexime të Kreshmëve dhe të Pashkëve.

5-Në vitin 1914 Imzot Theofani përktheu librin liturgjik “Lutësorja”, 96 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himnet e së Dielës në tetë zëra, Kanunin e Vogël dhe Kanunin e Madh të Shën Mërisë.

6-Në vitin 1914 Noli përktheu librin liturgjik “Pesëdhjetore e vogël”, 94 faqe, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në

Amerikë. Ky libër përmban himnet dhe leximet e të Dielave nga Pashkët deri te Rushajet dhe të Dielën e gjithë Shenjtorëve.

Gjatë viteve 1914-1952 Theofani, pasi u bëri një redaktim gjuhësor dhe pasi i plotësoi me disa urata që mungonin gjatë botimit të parë, përgatiti botimin e dytë të cilin e përmbloodhi në tre vëllime:

1-”Uratore e Kishës Orthodhokse”, 602 faqe, Boston 1941, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Në përkushtimin e librit lexojmë: “Të Përnderçmit At Kristo Negovanit, dëshmorit të Kishës Kombëtare, për kujtim të përjetmë”.

2-”Kremtorja e Kishës Orthodhokse”, 818 faqe, Boston 1947, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë.

3-”Triodi i vogël dhe Pesëdhjetorja”, 396 faqe, Boston 1952, botuar nga Kisha Ortodokse shqiptare në Amerikë. Ky libër përmban himne dhe lexime të kreshmëve, Pashkëve dhe rushajave.

Këto ribotime ndonëse janë më të plota përsëri lënë për të dëshiruar në krahasim me tekstet origjinale që përdoren në Kishën Ortodokse. Ashtu siç e thekson edhe vetë Theofan Noli në parathëniet e këtyre librave ai ka bërë një përkthim të lirë, duke i përpunuar himnet që t’i përshtaten melodisë e duke cenuar përmbajtjen e tekstit. (*Dhimitër Beduli, Noli dhe tekstet Liturgjike, Ngjallja, tetor 1995, faqe 3*).

Kostandin Trako në lidhje me muzikën e teksteve të përkthyer nga Noli është shprehur: “Meloditë bizantine që i ka harmonizuar vetë, përgjithësisht i gjejmë të punuara kështu: harmonia është kudo e plotë dhe mjaft e pasuruar me ornamente. Akordet shkëmbehen shpeshherë me lëvizje të rregullshme... Hirësia e Tij me përdorimin e shpeshtë të kësaj mënyre, sikur abuzon pak, gjë që bën që melodia zhduket ose më mirë humbet karakterin e saj. Gjithashtu nuk na duken me vend akordet perfekte minore

të gradit të tretë të një tonaliteti të caktuar, në meloditë bizantine, akord që vlen gjithmonë në fillim të pjesëve muzikore, si dhe akordi perfekt mazhor i përdorur në Vajtimet, pikërisht në stanzën e parë”.  
(*Eno Koço, Trako-Nolit, jo ndikimit të muzikës bizantine, Tema, 9 nëntor 2004, faqe 9*).

## **VISARION XHUVANI (1887-1965)**

Visarion Xhuvani ka lindur më 1 maj 1887 në Lagjen Kala të Elbasanit. Studimet e mesme i kreu në Shkollën Kishtare të Athinës. Në vitet 1911-1914 ndoqi studimet e larta për Teologji në Universitetin e Athinës. Më pas vijoi me studimet pasuniversitare, në përfundim të të cilave mori gradën “Doktor” dhe në vitin 1918 u emërua Lektor në Fakultetin Teologjik të Universitetit të Athinës. Po këtë vit u dorëzua në gradën priftërore nga Mitropoliti Jakov dhe pas një viti filloi punën misionare në Sofje të Bullgarisë. Më 1919 është misionar në Rumani për të organizuar komuntetin shqiptar. Në 29 nëntor të vitit 1919 Visarioni mori ofiqin e Arkimandritit dhe ishte kandidat për gradën episkopale. Në janar të vitit 1920 Kongresi i Lushnjës e zgjodhi aanëtar të Këshillit të Naltë (parlamentit të kohës) dhe në zgjedhjet e vitit 1922 u bë deputet i Durrësit. Në shtator 1922 ka marrë pjesë aktive në Kongresin e parë panortodoks të Beratit, në të cilin u propozua kandidat për episkop. Më tre maj të vitit 1925 Arkimandrit Visarioni, duke marrë bekimin e patrikut të Serbisë Dhimitrit, u dorëzua në gradën episkopale në Hercegnov (Kotor) prej dy episkopëve rusë Ermogenit të Ekaterinosllavit dhe Mihailit të Aleksandrovskit. Në vitin 1936 Kryeepiskop Visarioni dha vetë dorëheqjen nga kryesia

e kishës. (*Nos Xhuvani, Visarion Xhuvani apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare, Tiranë 2003*).

### **Vepra e Visarionit**

Imzot Visarioni ka qenë pjesëmarrës kryesor në të gjitha përpjekjet për njohjen e autoqefalisë dhe dora vendimtare për organizimin strukturor hierarkik të kishës shqiptare. Mendimet dhe pikëpamjet e tij për këtë problem i ka botuar më 1926 në dy broshura me titullin: “Çështje politiko-religjioze, Kostandinopojë-Tiranë”, ku ndër të tjera ka trajtuar këto çështje: 1) Kisha Ortodokse Shqiptare dhe Patriarkana e Kostandinopojës. 2) Ndërhyrjet e Patriarkanës së Kostandinopojës. 3) Episkopët e huaj në Shqipëri. 4) Gjuha e huaj në kishë. 5) Gjuha e huaj në shkollat shqiptare etj.

Imzot Visarioni duke u mbështetur në ndihmën e pakursyer që i premtoi qeveria dhe mbreti, si dhe me shpresë se do të gëzonte përkrahjen e Kishave Ortodokse të Serbisë dhe të Rumanisë, mori përsipër të zgjidhte problemin e autoqefalisë së Kishës Ortodokse. Më 12 shkurt 1929 u bë dorëzimi i episkopëve dhe disa ditë më vonë më 18 shkurt 1929 Imzot Visarioni me mbështetjen e qeverisë shqiptare formoi Sinodin e Shenjtë të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë, i cili përbëhej nga Fortlumturia e Tij Visarioni, Kryeepiskop i gjithë Shqipërisë, që kishte në juridiksion Mitropolinë e Korçës, Imzot Agathangjeli Mitropolit i Beratit, Imzot Efthimi Mitropolit ndihmës i Kryeepiskopit dhe Imzot Ambrozi Mitropolit i Drinopulit (Gjirokastrës). Mesha e parë episkopale u celebrua më 24 shkurt 1929 në Kishën e Shën Gjergjit në Korçë.

Fortlumturia e Tij Visarioni menjëherë filloi të konsolidonte strukturat e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Kështu më 16 qershor 1929 thirri Kongresin e dytë Kleriko-laik në qytetin e Korçës, i cili plotësoi Statutin e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë të miratuar në Kongresin e Beratit. Kongresi i Korçës vendosi krijimin e një këshilli për administrimin e pasurive të kishës. U vendos ndarja kishtare në bazë dioqeze duke formuar dioqezat e Korçës, Durrësit, Beratit dhe Gjirokastrës. Duhet theksuar se prej vitit 1922 e deri më 1929 qendra kishtare ishte Korça, ndërsa duke filluar nga viti 1930 kaloi në Tiranë duke marrë emrin Mitropolia e Tiranës, Durrësit dhe Elbasanit. Kryepiskop Visarioni, vazhdoi punën me organizimin e strukturave të kishës duke çelur në Durrës një kurs për përgatitjen e priftërinjve, i cili vite më vonë më 1930 u kthye në seminar katërvjeçar. Dërgoi studentë nëpër universitetet teologjike jashtë shtetit dhe më pas krijoi një komision për përkthimin dhe botimin e librave liturgjikë në gjuhën shqipe etj. (*Andrea Llukani, Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse, 55, 21 maj 2004, faqe 18*).

Nën drejtimin e Sinodit të kryesuar prej Kryepeshkopit

Imzot Visarionit u rishqyrtuan këta libra liturgjikë:

1. U botua Ungjilli i gjithë shërbimeve të shenjta për çdo nevojë fetare të popullit, si dhe mesha e shenjtë me të gjitha pjesët e mëngjesorit dhe të mbramësore.
2. U botua Ungjilli i madh, i ndarë në 365 pjesë të përditshme.
3. U botua Apostulli (letrat dhe vepra e Apostujve) i ndarë në 365 pjesë të përditshme sipas Rregullores së Ortodoksisë.
4. U botua Libri i të Kremteve të mëdha (përmbledhje e 12 librave të të kremteve të çdo muaji të vitit).
5. U botua libri i Shërbesës së Vajit të bekuar”.

Këto botime plotësuan nevojat e klerikëve për të kryer të gjitha shërbesat fetare në gjuhën shqipe. Lutjet dhe litanitë e lëçitura në gjuhën shqipe u bënë më të kuptueshme për besimtarët ortodoksë shqiptarë. Gjatë këtyre viteve që grigjën ortodokse e drejtoi Visarioni, u botuan 22 numrat e revistës “Kisha Kombëtare”, në të cilën klerikët dhe besimtarët shqiptarë patën mjaft materiale për edukimin fetaro-kombëtar. Kryepeshkopin Visarion Xhuvani e ka preokupuar shumë edhe e ardhmja e gjuhës shqipe në kishë, sidomos roli i mësimit të gjuhës amtare për fëmijët, të cilët i ka cilësuar si e ardhmja e ndritur e kombit. Për këtë arsye ai dha mbështetjen e rëndësishme për përkthimin e 15 librave për fëmijë: Historia e Dhiatës së Vjetër; Historia e Dhiatës së Re; Katekizma Kristiane; Lutjesori i Vogël; Libri i Mistereve; Historia Kishtare; Dogmatika; Spjegime Ungjijsh; Misionari; Morali; Arkeologjia Biblike etj. Më 1926 Fortlunturia e Tij, Visarioni botoi librin “Kujtim vepre dhe intrige”. (*Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, Si e miratuan ortodoksët shqiptarë predikimin në shqip, Tema, 2-3 tetor 2005, faqe 15*).

## **Kujtim Vepre dhe intrige**

Nji letër e Fan Nolit

Më 1920, kur nuk ishte intrigue

Boston, Mass 7 Mars 1920.

Fort i Përnderçim Arkimandrit dhe i dashur vëlla më Krishtin.

Një zonjë Amerikane e kryqit kuq e cila arriu këto ditë në Boston, më dha lajmën gazmore qi jini vendosur në Elbasan, që

meshoni shqip, qi përpiqeni t' a çlironi kishën tonë nga zgjedha e huaj, që kini fituar simpathinë dhe përkrahjen e popullit për veprën tuaj fisnike, dhe shumë gjëra të tjera të mira, të cilat e ngrenë nderin tuaj dhe të Elbasanit shumë lart. Po kjo nuk është hera e parë që e dëgjonj emrin tuaj për të mirë. Miku ynë Z. Kristo Luarasi më shkroj gjer e gjatë nga Sofja për ju dhe për meshën që bëtë atje. Letra e tij u-botua në gazetën “Dielli” dhe i gëzoj pa masë besnikët e kishës shqipe përkëtej Oqeanit, të cilët shofin në fytyrën tuaj një nga ushtarët më të mirë të ungjillit në Shqipri. Dëshëronja t’ju shkruanja prej kohe, po nuk dinja ku ndodheshit, dhe kjo është hera e parë që dëgjonj që arritët shëndoshë e mirë në Shqipri dhe që i jini përveshur punës së shenjtë për të ndriçuar popullin tonë të mjerë. Ju lutem shumë të kini mirsinë të më lajmëroni hollsisht si vete misioni juaj dhe cilat janë ndjenjat e popullit për kishën kombëtare aqë në Elbasan sa dhe kudo gjetkë në Shqipri. Këtu s’ marrim lajme nga Atdheu veç fare rrallë, dhe që kur krisi lufta, Zonja amerikane, për të cilën ju fola më sipër, më solli të vetëmin dhe të parin oshtim të lëvizjes kishtarë s’ andejmi. Po tani, me ndodhjen tuaj në Elbasan kam shpresë të dëgjonj më dendur, më tepër dhe më mirë dita me ditën. Ju përshëndosh vllazërisht dhe mbetem shërbëtor dhe vllaj juaj në Krishtin. (*Visarion Xhuvani, Kujtim vepre dhe intrige, Shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926, faqe 3*).

## ANTON HARAPI (1888-1946)

Anton Harapi ka lindur në Shirokë të Shkodrës më 5 janar të vitit 1888. Në moshë të vogël hyri në kolegjin jezuit dhe në vijim në atë françeskan. Në vitin 1907 ndoqi studimet e larta për teologji në Salsburg të Austrisë. Studimet filozofike i kreu në Universitetin e Vjenës. Në vitin 1910 vjen në Shqipëri ku shugurohet meshtar. Gjatë viteve 1912-1913 shërbeu në Kishën e Arrës së Madhe, ndërsa më vonë në Dukagjin. Patër Antoni në vitin 1924 emërohet drejtor i gjimnazit “Illyricum” dhe drejtor i revistës “Hylli i Dritës”. A. Harapi ka botuar më shumë se 70 artikuj. Në vitin 1925 ai botoi librin “Edukata e fëmijëve”, më 1936 botoi “Vlera shpirtërore”, më 1933 “Andrra e Pretashit” etj. Ai ka qenë shkrimtar, filozof dhe gojëtar. Më 8 qershor 1945 Patër Anton Arapin e arrestojnë në Plan të Dukagjinit. Pas gjyqimit atë e dënojnë me vdekje. Më 20 shkurt 1946 kur ishte në moshën 58-vjeçare pushkatohet në rrethinat e Tiranës. (*Pjetër Pepa, Si u pushkatua regjenti, gjeniu Patër Anton Harapi, 55, 6 dhjetor 2005, faqe 6*).

Në varrimin e Çerçiz Topullit dhe Muço Qullit, midis të tjerëve foli edhe Atë Anton Harapi. Më 1936, me rastin e përcjelljes së eshtrave të dy patriotëve nga Shkodra, Patër Antoni mbajti ligjëratën “Dy fjalë dhe një betim”:

-Ndaluni! Ku veni burra?!...Çerçiz e Muço, dy fjalë ka me ju Shkodra kreshnike, këtu në log të kuvendit, përpara se të ndahemi. Doni ta leni Shkodrën dhe të shkoni e të pushoni atje ku së pari patë të amblat rreze të diellit; atje ku si filiza të shëndoshë e të gëzueshëm e rritët shtatin; atje prej kah Shqipnia ju qiti dhe ju ndriti! Le të lavdërohen për ju Gjirokastra dhe Leskoviku, vendet ku ju u lindët për jetë, por asnji grimë ma pak nuk do të gëzohet



Shkodra, vendi ku ju nuk vdiqët, por u lindët për Atdhe. Njimend se ata ju dhanë tamblin e gjiut dhe ju janë nana të natyrshme, po e ju tashma nuk jeni shqiptarë të çfardoshëm; por ju jeni heronj, jeni burra shqiptarë. Dhe si të tillë ju priti dhe ju mbajti Shkodra.

E sot, si të tillë, me gëzim po ju përcjell Shkodra, lama dhe nana e heroizmit tuej. Jo, nuk ju lëshon ju Shkodër locja ambël pa ju puthë ndër të dyja faqet, thekshëm pa ju lëmue të dy krahët, përmallshëm pa derdhë dy pika loti – lot gëzimi e pikëllimi! – mbi eshtnat tuej. Eshtna të pamort, ju fale! Të pavdekshëm po, sepse ndër vemë tueja ruejeni një visar të çmueshëm, një ideal i cili i patrandun do të mbesë ndër ne deri sa të jetë Shqipnia.

E udha e mbarë ju qoftë! Veç, o burra, që të vdekun flisni, të mbetun ngjalleni, të humbun sot ndritni, - kahdo që rreth e rrotull do t' i bini Shqipnisë, deh!, lëshojeni një za, atë zanin tuej kumbues si të luajve dhe diftojini djelmënisë shqiptare shka ju a ushqeni idealin, shka ju a mbajti karakterin, shka ju bani të pavdekshëm. Diftojini po, se ka e do të ketë Shqipni përderisa të kemi dhe të mbajmë një Zot mbi vete; ka po, Shqipni derisa gjaku i gjallë të vlijë në kujtim dhe ndër ndjesi të shqiptarëve, derisa në Shqipni, pa dallim krahine e besimi, të çmohen e të madhnohen themeluesit e Atdheut. Kemi pse të jemi e të mbahemi shqiptarë përderi sa të shenjtë ta ruejm besën dhe burrninë. Me tanë fuqinë tuej vigane, m'ia bani një urim Shqipnisë: m' i ndjellni të mbarë e përparim, paqe e ngallnjim. (*Leksionet e Anton Harapit për respektimin e dëshmorëve të atdheut, 55, 30 dhjetor 2005, faqe 7*).

## LASGUSH PORADECI (1899-1987)

Lasgush Poradeci (Llazar Gusho) ka lindur më 27 dhjetor 1899 në Pogradec. Prindërit e tij kanë qenë fetarë. Çdo të dielë merrnin fëmijët dhe shkonin në kishën “Fjetja e Shën Mërisë” në qytetin e Pogradecit, ku ndiznin qirinj, puthnin ikonat e shenjta dhe ndiqnin Liturgjinë Hyjnore. Gjithashtu në shtëpinë e tyre luteshin vazhdimisht. Nëna e tij në dhomë kishte ikonën e Hyjlindëses, ndërsa në dhomën ku flinte Lasgushi ishte ikona e Shën Llazarit. Sipas Ismail Kadaresë, në moshën e fëmijërisë e kishin shpënë në manastirin e Shën Naumit për t’i hequr xhindet. Aty ishte njohur me murgj rusë, të cilët i kishin folur për Dostojevskin.

Në moshën 10-vjeçare vajti për t’u shkolluar në Manastir dhe vite më vonë përfundoi liceun në Athinë. Më 1921 u nis për të kryer studimet e larta në Rumani. L. Poradeci pati fatin të studionte në tre shtete, ku ndikimi i fesë ortodokse në popull ishte i madh. Tingujt e kambanave të qyteteve të Athinës, Manastirit dhe Bukureshtit e ftonin të vinte në kishë për të ndjekur shërbesat fetare. Llazar Gusho hynte në kishë, bënte kryqin dhe lutej me shprestari. Gjithnjë i kujtoheshin fjalët e nënës: “Bir, atje ku do të vesh, s’ka nënë e babë, motra e vëllezër, atje do të kesh mbi kokë Perëndinë!”. Në Bukuresht u lidh me lëvizjen atdhetare të kolonisë shqiptare dhe u zgjodh sekretar i përgjithshëm. Më 1924 mundi të siguronte një bursë studimi nga qeveria e Fan Nolit për në Fakultetin e Filologjisë në Grac të Austrisë. Gjithashtu besimin tek Perëndia ia kultivuan edhe dy miqtë e tij Fan Noli dhe Gjergj Fishta. Këta klerikë Lasgushi i nderonte dhe i respektonte. *(Tomi Mato, Lasgushi, a ka qenë apo jo fetar?, 55, 10 nëntor 2005, faqe 19).*

## Poezia e Poradecit

Krijimtaria letrare e Lasgush Poradecit fillon më 1933 kur botoi vëllimin e parë me poezi “Vallja e yjeve”. Më 1937 botoi vëllimin “Ylli i zemrës”. Gjithashtu ka shkruar poemat: “Ekskursioni teologjik i Sokratit”, “Kamadeva”, “Mbi ta” etj. Ndjenjat fetare të Poradecit shfaqen në krijimtarinë e tij letrare. Në poezinë “Zog i Qiejve” Lasgushi paraqet gjithë jetën e tij. Zogu është vetë Llazari, të cilit jeta në tokë iu bë e padurueshme, ndaj ëndërron të fluturojë lart në qiell dhe të jetojë në parajsë, afër Perëndisë.

Këng e tij më ngjan kulluar,  
Posi këng’ e Zotit vetë,  
E prandaj, duke filluar, aty lart i shpie kryet  
Dh’ i ngreh sipër e më sipër,  
Gjersa qafa mend i thyhet.  
Asokohe ndjen si dridhet,  
Me një zë pa shëmbëllim,  
Asohere e ndjen si foli:  
Të jam falë - O Zoti im!

Lasgushi e di mirë se jeta këtu në tokë është e vështirë, sepse cmirëzinjtë mundohen ta luftojnë, ndërsa pushtetarët e fyejnë. Këshu poeti kërkon të ngjitet lart në qiell për të sfiduar jetën e vështirë që kaloi në këtë botë.

Që nga bota njerëzore, ku këndoj me shpirtin plot,  
Prit-e prit! Se po t’ afrohet Zog’ i Qiejve, o Zot!  
Fal-i këngëtor-finoshit, gas të thjeshtë mu në gji;  
Posi lot në rreze dielli, ndrit-e në Përjetësi!

Poeti e ëndërron përjetësinë, prandaj kërkon të fluturojë. Kjo shihet edhe në një krijim tjetër të tij, në poezinë “Vallja e Përjetësisë”.

Marr të rënët që përdhe,  
Marr të thellët nënë dhe,  
Po që lart prej Qenies vetë  
Marr e jap përjetësi.

Përjetësia ishte lajtmotivi i jetës së mundimshme të Poradecit. Poezia “Shpirtit” tregon më së miri shprestarinë e Lasgushit.

Të lus, o Lajmës i qielluar!  
O Frym’ e Zotit, vetë Zot!  
Me hirin t’ënd të pashteruar  
Që ka mburim përjetësije,  
Hirplot, o Shpirt, nër gaze Ti-je.  
Dhe nër mjerime je hirplot!

Ti botës s’onë-i prure lajmin  
E nj’ëndërimi të pafaj:  
Për mallin t’ënd me të pastajmin  
Ti kuvendon që përmbi botë,  
Dhe në gëzim i bije lotë,  
I bije gas në zi të saj.

Në vitin 1939 Llazar Gusho vuri kurorë në kishën “Fjetja e Shën Mërisë” në qytetin e Pogradecit. Gjithë jetën ka qenë fetar dhe njeri i përkushtuar. Madje edhe vajzat i edukoi me frikë Perëndie. Çdo të diel ai shkonte në kishë së bashku me të bijat Kostandinën dhe Marien. Lasgushi kishte miqësi me Atë Erazmi Jorgon, teologun Dhimitër Beduli dhe shumë klerikë të tjerë.

## **Përkthimet e Lasgushit**

Poradeci ka përkthyer disa nga kryeveprat e letërsisë botërore: “Eugjen Onjegin” e Pushkinin, lirikat e Gëtes, poemat e Hajnes, poezi të Hygoit, Brehtit, Bajronit, Bërnsit, Majakovskit etj. Në vitin 1943 Lasgush Poradeci ka përkthyer për Kishën Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë librin e shkrimtarit zviceran H. Zschoke “Stunden der Andacht”, i cili u çua për botim në shtypshkronjën “Gutenberg”. (*Dhimitër Beduli, Përmes shkrimeve, Neraida, Tiranë 2006, faqe 75*).

Lasgush Poradeci vdiq më 12 nëntor 1987. Vepra e tij e plotë mundi të botohej vetëm më 1989. Me krijimtarinë e tij të pasur Poradeci është nga lirikët më të mëdhenj shqiptarë.

## **ERNEST KOLIQUI (1903-1975)**

Ernest Koliqi ka lindur në Shkodër më 20 maj 1903. Studioi në Kolegjin Saverian në qytetin e lindjes. Në vitin 1933 ndoqi studimet e larta në Universitetin e Padovës. Pas përfundimit të studimeve, më 1936, u emërua lektor i gjuhës shqipe po në atë universitet dhe më 1937 mbrojti doktoranturën me temë: “Epika popullore shqipe”. Më 1939 e gjejmë në Universitetin Shtetëror të Romës si Ordinar i Seksionit të Albanologjisë. E. Koliqi gjatë viteve 1939-1942 ka qenë ministër i Arsimit në Shqipëri. Me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore Koliqi kthehet në Katedrën e Albanologjisë në Universitetin e Romës. Veprat më të njohura të Koliqit janë: “Kushtrimi i Skanderbeut”, “Hija e maleve”, “Gjurnat e stinëve” (1934), “Tregtar flamujsh” (1935), si dhe studimet letrare mbi dy Kolegjet shkodrane, të Jezuitëve dhe Françeskanëve, “Mbi

reflekset lindore në Letërsinë Shqipe”, “Mbi artin krijimtar të rapsodëve të maleve të veriut të Shqipnisë”, të cilat i botoi në revistat “Hylli i Dritës”, “Leka”, “Ora e Maleve” etj. E. Koliqi ka vdekur më 15 janar 1975. Vepra e tij është vlerësuar vetëm në vitet e demokracisë, kështu në vitin 2005 krijimtaria letrare e Koliqit është vlerësuar me “Pendën e artë”. Nga krijimtaria e E. Koliqit kam përzgjedhur poezinë “Lutja e dëshprueme”. (*Flori Slatina, Penda e artë për Ernest Koliqin, 55, 23 dhjetor 2005, faqe 16*).

O Perëndi, na tokën pranuem qi Ti na fale,  
n'te tash tridhjet' qindravjeta na u end e ndershme jet,  
jetuem m'kto troje t'vobta, n'kto brigje t'thata e t'shkreta,  
ngujue larg botës tjetër, pa dijt' ç'janë miradinat,  
pa njoft' doket e lmueta të kombeve fatbardha.

Me mzi strehuem trupin nga shiu e breshni e mardha,  
n'kasolle e stane t'brishta qi shpërthejshin duhinat,  
pa dijt' qejfet e holla, pa dijt' ç'janë miradinat,  
pa njoft' doket e lmueta të kombeve fatbardha.

E, pra, t'ushqyem n'kto gryka me bukë kollomoqe  
Qi e zbutshin n'uj të kronit, s'lypshin kurrnga ma shum,  
sepse bylmet na kishin një liri t'thjesht, t'pashoqe,  
qi me hiret e veta na e bante gjakun t'lum.

Nanat me qumsht' të pastër andjen n'shpirt t'on' dikojshin  
me fluturue si shqipe në qiell t'ndjerit shqiptar,  
n'flak t'dokeve m'u kndellun e n'zjarrm t'buzmit bujar,  
qi kobin e zvetnimit nga votra na e largojshin.

O Perëndi, ndër shekuj uja buzën na e zverdhi,  
shpesh u errëm pa hangër bukën m'e ruejt' për fmin  
e mitun q'ish n'e rritun, por n'qe i mik në shpin  
na msyni, ia vum para at buk mikut kur erdhi.

### **MITRUSH KUTELI (1907-1967)**

Mitrush Kuteli ka lindur në qytetin e Pogradecit më 13 shtator të vitit 1907. Shkollën fillore e kreu në vendlindje. Studimet e larta i bëri në shkollën tregtare rumune të Selanikut. Në vijim vete në Bukuresht, ku kreu Akademinë e Shkencave Ekonomike. Në vitin 1934 mori titullin “Doktor i Shkencave Ekonomike”. Më 1942 u kthye në atdhe ku punoi si përkthyes. Më 1938 Kuteli botoi në Kostancë “Net shqiptare”. Libri u botua në shtypshkronjën “Albania” të Kostancës dhe pati jehonë të shqiptarët e Rumanisë. Vitet 1943-1944 qenë më të frytshmet në krijimtarinë e M. Kutelit. Ai botoi njëri pas tjetrit librat “Ago Jakupi”, “Sulm e lotë”, “Rrëfime-rëfenja”, “Shënime letrare”, “Këngë e britma nga qyteti i djegur”, “Mall e brengë”, “Tregime të moçme shqiptare” etj. (*Nasho Jorgaqi, Mitrush Kuteli, Vepra Letrare 1, faqe 11-150.*

### **Poezia e Kutelit**

Kuteli në krijimtarinë e tij përshkruan shumë ndodhi të jetës. Në vitin 1943 fashistët i vranë babanë dhe i dogjën shtëpinë që kishte në Pogradec. Kjo ngjarje e hidhur e shtyu Kutelin që dhimbjen ta hidhte në poezinë “Kartë nga Shëndaumi”.

Kjo zonjë e rëndë Shërmëri,  
Kjo nënë e vuar Shërmëri,

Veshur me 'rgjënd e me flori,  
Në dorë një qiri.

I bie më gju, bëj metani,  
Një herë, dy, dyzet e tri,  
“E madhe je, moj Shërmëri,  
Ti dorëlarë me flori.

Me poezinë “Efremi i Gjinit” Kuteli satirizon ata shqiptarë, të cilët për hir të ineresit kanë ndërruar kombësinë. Kjo poezi është shumë aktuale për kohën e sotme.

Efremi i Gjinit, renegat Elbasani,  
Vetveten ç’ e shpalli vorioepirot:  
Kuleta e Llasos pare kish plot,  
Pra për Heladën furrë i digjej xhani.

Në Korçë brenda kurdiste komplot,  
Dhe hapte helmin që hidhte Junani.  
Themistokliu ish vrarë... Pra, hajvani  
Pandehte se Korça kish mbetur pa zot.

Kambanat binin, meshonte dhespoti...  
Efremi mbante fjalime te Stema:  
“Shqiponjën në Korçë nuk e zë moti,

Pra, burra, tyxharë, kërkoni Greqi!”  
Por kupa u mbush dhe trimi Pasa Pema  
Me plumb e shtriu renegatin e zi.

M. Kuteli në poezinë “Të falem ty” tregon shprestarinë e tij ndaj ortodoksisë.



Të falem ty, fe e lashtë e vendit  
Tim e mburuar drejtpërdrejt nga  
Fjala dhe e njësuar me Fjalën.  
Të falem ty, fe e qëndrimit dhe e  
Durimit, fe e martirëve dhe e  
Dëshmorëve, fe e paqes dhe e drejtësisë.

Të falem ty, fe e gjyshëve  
zemërbardhë e shpirtmëdhenj, që të  
përqaftuan sapo u linde e si u linde,  
që të mbajtën të përgjakur e të  
përlotur një kohë me gjuhën e kombit.

Ti i dhe kombit tim dritën e Ungjillit  
dhe kombi im të fali Shën Kostandinin  
dhe mijëra martirë, që me gjakun e tyre  
I bënë të përjetshme themelet tona.

Ti frymëzove Joanin e Vojsavën,  
Në qëndrimin e tyre të përlotur e  
të përgjakur për mbrojtjen e kësaj toke.  
Ti na dhe zemërgurin Gjergj Kastriotin.  
Që i vuri gjoksin rrebeshit të Azisë.

Ndaj teje, fe e shën Jonit dhe e Shën Marenës,  
thyhet gjuri im si u pat thyer gjuri i atit,  
I gjyshit dhe i stërgjyshit gjer në njëzet breza.  
Ndaj teje fe e manastireve të gurtë,  
E ajazmave të shenjta, e altarëve të rrënuar,

Kodër më kodër të përhapura në gjithë vendin tim  
Ne shtojmë shpirtrat tona të përvojtura dhe mbështesim  
Shpresat tona, gjithmonë të gjalla e të patundura.

Të jam falur e do të falen ty,  
fe e shenjtë e Papa Kristos nga Negovani,  
e Papa Dhimitrit nga Ballkameni  
dhe e të gjithë martirëve të ungjillit shqiptar.  
Ti i mbajte kombit tonë  
legjendat e Kostandinëve e të Garentinave,  
këngët e stërlashta, zakonet e mburura,  
nga vetë fryma e kësaj toke dhe e këtij kombi.  
Mbulesë e shënjtë kundrejt breshit e kohës.

### **Proza e Kutelit**

Proza kuteliane lidhet me traditën gojore, legjendat dhe baladat e jugut të Shqipërisë. M. Kuteli synon drejt përsosjes shpirtërore duke zbatuar normat e moralit kristjan. Nga krijimet më të bukura të Kutelit është libri “E madhe është gjëma e mëkatit”, ku në çdo fjalë të rrëfimit ndihet brumi i butë i gatuar në magjen e lashtë të shqiptarëve. Nën vellon e legjendës, nën dritën e shkrimeve të shenjta dhe jehonën sensuale të “Këngës së Këngëve” të Sollomonit dhe grishjes tunduese të Ekleziastit, kumbon madhërisht himni i dashurisë së pastër, i përsosmërisë morale, të kurorëzuar me butësinë e fesë së krishterë, të cilat triumfojnë mbi prapësitë e botës materiale. Në legjendat më të hershme përshkruhet dënimi i mëkatarëve nga Zoti. Ky motiv për shumë kohë zuri vend në letërsinë e krishterë. Mund të përmendim rapsodinë e shkrimtarit gjerman Daniel Shubart të titulluar “Der

Evige Jude” (Çifuti i përjetshëm) përmbajtja e së cilës është: Krishti, gjatë rrugës së mundimit me kryqin e rëndë mbi shpinë, donte të çlodhej pak para shtëpisë së çifutit Ahasverin, por ai e dëboi. Atëhere engjëlli i vdekjes e dënoi Ahasverin duke i thënë:

Ti që mohove prehjen e Birit të Njeriut,  
Edhe ty, o i panjerëzishëm,  
Do të mohohet prehja...

Gjithsesi engjëlli e fali Ahasverin. Nëse krahasojmë këto dy poema, ajo e Kutelit është më e plotë. Mitrush Kuteli i vendos ngjarjet në tokën e lashtë ilire. Ai na jep një përshkrim të bukur të liqenit të Ohrit. Në qendër të rrëfimit është një prift arbëror, i cili tundohet dhe bie në mëkat, por gjen forca për t’u penduar dhe rilindur në një jetë të re. (*Petraq Kolevica, Parathënia e librit E madhe është gjëma e mëkatit, Tiranë 2000, faqe 7-9*).

E madhe është gjëma e mëkatit,  
Po e madhe është fuqia e hirit të priftërisë,  
Sepse ndaj Zotit të pamundur  
Bëhen të mundura, me anë të hirit të fjalës.

Që në faqen e parë të librit shkrimtari thekson se ka shfrytëzuar dy legjenda të dëguara në qytetin e Pogradecit. (*Mitrush Kuteli, E madhe është gjëma e mëkatit, Tiranë 2000, faqe 11*).

### **Përkthimet e Kutelit**

Pasi doli nga burgu, M. Kuteli, i persekutuar nga cmira dhe ligësia e kolegëve, për 15 vjet (1952-1967) u detyrua që të punonte si përkthyes. Nga rusishtja përktheu 20 libra: “Kujtimet e një gjahtari” të Turgenjev, “Tregimet e Petërburgut” dhe “Shpirtra të vdekura” të Gogolit, “Zotërinjtë Golloviövë” të Sllatikov Shçedrinit, vepra të Gorkit, Tolstoit, Paustovskit etj.

Nga rumanishtja përktheu pesë libra, prej të cilëve më i spikaturi ishte ai me poezitë e Mihail Emineskut. Kuteli ka qenë mjeshër i shqipërimin. Në poezitë e Emineskut në ato raste ku përkthimi nuk përkonte me gjuhën shqipe ai ka përdorur trajta të veçanta të shqipes. Për shembull: “M’i përngjan një ruspi pralle”, në vend të origjinalit “Ti i ngjan një princi”, ose “E virgjërë Maris” në vendin e origjinalit “Gjithmon virgjërës Maris”, “Në këmbët e Zotit Krisht”, në vend të origjinalit “Në këmbët e Krishtit” etj. Në vëllimin “Zgjohu druvar”, Kuteli ka mbledhur përralla të popujve të ndryshëm, të cilat përbëjnë rreth 7000 faqe. Mitrush Kuteli pas një jete të vështirë që kaloi, ia dorëzoi shpitrin Perëndisë më 4 maj të vitit 1967.

### **MIGJENI (1911-1938)**

Millosh Gjergj Nikolla ka lindur në Shkodër më 23 tetor 1911. Pasi kishte jetuar disa vjet tek e motra Lenka, sepse i kishin vdekur rradhazi, nëna, i ati, vëllai dhe gjatë kohës që studionte në gjimnaz Milloshi merr edhe një goditje tjetër. I vdiq gjyshja e dashur, Stanka, në vitin 1926. Milloshit jetim tashmë në qytetin e lindjes, Shkodër, nuk i kishte mbetur anjë i afërm, sepse motrat qenë martuar. Për të u kujdes i ungji Jovan, i cili i siguroi një bursë nga kisha serbe për në seminarin teologjik. Në moshën 13-vjeçare u regjistrua në Seminarin Teologjik “Joan Theologu” të Manastirit.

Migjeni ishte nxënës mesatar, megjithëse nuk i mungonte zgjuarsia. Në Seminarin Teologjik përgatiteshin priftërinj, psaltë dhe mësues katekizmi. Aty mësonin kryesisht nxënës të shtresave të varfra nga Maqedonia, Serbia, Kosova dhe Shqipëria. Në

Seminarin e Manastirit kanë studiuar rreth 40 shqiptarë, Millosh Gjergj Nikolla, Vasil Shanto, Jordan Misja, Theofan Popa, Petro Doçi etj. Prej tyre jo të gjithë ndoqën udhën e fesë. Nxënësi më i mirë i Seminarit ishte një shqiptar nga Pogradeci, i cili quhej Pandeli Papaanastasi. Ky i fundit ishte miku më i mirë i Migjenit, ndofta dhe i vetëm. Ata i bashkonte jo vetëm intelekti, të cilin Pandi e manifestonte në mësim, ndërsa Migjeni e kishte në thellësi dhe do ta shfaqte më vonë. Ajo që i bashkonte ishte edhe psalmodhia, madje Pandeliu ishte dirigjenti i korit bizantin të Seminarit. Në provimin përfundimtar të Seminarit Migjeni trajtoi temën: “Dy natyrat e Krishtit”. Pas përfundimit të Seminarit udhët e tyre u ndanë, Pandeliu ndoqi Fakultetin Teologjik të Beogradit, ndërsa Milloshi nuk pati mundësi që të vazhdonte studimet e mëtejshme teologjike dhe u bë mësues.

Më 23 prill të vitit 1933 Milloshi filloi punë si mësues në shkollën “Skënderbeg” të fshatit Vrakë në rrethin e Shkodrës. Një muaj më vonë botoi në Revistën “Illyria” skicën satirike “Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun”, të nënshkruar me një emër të ri, Migjeni, me të cilin do ta njihte mbarë bota shqiptare. (*Nasho Jorgaqi, Udhëve të mërgimit, Tiranë 1994, faqe 97-141*).

Migjeni ka shkruar dy libra, “Vargjet e lira” në poezi dhe “Novelat e qytetit të veriut” në prozë. Asnjëra nga këto dy vepra nuk mundi të shohë dritën e botimit në gjallje të tij. Megjithatë përpjekjet e Migjenit qenë të mëdha. Në vitin 1936 Migjeni mori një lajm të gëzuar. Komisioni për shqyrtimin e librave, pranë Ministrisë së Kulturës Popullore, kishte dhënë pëlqimin për botimin e “Vargjeve të lira”. Duheshin shumë para për shtypjen e librit. Migjeni në atë kohë ishte mësues në Pukë dhe kishte një rrogë simbolike. Gjithsesi që të botonte librin shpenzoi gjithë kursimet. I

pagoi shtypshkronjës këstin e parë nga paratë e ilaçeve, që i kishte hequr mënjatë. Më pas përcaktoi formatin e librit, zgjodhi letrën për librin që do të botohej etj. Migjeni nxitohej në daljen e librit sepse shëndeti i tij sa vinte e keqësohej. Poeti nuk arriti që ta shihte librin të botuar, sepse më 26 gusht të vitit 1938 mbylli sytë përgjithmonë në sanatoriumin San Luigji të Torinos, ku kishte vajtur për kurim. Millosh Gjergj Nikolla u këput shumë herët, në moshën 27-vjeçare. (*Mitrush Kuteli, Vepra letrare, Nr. 5, Tiranë 1990, faqe 294-295*).

Migjeni në çastin që u shua përgjithmonë ndofta po shikonte një ëndërr të bukur me Bojkën e tij të dashur. Bojka gjendej larg në Shqipëri. Ajo ishte shoqe e ngushtë me motrën e tij Ollgën, së cilës i ka dërguar dy letra ku shprehte dhimbjen e saj për humbjen e Mirkos së dashur. Letrat janë shkruar serbisht dhe nuk janë botuar në veprat e mëparshme të Migjenit, për arësye etike, pasi Bojka pas vdekjes së Mirkos ka krijuar familjen e saj në Tiranë. Bojka ka vdekur më 4 maj të vitit 1991. (*Kur vdes larg poeti...dhe eshtrat i vijnë më pas, Korrieri, 6 shkurt 2006, faqe 17*).

Dashuria e vetme e Migjenit kohët e fundit është përfulur shumë, duke e cilësuar si një lidhje incesti. Por mbesa e poetit, Angjelina Luarasi sqaron se Kola, i ati i Bojkës, vërtet kishte mbiemrin Nikolla, por ai kishte ardhur në Shkodër nga komuniteti ortodoks i Kavajës dhe nuk kishte lidhje gjaku me Nikollë Dibrarin, gjyshin e Migjenit, i cili kishte ardhur nga komuniteti ortodoks shqiptar i Rekës së Dibrës. Lidhja e Migjenit me Bojkën ishte një lidhje fisnike dhe e çiltër.

## Vargjet e Migjenit

Vëllimin “Vargjet e lira” Migjeni e kishte shkruar që në vitin 1936. Libri është ndarë në gjashtë cikle: “Kangët e ringjalljes”, “Kangët e mjerimit”, “Kangët e perëndimit”, “Kangët më vete”, “Kangët e rinisë” dhe “Kangët e fundit”. Në ciklin e parë “Kangët e ringjalljes” bëjnë pjesë krijimet më të mira të Migjenit. Në to flitet për njeriun e ri, i cili ndonëse i lindur nga mjerimi shpreson për një botë të re. Migjeni i bën thirrje rinisë që ta këndojë këngën e saj lirisht (Kanga e rinisë).

Rini, thueja kangës ma të bukur që di!  
Thueja kangës sate që të vlon në gji.  
Nxirre gëzimin tand’ të shpërthejë me vrull...  
Mos e freno kangën! Le të marri udhë.

Thueja kangës, rini, pash syt e tu...  
Të rroki, të puthi kanga, të nxisi me dashnu  
me zjarrm tand, rini...Dhe të na mbysi dallga  
prej ndjenjash të shkumbzuese q’i turbullin kanga.

Rini, thueja kangës dhe qeshu si fëmi  
Kumbi i zanit të përplaset për qiellë  
dhe të kthejë prap te na, se hyjt ta kanë zili  
e na të duem fort si të duem një diell.

Thueja kangës, Rini! Thueja kangës gëzimplete!  
Qeshu, rini! Qeshu! Bota asht e jote.

Në ciklin e dytë të “Vargjeve të lira” veçojmë “Poemën e mjerimit”, e cila paraqet fytyrën tragjike të mjerimit të shqiptarëve.

Në këtë poezi, që është si më e goditura e Migjenit, na paraqitet dhimbja e poetit për punëtorin që shfrytëzohet barbarisht.

Kafshatë që s'kapërdihet asht, or vlla, mjerimi,  
kafshatë që të mbetë në fyt edhe të za trishtimi  
kur shef ftyra të zbeta edhe sy të jeshilta  
qi të shikojnë si hije dhe shtrijnë duert e mpita  
edhe ashtu të shtrime mbrapa teje mbesin  
të tanë jetën e vet derisa të vdesin.

Migjeni shkruante “Kangët e pakëndueme”, të cilat nuk u lejuan të qarkullonin nga censura e kohës. U quajtën këngë të ndaluara, sepse dënojnë zymtësinë e atyre viteve dhe ngjallin ndjenjën e shpresës për kohën e re.

Thellë në veten teme flejnë kangët e pakëndueme,  
të cilat ende vuejtja as gëzimi s'i nxori,  
të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme,  
me shpërthye, m'u këndue pa frikë e pa zori.

Thellë në veten time kangët e mia, jesin...  
e unë jam vullkani që fle i fashitun,  
por kur t'i vijë dita të gjitha ka me i qitun  
në një mijë ngjyra të bukura që nuk vdesin.

Sipas Moikom Zeqos, Migjeni në krijimtarinë e tij ka përdorur shumë motive biblike. Ja disa nga ato: “Besimi yt më shpëtoi” (Lluka 7-50); “deri kur” (Psallmi 90, 13); “Këndoni një këngë të re” (Psallmi 149, 1) etj. Në poezinë “Lutje” Migjeni i lutet Perëndisë.

Të lutem, o perëndi,  
për një simfoni  
me tinguj t'argjantë



e akorde t'artë.

Të lutem, o perëndi,  
për një simfoni  
plot dashuni  
të nxehtë si te vasha gjithë  
kur vlojnë ndijesitë.

Të lutem, o perëndi  
për një simfoni  
të dëfrej në lumni  
t'u u përkundë n'ani  
të bukur t'andrrimeve  
të kaltër, ku të fantazmëve  
buzët më tërheqin zjarrtë  
e më digjen syt e flaktë.

Të lutem, o perëndi,  
për një simfoni  
e kurr, e kurr ma mos të zgjohemi.

Te "Recitali i Malësorit" Migjeni përdor vargje nga (Jeremia 51,25), "Ja ku jam unë kundër teje, o mal i shkatërrimit – thotë Zoti, ti që shkatërron tërë tokë." (*Moikom Zeqo, Universi i Migjenit, zbulime të reja, Koha Jonë, 11 maj 2006, faqe 10-11*).

O, si nuk kam një grusht të fortë  
t'i bij mu në zemër malit që s'bëzanë,  
ta dij dhe ai se ç' domethanë i dobët-  
n'agoni të përdihet si vigan i vramë.

Mali hesht. Edhe pse përditë  
mbi lëkurë të tij, në lojë varrimtare,  
kërkoj me gjetë një kafshatë ma të mirë...  
por më rren shaka, shpresa gënjeshtare.

Mali hesht, dhe në heshtje qesh.  
E unë vuej, dhe në vuejtje vdes.  
Po unë, kur? Heu! Kur kam për t'u qesh?  
Apo ndoshta duhet ma parë të vdes?

O, si nuk kam një grusht të fuqishëm!  
Malit, që hesht, mu në zemër me ia njesh!  
Ta shof si dridhet nga grusht'i paligjshëm...  
E unë të kënaqem, të kënaqem tu'u qesh.

Më 5 shkurt të vitit 1956 u sollën nga Italia dhe u varrosën  
në atdhe eshtrat e poetit. Poetët e parandjejnë vdekjen, prandaj  
edhe Migjeni kur ishte në jetë ka shkruar poezinë “Nderim”.

Karroca mortore gjatë udhës kalonte,  
Dhe arkën veç drrasash njerzia nderonte!  
Përmbropa pak veta, me ftyra t'përvajta,  
Përpara ish prifti.  
Nga e djathta, nga e majta njerzia nderojshin!  
Gjatë udhës karroca ngadalë kalonte  
Dhe zanin përdridhte meshtari përvajshëm.

### **Proza e Migjenit**

Migjeni si në poezi, ashtu edhe në prozë pasqyroi me  
realizëm jetën e shtresave të varfëra të qytetit e të fshatit. Në  
krijimtarinë e tij paraqitet me vërtetësi figura e malësorit dhe e

punëtorit. Tregimet e tij janë të një niveli të lartë artistik. Me dhimbje dhe revoltë Migjeni rrëfen para lexuesve se dinjiteti i malësorit ka marrë fund në luftën e përditshme për të mbijetuar, për t' u siguruar fëmijëve bukën e gojës. Personazhet kryesore të rrëfimeve migjeniane janë: punëtori i papunë, malësori që i përgjërohet kokrrës së misrit, nëna që nuk mund të ushqejë dot fëmijën etj. Në prozën e Migjenit mjerimi, uria dhe zvetënimi vijnë nga shtypja e shfrytëzimi që u bëhet shtresave të varfëra të shoqërisë shqiptare.

Nga tregimet e Migjenit po përmendim: “A don qymyr zotni?“, “Studenti në shtëpi”, “Bukën tonë të përditshme falna sot”, “Mollë e ndalueme”, “Zoti të dhashtë”, “Legjenda e misrit”, “Luli i vocërr”, “Bukuria që vret”, “Sokrat i vuejtun apo derr i kënaqun”, “Ne me Krishtin” etj. Shtëpia ku ka lindur Migjeni, në vitin 1961 u kthye në muze, ku u ekspozuaan dorëshkrimet, mjetet e punës, sendet vetjake etj. Pas viteve 1990 ndërtesa e këtij muzeu është marrë nga pronarët, të cilët ia shitën kuvendit të murgeshave.

## BIBLIOGRAFIA

- 1-Anton Papeleka, Poetë shqiptarë, Mësonjtorja, Tiranë 1999.
- 2-Girolamo de Rada, Rapsodie d'un' poema albanese, Firenze 1866.
- 3-Dhimitër Shuteriqi, Shkrimet shqipe, Akademia e Shkencave, Tiranë 1976.
- 4-Dhimitër Beduli, Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1992.
- 5-Dhimitër Beduli, Gjuha Shqipe në Kishë, botim i K.O.A.Sh-it, Tiranë 1997.
- 6-Jeronim de Rada ,Coferenza sull, antichita della lingua Alvaneze.
- 7-Jul Variboba, La vita di Maria, Cosenza 1984.
- 8-Engjëll Sedaj, Simpoziumi Ndërkombëtar Krishtërimi ndër shqiptarë, 16-19 nëntor 1999.
- 9-Engjëll Sedaj, Papa shqiptar Klementi XI Albani dhe Kuvendi i Arbërit, Gjon Buzuku, Prishtinë 1998
- 10-Efthim Dodona, Noli i panjohur, Enciklopedike, Tiranë 1996.
- 11-Fadil Sulejmani, E mbsuame e krështerë e Lukë Matrëngës, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1979.
- 12-Fan S Noli, Vepra II, Dudaj, Tiranë 2003.
- 13-Fan S Noli, Poezi të zgjedhura, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 1975.
- 14-Fan S Noli, Autobiografia, Elena Gjika, Tiranë 1994.
- 15-Frang Bardhi, Fjalor latinisht-shqip, Prishtinë 1983.
- 16-Formula e Pagëzimit, (Kumtesa dhe artikuj), Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë 2008.
- 17-Jul Variboba, Gjella e Shën Mëris Virgjër, Shpresa, Prishtinë 2002.

- 18-Lekë Matranga, E mbësuar e krishterë, Prishtinë 1979.
- 19-Max Demeter Peyfuss, Shtypshkronja e Voskopojës, Vienë 1996.
- 20-Migjeni, Vargjet e lira, Tiranë 1954.
- 21-Mitrush Kuteli, Vepra letrare, Nr. 5, Naim Frashëri, Tiranë 1990.
- 22-Mitrush Kuteli, E madhe është gjema e mëkatit, MK, Tiranë 2000.
- 23-Namik Resuli, Shkrimtarët Shqiptarë, Nga Buzuku deri tek arbëreshët e Greqisë, Pakt, 2007.
- 24-Nasho Jorgaqi, Antologji e mendimit estetik shqiptar 1504-1944, Naim Frashëri, Tiranë 1979.
- 25-Nasho Jorgaqi, “Jeta e Fan S. Nolit 1”, OMBRA GVG, Tiranë 2005.
- 26-Nasho Jorgaqi, “Jeta e Fan S. Nolit 2”, OMBRA GVG, Tiranë 2005.
- 27-Nos Xhuvani, Visarion Xhuvani, apostull i atdhetarizmit dhe i ortodoksisë shqiptare, Tiranë 2003.
- 28-Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, Na flet Visarion Xhuvani, Tekno Paper, Tiranë 2008.
- 29-Pal Dukagjini, Gjergj Fishta, jeta dhe veprat, S. Maria degli Angeli, Assisi 1992.
- 30-Petro N. Luarasi. Mallkimi i shkronjave shqipe dhe çpërfolja e shqiptarëve, Tiranë 1999.
- 31-Pjetër Bogdani dhe vepra e tij, Akademia e Shkencave, Tiranë 1991.
- 32-Pjetër Bogdani, Çeta e profetëve, Prishtinë 1990.
- 33-Pjetër Budi, (Kumtesa dhe artikuj), Muzeu Historik Kombëtar, Tiranë 2008.
- 34-Sabri Hamiti, Letërsia shqiptare e vjetër, Shtëpia botuese e librit shkollor, Tiranë 2001.
- 35-Shaban Sinani, Kështjella e virtytit, botimet Arjan Çakçiri, Tiranë 2001.
- 36-Tomor Osmani, Udha e shkronjave shqipe, Shkodër 1999.
- 37-Visarion Xhuvani, Kujtim vepre dhe intrige, Shtypshkronja Tirana, Tiranë 1926.
- 38-Visarion Xhuvani, Vepra, 55, Tiranë 2007.
- 39-Zef Mirdita, Krishtenizimi ndër shqiptarë, Drita, Zagreb 1998.

## ARTIKUJ GAZETASH & REVISTASH

- Agim Janina, Takimi me Poradecin, Zembrashqiptare.net.
- Admirina Peçi, Të fshehtat e Migjenit rrëfohen në një libër të ri, Zembrashqiptare.net.
- Admirina Peçi, Ky është Kuteli që kurrë nuk e njohëm, Zembrashqiptare.net.
- Alket Çani, Lasgush Poradeci, ky shpikësh harmonish, Zembrashqiptare.net.
- Andrea Llukani, Visarion Xhuvani martir i Kishës Ortodokse, 55, 21 maj 2004, faqe 18.
- Anisa Ymeri, Çajupi, Tomorri i poezisë shqipe, Korrieri, 27 mars 2006, faqe 17.
- Ben Andoni, Migjeni-poeti i dhimbjes krenare, Zembrashqiptare.net.
- Behar Gjoka, Pjetër Budi, pse ka mbetur në harresë, Ballkan, 3 shkurt 2006, faqe 18.
- Behar Gjoka, Faktet e vërteta të vrasjes së Pjetër Budit, Standard, 5 qershor 2006, faqe 14-15.
- Behar Gjoka, Pse shkroi Pjetër Budi në shqip?, Standard, 12 qershor 2006, faqe 14-15.
- Behar Gjoka, Budi në Evropë, kërkon ndihmë për të luftuar turqit, Standard, 19 qershor 2006, faqe 14-15.
- Behar Gjoka, Studimet, çfarë thonë të huajt për Pjetër Budin, Standard, 26 qershor 2006, faqe 14-15.
- Eno Koço, Trako-Nolit, jo ndikimit të muzikës bizantine, Tema, 9 nëntor 2004, faqe 9.
- Ermir Nika, Vepra e Çajupit dhe takimet e saj me rrymat letrare, Korrieri, 27 mars 2006, faqe 17.
- Ermir Hoxha, Botohet për herë të parë në shqip Historia e Shqiptarëve e Nikolla Jorgës, njeriut që zbuloi formulën e pagëzimit të Pal Engjëllit, Shqip, 26 korrik 2006, faqe 40.
- Erjon Tase, Klasiku i fundit i letrave shqipe, Zembrashqiptare.net.
- Flori Slatina, Penda e artë për Ernest Koliqin, 55, 23 dhjetor 2005, faqe 16.
- Fjala e Mjedës, Standard, 21 gusht 2006, faqe 17.
- Dashnor Kaloçi, At Gjergj Fishta, Nder i kombit, Zembrashqiptare.net.
- Dom Nikë Ukgjini, A është libër liturgjik kishtar “Meshari” i Buzukut?, Koha Javore.

- Dhurata Hamzai, E mbësuar e krështerë, në Tiranë s'është origjinal, Tema, 9 nëntor 2005, faqe 17.
- Gjeniu që vdiq pa peng në zemër, Shqip, 28 gusht 2006, faqe 28.
- Imzot Joan Pelushi, Një vështim i shkurtër historik mbi përkthimet fetare në Kishën ortodokse në Shqipëri, Tempulli, Nr 2, Korçë 2000, faqe 11.
- Ismail Kadare, Ardhja e Migjenit në letrësinë shqipe, Zembrashqiptare.net.
- Ismail Kadare, Portreti i Lasgush Poradecit, Zembrashqiptare.net.
- Jaho Brahaj, Kronika e derës së Gjon Buzukut, Koha Jonë, 2 mars 2006, faqe 19.
- Jaho Brahaj, 450 vjet me mesharin e Gjon Buzukut, Panorama, 5 janar 2005, faqe 21.
- Josef Oroshi, Ernest Koliqi-nji pishtar i letërsisë e i kulturës shqiptare fiket, Zembrashqiptare.net.
- Jul Variboba, Gjella e Shën Mërisë virgjër, Tirana Observer, 16 prill 2006, faqe 28.
- Klajd Kapinova, Vepra e Poetit Kombëtar, Zembrashqiptare.net.
- Kur vdes larg poeti...dhe eshtrat i vijnë më pas, Korrieri, 6 shkurt 2006, faqe 17.
- Ledi Shamku-Shkreli, Dictionarium i Frang Bardhit, Shekulli, 28 korrik 2006, faqe 1213.
- Leksionet e Anton Harapit për respektimin e dëshmorëve të atdheut, 55, 30 dhjetor 2005, faqe 7.
- Leonard Veizi, Pjetër Budi, pse ka mbetur në harresë, Ballkan, 3 shkurt 2006, faqe 18.
- Llemadeo Dukagjini, At Gjergj Fishta-poet i madh, mendimtar, gjuhtar dhe gojtar i shquar i kombit shqiptar, Zembrashqiptare.net.
- Magdalena Alla. Formula e Pagëzimit, rrena e një fotomontazhi, Ballkan, 23 shkurt 2004, faqe 29.
- Mërgim Korça, Patër Gjergj Fishta-gjeniu pa varr, Zembrashqiptare.net.
- Mërgim Korça, Patër Gjergj Fishta akoma i trajtuar si gogol, Zembrashqiptare.net.
- Moikom Zeqo, Gjon Buzuku dhe të vërtetat e pathëna për të, Korrieri, 29 qershor 2005, faqe 14-15.

- Moikom Zeqo, Vepra e Buzukut, në rrafshin poetik dhe estetik, Koha Jonë, 20 dhjetor 2005, faqe 8.
- Moikom Zeqo, Universi i Migjenit, zbulime të reja, Koha Jonë, 11 maj 2006, faqe 10-11.
- Moikom Zeqo, Kombkrijuesi dhe emërshenjtë De Rada, Ballkan, 20 shtator 2006, faqe 16.
- Musa Ahmeti, Çeta e Profetëve, Ballkan, 18 shkurt 2004, faqe 28.
- Musa Ahmeti, Vepra “Embsvame e chrestere” e Lekë Matrëngës, Koha Jonë, 23 shkurt 2006, faqe 18.
- Ndue Zef Toma, At Gjergj Fishta, figurë e madhe e kombit, 55, 29 dhjetor 2005, faqe 19.
- Ndue Ujkaj, Ernest Koliqi dhe fillimet e prozës moderne shqipe, Zembrashqiptare.net.
- Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, Liturgjia shqipe, nga Pal Engjëlli te Dhaskal Todri, Tema, 30 shtator 2005, faqe 14-15.
- Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, Përpjekjet për futjen e gjuhës shqipe në liturgjinë e Kishës Shqiptare, Tema, 1 tetor 2005, faqe 14.
- Nos Xhuvani, Pavli Haxhillazi, Si e miratuan ortodoksët shqiptarë predikimin në shqip, Tema, 2-3 tetor 2005, faqe 15.
- Pëtraq Kolevica, Kuteli, shkrimtari që sfidoi diktaturën dhe ringjalli shpresën, Zembrashqiptare.net.
- Pjetër Bogdani. Çeta e profetëve. Përshtatur në gjuhën e sotme shqipe nga E. Sedaj.
- Pjetër Pepa, Si u pushkatua regjenti, gjeniu Patër Anton Harapi, 55, 6 dhjetor 2005, faqe 6.
- Pjetër Pepa, Kontributi i klerit katolik në letërsi, albanologji e media, 55, 14 dhjetor 2005, faqe 9.
- Roland Qafoku, Flet Nasho Jorgaqi: 25 vitet e mia me Fan Nolin, Tirana Observer, 25 prill 2006, faqe 18.
- Skënder Luarasi, Vepra e Migjenit-Kritikë, Zembrashqiptare.net.
- Shaban Sinani, Poeti që motivoi shumë poetë, Zembrashqiptare.net.
- Tomi Mato, Lasgushi, a ka qenë apo jo fetar?, 55, 10 nëntor 2005, faqe 19.
- Tonin Çobani, Frang Bardhi, 1606-1643, Temp, 14 maj 2006, faqe 22-23.



# PASQYRA E LËNDËS

Parathënie

KREU I PARË

LETËRSIA E VJETËR SHQIPE (1200-1800)

Teodor Shkodrani (1210)

Pal Engjëlli (1417-1470)

Gjon Buzuku (1555)

Lekë Matrënga (1560-1619)

Pjetër Budi (1566-1622)

Frang Bardhi (1606-1643)

Pjetër Bogdani (1625-1689)

Zef Skiroi (1690-1769)

Jul Variboba (1724-1788)

Perikopeja nga Ungjilli i Pashkëve (shek.XV)

Anonimi i Elbasanit (shek. XVII)

Grigori i Durrësit (1701-1769)

Nektar Tërpo Voskopojari (shek. XVIII)

Theodhor Haxhifilipi (1730-1805)

Kostandin Berati (1745-1825)

KREU IDYTË  
LETËRSIA E RILINDJES KOMBËTARE (1800-1912)

Naum Velqiharxhi (1797-1846)  
Jeronim de Rada (1814-1903)  
Kostandin Kristoforidhi (1827-1895)  
Petro Nini Luarasi (1865-1911)  
Andon Zako Çajupi (1866-1930)  
Ndre Mjeda (1866-1937)  
Mihal Grameno (1871-1931)  
Asdreni (1872-1947)  
Papa Kristo Negovani (1875-1951)  
Luigj Gurakuqi (1879-1925)

KREU I TRETË  
LETËRSIA E PAVARËSISË (1912-1944)

Gjergj Fishta (1871-1940)  
Fan Noli (1882-1965)  
Visarion Xhuvani (1887-1965)  
Anton Harapi (1888-1946)  
Lasgush Poradeci (1899-1987)  
Ernest Koliqi (1903-1975)  
Mitrush Kuteli (1907-1967)  
Migjeni (1911-1938)

Bibliografia  
Pasqyra e lëndës



